

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

SHËRBIME DETARE NË KUVERTË

Niveli V i KSHK
(Pas të mesmes)

Kodi: J1-V-14

Miratoi:

.....

**Ky skeletkurrikul u hartua me mbështetjen e Projektit IPA 2010 për
Zhvillimin e Burimeve Njerëzore, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar
nga Organizata Ndërkombëtare e Punës.**



Tiranë, 2014

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK .**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK.**
 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK.
 2. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK.
 3. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime detare në kuvertë”, niveli IV.
- III. Plani mësimor për profilin mësimor “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve bazë të sigurisë.**
- X. Përshkruesit e moduleve profesionale të praktikës së shpërndarë.**
- XI. Praktika profesionale e grupuar në anije.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK, është *“aftësimi i nxënësve me kompetencat e nevojshme për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e detare në kuvertë”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Shërbime detare në kuvertë”, niveli IV, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë dhe të rriturit që:

- kanë mbaruar arsimin e mesëm të lartë, niveli IV i KSHK ;
- nga pikëpamja shëndetësore, janë *“të aftë për punë në det”* sipas kërkesave të Ligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për standardet e kualifikimit, atestimit dhe të shërbimit për detarët” STCW 1978 dhe amendamentet e mëvonshme;
- janë të aftë të notojnë;
- janë të aftë të komunikojnë në gjuhën angleze.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të shkollës, atëherë, MAS përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Shërbime detare në kuvertë”, niveli IV, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale, si më poshtë:

- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale.

- Të zbatojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në përmbushjen e detyrave profesionale.
- Të përdorë pajimet personale për sigurinë dhe shëndetin në punë.
- Të përdorë pajimet personale, kolektive dhe teknikat e rekomanduara për mbijetesën në det.
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet për parandalimin dhe luftën kundra zjarrit.
- Të japë ndihmën e parë.
- Të përdorë materialet për reagim ndaj ndotjeve detare.
- Të interpretojë leximet e aparateve kryesore të instaluar në urën e komandës.
- Të përdorë mjete, mekanizma dhe agregate të instaluar në kuvertën e mjetit lundrues.
- Të kryejë punime mirëmbajtje në sektorin e kuvertës.
- Të realizojë shërbime në funksion të aktivitetit ekonomik të mjetit lundrues në port.
- Të realizojë vendosjen e sigurtë të mjeteve për pritjen dhe përcjelljen e pilotit.
- Të realizojë detyrat e shërbimit kur mjeti lundrues është në det.
- Të përgatisë materialet dhe veglat për peshkim.
- Të realizojë ruajtjen e freskisë së produkteve të zëna nga gjuetia.
- Të notojë në kushte të ndryshme në ujë.
- Të vozisë barkë mbijetese.
- Të realizojë detyrat e ngarkuara sipas Planit të Sigurisë së Mjetit të Lundrimit.
- Të përdorë terminologjinë standarde detare ndërkombëtare në shqip dhe anglisht.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtjshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Shërbime detare në kuvertë”, niveli IV, e pajis nxënësin me Çertifikatën e Aftësimit profesional Rregulli **II/4 i STCW¹** + **Rregulli III/1 i STCW²**.

Pas një përvoje pune në det, të përcaktuar nga Administrata Detare, fiton të drejtën të pajiset me Çertifikatën e Aftësimit profesional si Marinar Kuverte i Kualifikuar Rregulli **II/5 i STCW** + **Rregulli II/4 i STCW²**. Me ndjekjen e një Kualifikimi të lartë të caktuar në fushën e detarisë fiton të drejtën të pajiset me Diplomën në Navigacion me mundësi karriere si:

- a. Oficer Kuverte,
- b. Oficer i II,
- c. Oficer i I, dhe
- d. Kapiten

sipas Rregullave përkatëse të Administratës Detare, STCW¹ dhe STCW².

Ky kualifikim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në mjetet e lundrimit si më poshtë:

- Peshkimi bregdetar deri në 20 milje nga bregu më i afërt.
- Peshkimi apo argëtimi - çlodhje në ujërat e brendshme.
- Shërbimi portual.
- Transporti detar ndërkombëtar.
- Roje bregdetare dhe agjencive të tjera ligj-zbatuese në det.
- Kërkimore shkencore dhe praktike mësimore.
- Argëtimi - çlodhje në det.

¹ Standardet e Trajnimit, Certifikimit dhe Atestimit të Detarëve

² Standardet e Trajnimit, Certifikimit dhe Atestimit të Peshkatarëve

**III. Plani mësimor për profilin mësimor “Shërbime detare në kuvertë”,
niveli V i KSHK.**

Plani mësimor për profilin mësimor “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
A.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	10 (180 orë)
1	L-30-355-14	Hyrje në industrinë detare dhe legjislacioni	2
2	L-30-356-14	Art detar	3
3	L-30-357-14	Shërbimi në det dhe në port STCW II/4	1
4	L-30-358-14	Avaritë detare	1
5	L-16-359-14	Peshkim	1
6	L-30-360-14	Komunikimi standard detar ndërkombëtar në anglisht IMO 3.17	2
B.		Modulet bazë të sigurisë (Gjithsej)	5 (90 orë)
1	M-30-1035-14	Teknikat personale të mbijetesës në det (IMO 1.19)	18
2	M-30-1036-14	Parandalimi dhe lufta kundër zjarrit (IMO 1.20)	18
3	M-30-1037-14	Ndihma e parë elementare (IMO 1.13)	18
4	M-30-1038-14	Siguria personale dhe përgjegjësia shoqërore (IMO 1.21)	18
5	M-30-1039-14	Trajnim për detarët me detyra të veçanta sigurie (IMO 3.26)	18
C.		Modulet profesionale të praktikës së shpërndarë (Gjithsej)	15 (270 orë)
1	M-30-1040-14	Notimi dhe vozitja	36
2	M-30-1041-14	Interpretimi i instrumentave kryesore hidro-meteorologjike e radionavigacional	30
3	M-30-1042-14	Punime mirëmbajtje në kuvertë	96
4	M-30-1043-14	Operime të mjeteve, mekanizmave dhe agregateve në kuvertë	36
5	M-16-1044-14	Peshkimi me anije dhe me mjete të lehta lundruese	36
6	M-30-1045-14	Sigurimi i ngarkesave të stivuara	36
D.		Praktika profesionale e grupuar në anije (Gjithsej)	16 javë (640 orë)
		Gjithsej A+B+C+D	1180 orë

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime detare në kuvertë”, Niveli V i KSHK, është 1 vit shkollor.

Viti shkollor ka gjithsej 35 javë (18 javë mësimore + 16 javë praktikë e grupuar në anije + 1 javë provimet përfundimtare teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Një javë mësimore ka 30 orë mësimore teorike dhe/ose praktike të shpërndarë (5 ditë x 6 orë/ditë).

Praktika e grupuar në anije realizohet në fund të vitit shkollor me këtë kohëzgjatje:

16 javë x 5 ditë/javë x 8 orë/ditë në lundrim.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Shërbime detare në kuvertë”, Niveli V i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët profesionale (programet e përgjithëshme të tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikës bazë (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet profesionale të praktikës së shpërndarë (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli, detyrat e të cilit do të përmbushen sipas rastit në anije).
- Praktika e grupuar në anije (kjo praktikë kryhet në kuadrin e detyrave që përmbushen në anije, sipas Librit të Regjistrimit të Trajnimit në Mjetin Lundrues).

Rekomandohet që javët mësimore 5 ditëshe të ndahen në blloqe me 2 ditë teori profesionale dhe 3 ditë praktikë profesionale të shpërndarë.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikës profesionale të shpërndarë duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilin profesional “Shërbime detare në kuvertë”.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata.

Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Pas përfundimit të moduleve bazë të sigurisë nxënësit do t'i nënshtrohen provimit të ndërmjetëm për përvetësimin e kompetencave përkatëse, i cili organizohet nga shkolla profesionale dhe Administrata Detare, si dhe marrin certifikatën përkatëse. Kjo certifikate u jep të drejtën nxënësve të kryejnë me tej praktikën në mjete lundrimi.

Kompetencat profesionale për të cilat nxënësit duhet të praktikohen në mjete lundrimi, pasqyrohen në Librin e Regjistrimit të rajnimit në ord të jetit undruës.

Ato vlerësohen nga kapiteni, oficeri ose instruktori. Përmbushja me sukses e këtyre kompetencave u jep të drejtën nxënësve për t'iu nënshtuar provimeve përfundimtare.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime detare në kuvertë”, niveli IV, nxënësi i nënshtrohet provimeve të mëposhtme nga Shkolla Profesionale në bashkëpunim me Administratën Detare:

a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;

b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale të shërbimeve të detare në kuvertë, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Shërbime detare në kuvertë”, niveli V i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me certifikatën e arsimit për profilin “Shërbime detare në kuvertë”. Kjo certifikatë përmban:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët profesionale dhe modulet profesionale;

- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit V i KSHK.

Administrata Detare në bashkëpunim me Shkollën profesionale, e pajis nxënësin me Certifikatën e Aftësisë profesionale Rregulli II/4 i STCW + Rregulli III/1 i STCW.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Hyrje në industrinë detare dhe legjislacioni” (L-30-355-14), 36 orë

- Synimet e lëndës “Hyrje në industrinë detare dhe legjislacioni”.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Hyrje në industrinë detare dhe legjislacioni” nxënësi duhet:

- Të përshkruajë portet, parimet e organizimit dhe veprimtaritë kryesore;
- Të përshkruajë llojet e ndryshme të aktiviteteve ekonomike në industrinë e transportit detar;
- Të përshkruajë historinë e veprimtarive detare në vendin tonë;
- Të përkufizojë parimet kryesore të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare në industrinë e transportit detar dhe peshkimit;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar në fushën e detarisë;
- Të përshkruajë elementet kryesore të legjislacioni e aplikueshëm të punës në det;
- Të listojë institucionet në fushën e detarisë dhe funksionet përkatëse të tyre;
- Të përshkruajë konceptet bazë të hidrometeorologjisë;
- Të dallojë aparatet kryesore të matjes së elementeve hidrometeorologjike në mjetin lundrues;

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Hyrje në industrinë detare dhe legjislacioni”, 36 orë

Tema 1	Parimet e organizimit dhe veprimtaritë në porte	2 orë
Tema 2	Llojet e ndryshme të aktiviteteve ekonomike në industrinë e transportit detar	2 orë
Tema 3	Historia e veprimtarive detare në vendin tonë	2 orë
Tema 4	Parimet e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare në industrinë e transportit detar dhe peshkimit	4 orë
Tema 5	Legjislacioni shqiptar në fushën e detarisë	4 orë
Tema 6	Elementet kryesore të legjislacioni e aplikueshëm të punës në det	6 orë
Tema 7	Institucionet në fushën e detarisë dhe funksionet përkatëse të tyre	2 orë
Tema 8	Konceptet bazë të hidrometeorologjisë	6 orë
Tema 9	Aparatet kryesore të matjes së elementeve hidrometeorologjike dhe në mjetin lundrues	8 orë

2. Lënda “Arti detar” (L-30-356-14), 54 orë

- Synimet e lëndës “Arti detar”.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Arti detar”, nxënësi duhet:

- Të identifikojë tipet e mjeteve lundruese.
- Të dallojë pjesët kryesore përbërëse të mjetit lundrues.
- Të përshkruajë funksionet e mekanizmave dhe agregateve në sektorin e kuvertës.

- Të përshkruajë mënyrat e përdorimit të mekanizmave dhe agregateve në sektorin e kuvertës.
- Të identifikojë e përshkruajë veglat dhe mjetet e punës, si dhe mënyrën e përdorimit të tyre.
- Të përshkruajë metodat e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së veglave dhe mjeteve të punës.
- Të rendisë hapat e punës për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të kuvertës.
- Të përshkruajë metodat e ruajtjes së mekanizmave dhe agregateve në sektorin e kuvertës;
- Të përshkruajë metodat mirëmbajtjes së mekanizmave dhe agregateve në sektorin e kuvertës.
- Të radhisë hapat e punës për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve të omergjimit;
- Të përshkruajë hapat e punës për mirëmbajtjen e hapësirave të ngarkesës;
- Të përshkruajë mirëmbajtjen për mjetet e Mbrojtjes Kundra Zjarrit;
- Të përshkruajë mirëmbajtjen për mjetet e shpëtimit;
- Të përshkruajë mirëmbajtjen në sektorin e akomodimit

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Arti detar”, 54 orë:**

Tema 1	Tipet e mjeteve lundruese dhe ndërtimi i tyre	2 orë
Tema 2	Funksionet dhe mënyrat e përdorimit të mekanizmave dhe agregateve në sektorin e kuvertës	8 orë
Tema 3	Veglat dhe mjetet e punës, përdorimi dhe metodat e ruajtjes dhe të mirëmbajtjes së tyre	6 orë
Tema 4	Shërbime të mirëmbajtjes në kuvertë	10 orë
Tema 5	Masat e sigurimit teknik për punime të ndryshme në mjetin e lundrimit	4 orë
Tema 6	Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve të omergjimit	8 orë
Tema 7	Mirëmbajtja e hapësirave të ngarkesës;	6 orë
Tema 8	Mirëmbajtja për mjetet e Mbrojtjes Kundra Zjarrit	4 orë
Tema 9	Mirëmbajtja për mjetet e shpëtimit	4 orë
Tema 10	Mirëmbajtja në sektorin e akomodimit	2 orë

3. Lënda “Shërbimi në det dhe në port” (L-30-357-14), 18 orë

• **Synimet e lëndës “Shërbimi në det dhe në port”.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Shërbimi në det dhe në port”, nxënësit duhet:

- Të dallojë drejtimit kryesore të horizontit;
- Të listojë mjetet dhe aparaturat kryesore në urën e komandës dhe funksionet përkatëse të tyre;
- Të interpretojë aparaturat përkatëse për identifikimin e drejtimeve të lëvizjes së mjetit lundrues në det;
- Të përshkruajë veprimet që kryhen gjatë shërbimit në urën e komandës;
- Të rendisë veprimet që kryhen në patrullimin periodik në mbistrukturë;
- Të përshkruajë veprimet që kryhen për kontrollin e gjendjes së ngarkesës gjatë lundrimit;
- Të përshkruajë veprimet që kryhen për kontrollin e hapësirave të ngarkesës gjatë lundrimit;
- Të radhisë hapat e punës për përgatitjen për hedhjen/ngritjen e spirancës të mjetit lundrues;
- Të radhisë veprimet që kryhen gjatë hedhjes/ngritjes së spirancës të mjetit lundrues;
- Të radhisë veprimet që kryhen pas hedhjes/ngritjes së spirancës të mjetit lundrues;
- Të dallojë terminalët portuale, funksionet dhe pjesët përbërëse të tyre;

- Të radhisë hapat e punës për përgatitjen e mjetit lundrues për ngarkim/shkarkim;
- Të rendisë veprimet për kontrollin e fiksimit të sigurtë të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë veprimet për përgatitjen e mekanizmave të përpunimit të ngarkesës të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë veprimet për sigurimin e ngarkesës për lundrim;
- Të përshkruajë veprimet për sigurimin e hapësirave të ngarkesës për lundrim;
- Të radhisë veprimet për sigurimin e mekanizmave të përpunimit të ngarkesës për lundrim;
- Të radhisë veprimet për sigurimin e agregateve dhe materialeve të lëvizshme në kuvertë për lundrim;
- Të përshkruajë veprimet për sigurimin e hermetizimit të hapësirave në mbistrukturë për lundrim;
- Të përshkruajë veprimet për përgatitjen e mjeteve për pritjen dhe përcjelljen e pilotit;
- Të përshkruajë punën për evidentimin e ngarkesës që ngarkohet ose shkarkohet nga mjete lundrues;
- Të përshkruajë hapat e punës për përgatitjen e akostim/ç'akostimit të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë hapat e punës që kryhen gjatë akostim/ç'akostimit të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë hapat e punës që kryhen pas akostim/ç'akostimit të mjetit lundrues;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Shërbimi në det dhe në port”, 18 orë:**

Tema 1	Orientimi në det dhe aparaturat në funksion të lundrimit	2 orë
Tema 2	Shërbimi në det dhe përgatitja e mjeteve për pritjen e përcjelljen e pilotit	4 orë
Tema 3	Përgatitja dhe hedhja/ngritja e spirancës së mjetit lundrues	2 orë
Tema 4	Terminalet dhe aktiviteti ekonomik i mjetit lundrues në to	2 orë
Tema 5	Përgatitja e mjetit lundrues për ngarkim/shkarkim	2 orë
Tema 6	Sigurimi i ngarkesës, hapësirave, mekanizmave të përpunimit dhe agregatëve e materialeve të lëvizshme në kuvertë	2 orë
Tema 7	Sigurimi i hermetizimit të hapësirave në mbistrukturë për lundrim	2 orë
Tema 8	Përgatitja e akostim/ç'akostimit të mjetit lundrues dhe puna që kryhet gjatë dhe pas akostim/ç'akostimit	2 orë

4. Lënda “Avaritë detare” (L-30-358-14), 18 orë

• **Synimet e lëndës “Avaritë detare”.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Avaritë detare”, nxënësit duhet:

- Të përshkruajë rregullat për familjarizimin me mjetin lundrues
- Të radhisë masat e sigurimit teknik gjatë punës në mjetin lundrues
- Të përshkruajë veprimet pas përplasjes së mjetit lundrues
- Të përshkruajë veprimet pas rënies në cekinë të mjetit lundrues
- Të radhisë hapat e punës për luftën kundra ujit;
- Të përshkruajë veprimet për kërkim shpëtimit në det
- Të përshkruajë veprimet gjatë një avarie në sistemin e drejtimit
- Të përshkruajë veprimet gjatë një avarie në motorin kryesor
- Të përshkruajë veprimet gjatë një avarie në sistemin elektrik
- Të radhisë veprimet kur ndodh lëvizje e ngarkesës / Krenim i mjetit lundrues
- Të radhisë hapat e punës për rimorkimin e mjetit të lundrimit;
- Të përshkruajë veprimet për operacione me helikopter;
- Të listojë llojet e ndotësve të mjedisit detar;

- Të radhisë masat për parandalimin e ndotjeve të mjedisit detar;
- Të listojë inventarin e materialeve për reagim ndaj ndotjeve detare;
- Të përshkruajë veprimet për reagimin gjatë ndotjeve të mjedisit detar;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Avaritë detare”, 18 orë:**

Tema 1	Rregullat për familjarizimin me mjetin lundrues	3 orë
Tema 2	Përplasje, rënie në cekinë, ujë në anije dhe lëvizje e ngarkesës/Krenim i mjetit lundrues	4 orë
Tema 3	Kërkim shpëtimi në det dhe veprimet me helikopterin	2 orë
Tema 4	Avari të e sistemit të drejtimit, motorrit kryesor, sistemit elektrik. Rimorkimi	4 orë
Tema 5	Ndotja e mjedisit detar	5 orë

5. Lënda “Peshkim” (L-16-359-14), 18 orë

• **Synimet e lëndës “Peshkim”.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Peshkim”, nxënësit duhet:

- Të përshkruajë teknikat kryesore të gjuetisë së peshkut;
- Të identifikojë llojet e veglave kryesore të peshkimit dhe pjesët përbërëse të tyre;
- Të përshkruajë veprimet për përgatitjen e materialeve dhe veglave për peshkim;
- Të përshkruajë radhën e punës për hedhjen në ujë dhe marrjen nga uji të veglave të peshkimit;
- Të identifikojë llojet kryesore dhe cilësitë e produkteve të zëna nga gjuetia;
- Të përshkruajë kushtet e duhura për ruajtjen e freskisë së produkteve të zëna nga gjuetia;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Peshkim”, 18 orë:**

Tema 1	Teknikat të gjuetisë së peshkut	3 orë
Tema 2	Llojet e veglave kryesore të peshkimit dhe pjesët përbërëse të tyre	3 orë
Tema 3	Përgatitja e materialeve dhe veglave për peshkim	3 orë
Tema 4	Teknikat e hedhjes dhe marrjes nga uji të veglave të peshkimit	3 orë
Tema 5	Llojet kryesore dhe cilësitë e produkteve të zëna nga gjuetia	2 orë
Tema 6	Kushtet për ruajtjen e freskisë së produkteve të zëna nga gjuetia	4 orë

6. Lënda “Komunikimi standard ndërkombëtar detar në anglisht” (L-30-360-14), 36 orë

• **Synimet e lëndës “Komunikimi standard ndërkombëtar detar në anglisht”.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Komunikimi standard ndërkombëtar detar në anglisht”, nxënësit duhet:

- Të interpretojë terminologjinë standarde detare ndërkombëtare në gjuhën angleze;
- Të interpretojë sinjalet e alarmeve në mjetin lundrues;
- Të interpretojë sinjalet kryesore sipas REPAD³;
- Të interpretojë sinjalet kryesore sipas Kodit Ndërkombëtar të Sinjaleve;
- Të interpretojë sinjalet e dorës sipas Kodit të Praktikës së Sigurtë të Punës në Porte sipas ILO⁴-s;
- Të interpretojë veprimet që duhen kryer kur i jepet një urdhër i dhënë nga eprori;

³Rregullore e Evitimit të Përplasjeve të Anijeve në Det

⁴International Labour Organization - Organizata Ndërkombëtare e Punës

- Të përshkruajë rregullat dhe etikën e komunikimit në mjetin lundrues;
 - Të dallojë simbolet kryesore të mallrave të rrezikshme;
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Komunikimi standard ndërkombëtar detar në anglisht”, 36 orë:**

Tema 1	Komunikimi standard detar ndërkombëtar në gjuhën angleze	4 orë
Tema 2	Komunikimi për përgatitjen për nisje nga mbërritje për në port. akostim – ç’akostimi.	2 orë
Tema 3	Komunikimi për incidentet në bord dhe në breg.	2 orë
Tema 4	Komunikimi për sigurinë dhe rreziqet në vendin e punës	4 orë
Tema 5	Komunikimi për motin dhe procedurat për mbijetesë	3 orë
Tema 6	Komunikimi për shërbimet në det dhe në port	2 orë
Tema 7	Komunikimi për transportin detar. Siguria në anije	2 orë
Tema 8	Komunikimi për mbrojtjen e mjedisit	3 orë
Tema 9	Puna dhe sjellja me ekipazhe me kultura të ndryshme në det	3 orë
Tema 10	Komunikimi me radio	2 orë
Tema 11	Interpretimi i rregullores së Evitimit të Përplasjeve të Anijeve në Det (REPAD)	3 orë
Tema 12	Interpretimi i kodeve ndërkombëtare të sinjaleve në det dhe në port	2 orë
Tema 13	Interpretimi i simboleve kryesore të mallrave të rrezikshme	2 orë

IX. Përshkruesit e moduleve bazë të sigurisë.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 8569, datë 20.01.2000 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për Standardet e Kualifikimit, Atestimit dhe të Shërbimit për Detarët, të vitit 1995” si dhe ndryshimet e mëvonshme të Konventës përfshirë Kodin e saj.

Emërtimi i Moduleve	Përshkrimi i Modullit	Kodi/ Standardi	Kohë-zgjatja	Vendi i zhvillimit të kursit
Moduli - 01 Teknikat personale të mbijetesës Personal Survival Techniques Ref: STCË'95 A-VI/1-1	Modul teoriko-praktik për të pajisur nxënësit/detarët me njohuritë dhe aftesitë e nevojshme për të reaguar ndaj situatave emergjente të cilat mund të çenojnë mbijetesën personale si: përplasia e anijes, njeriu në det, ujë në anije, mbytja dhe braktisja e anijes, hipotermia etj.	M-30-1035-14 IMO 1.19	18 orë	Në klasë dhe në ambjent anijeje
Moduli – 02 Parandalimi dhe lufta kundër zjarrit Basic Fire Fighting Ref: STCË'95 A-VI/1-2	Modul teoriko-praktik për trajnimin e nxënësve/detarëve në lidhje me parimet e parandalimit të zjarrit, si dhe veprimet që duhet të ndërmerren në rast zbulimi të zjarrit në anije. Demonstrim i sigurisë dhe efikasitetit në përdorimin e fiksave të zjarrit, përdorimit të shllangave dhe përdorimit të kompletit të fikësit të zjarrit (kostumi amjantit me aparat frymëmarrës).	M-30-1036-14 IMO 1.20	18 orë	Në klasë dhe në ambjent anijeje
Moduli - 03 Ndihma e parë elementare Elementary First Aid Ref: STCW'95 A-VI/1-3	Modul teoriko-praktik për trajnimin e nxënësve/detarëve në lidhje me njohjen dhe aftësimin e kërkuar për të ndërmarrë veprime të menjëhershme pas ndodhjes së një aksidenti apo emergjence tjetër mjekësore nga personeli në bordin e anijes.	M-30-1037-14 IMO 1.13	18 orë	Në klasë dhe në ambjent anijeje
Moduli - 04 Siguria personale dhe përgjegjësitë	Modul teoriko-praktik për trajnimin e nxënësve/detarëve për njohjen dhe aftësimin e nevojshëm për krijimin e një ambjenti të	M-30-1038-14 IMO 1.21	18 orë	Në klasë dhe në ambjent anijeje

<p>shoqërore</p> <p>Personal Safety & Social Responsibility</p> <p>Ref: STCË'95 A-VI/1-4</p>	<p>sigurtë pune. Kryerja e veprimeve nga secili detar me korrektësi së pari ndaj vetes dhe më anagazhimi po me të njëjtën përgjegjësi ndaj të tjerëve është nga kushtet bazë për një ambjent të sigurtë pune në anije.</p>			
<p>Moduli - 05 Trajnim për Detarët me Detyra të Veçanta Sigurie</p> <p>Training for the Seafarers with Specific Security Duties</p> <p>Ref: STCW'95 A-VI/6-2</p>	<p>Modul teoriko-praktik për trajnimin e nxënësve/detarëve për të aftësuar detarët që imbarkohen në mjete lundrimi për të ruajtur kushtet e caktuara në Planin e Sigurisë së Anijes, dalluar rreziqet dhe kërcënimet e sigurisë, ndërmarrë inspektime të rregullta sigurie dhe përdorin si duhet pajisjet dhe sistemet e sigurisë.</p>	<p>M-30-1039-14</p> <p>IMO 3.26</p>	<p>18 orë</p>	<p>Në klasë dhe në ambjent anijeje/porti</p>

1. Moduli: “Teknikat personale të mbijetesës në det”

Profili mësimor: Shërbime detare në kuvertë

Niveli: V i KSHK

Kodi: M-30-1035-14

Qëllimi i modulit: Një modul teorik e praktik që i pajis nxënësit/detarët me njohuri e aftësi për të ndërmarrë veprime të menjëhershme kur konfrontohen me një situatë emergjente që mund të kërcënojë mbijetesën e tyre personale si: përplasja e anijes, ujë në anije, mbytja dhe braktisja e anijes etj.

Metoda e trajnimit: Fillimisht do të zhvillohen leksione teorike që do të zbatohen edhe në praktikë. Pjesa praktike do të zhvillohet në det ose në pishinë.

Kërkesa të veçanta: Pjesëmarrësit duhet të jenë të aftë nga ana shëndetsore para ndjekjes së kursit, sipas kërkesave të Rregullit 1/9 të STCW95.

Kohëzgjatja e modulit: Moduli parashikohet të zgjasë 18 orë.

Provimi: Pjesëmarrësit duhet të kalojnë në provim për dijet teorike dhe aftësitë praktike të kërkesave të modulit.

Tema/veprimtaria që do të zhvillohet

Hyrje, siguria dhe mbijetesë

- **Udhëzimi mbi sigurinë**
 - Konstatimi që rregullat e sigurisë që vendosen nga instruktori, të cilit detarët
 - që do trajnohen duhet t'i binden gjatë kursit dhe sidomos gjatë mësimëve praktike.
- **Parimet e mbijetesës në det**
 - Konstatimi i parimeve të mbijetesës në det si:- fillimi i familjarizimit në bord, ushtrimet, trajnimet dhe alarmet sistematike, përgatitjen për çdo emergjencë, njohuritë mbi veprimet që duhet të kryhen, njohuritë mbi rreziqet kryesore për të mbijetuarit.
- **Përkufizimet, mjetet e shpëtimit**
 - Përcaktimi dhe dallimi;
 - Mjetet e shpëtimit, barka e shpëtimit, kostumet e zhytjes, xhaketat e shpëtimit, mjetet e lëshimit, etj.
- **Manuali i trajnimit SOLAS (Safety of Life at Sea).**
 - Konstatimi që trajnimi specifik për çdo anije ndodhet në manualin e trajnimit SOLAS.
- **Simbolet e sigurisë**
 - Identifikimi i simboleve të sigurisë që përdoren në anije.

- **Llojet e emergjencës**
 - Evidentimi i emergjencave që çojnë në zjarr apo fundosje të anijes si: përplasja-rënia në tokë- lëvizja e ngarkesës-ngarkesat e rrezikshme - shpërthimi i sallës së mashinës- skafi, etj.
- **Marrja e masave**
 - Evidentimi i masave që merren kundër këtyre emergjencave.
- **Masat kunder zjarrit**
 - Përshkrimi i përgjithshëm i mënyrave për të luftuar zjarrin.
- **Mbytja**
 - Përshkrimi i përgjithshëm i mënyrave për të luftuar ujin.
- **Eksperienca e ekuipazhit**
 - Konstatimi se efektiviteti i mjeteve të shpëtimit të jetës varet nga eksperienca e ekuipazhit.
- **Lista e apelit dhe sinjalet e emergjencës**
 - Shpjegimi i nevojës së: Listës së Apelit - Sinjaleve të emergjencës
 - Trajnimeve mbi Emergjencat.
- **Ekuipazhi dhe instruksionet mbi emergjencën**
 - Konstatimi se, që në momentin e parë të hipjes në anije, ekuipazhi duhet të marrë njohuri për: Kuptimin e sinjaleve të emergjencës - instruksionet e listës së apelit dhe detyrat - vendodhja dhe përdorimi i paisjeve të shpëtimit - rrugët e shpëtimit dhe pajisjet - emergjencat që involvojnë mbytjen e anijes - mënyrat e mbijetesës.
- **Paisjet shtesë dhe mbijetesë**
 - Evidentimi i paisjeve shtesë të cilat merren me vete nga anija për në mjetet e mbijetesës n.q.s. koha e lejon.
- **Braktisja e anijes - problemet**
 - Shpjegimi i problemeve që, gjatë braktisjes së anijes shkaktohen nga: mjetet e shpëtimit e palëshura - mungesa e ndriçimit - mungesa e kryerjes së detyrës nga personeli.
- **Braktisja e anijes si zgjidhja e fundit**
 - Konstatimi që anija zakonisht është shansi më i mirë për të mbijetuar dhe braktisja e anijes bëhet vetëm kur të gjitha masat e tjera dështojnë.
- **Përgatitja personale për braktisjen e anijes**
 - Shpjegimi mbi vetë-përgatitjen për të braktisur anijen.
- **Domosdoshmëria e shmangjes së panikut**
- **Detyrat e ekuipazhit ndaj pasagjerëve**
- **Detyrat e ekuipazhit - lëshimi i paisjeve të shpëtimit.**
- **Urdhëri i Kapitenit për braktisjen e anijes**
 - Konstatimi që urdhëri për të braktisur anijen vjen vetëm nga kapiteni.
- **Mënyrat e mbijetesës**
 - Përshkrimi i mënyrave të domosdoshme për mbijetesën pasi anija është braktisur si: qëndrimi mbi ujë - të ngrohtit/ftohtit – konsumi i ujit dhe ushqimeve - mënyra e komunikimit me anijet apo varkat e shpëtimit.
- **Barkat e mbijetesës**
 - Identifikimi i tipeve të ndryshme të barkave të mbijetesës si: të hapura, gjysëm të mbyllura- vetëfryrëse gjysëm të mbyllura- totalisht të mbyllura- totalisht të mbyllura me sistem ajrosje të vetën- të mbrojtura nga zjarri;
 - Konstatimi që në anijet pasagjere kapaciteti i barkave të mbijetesës është i mjaftueshëm për çdo person në bord;
 - Konstatimi që në anijet e ngarkesës kapaciteti i barkave të mbijetesës është sa

- dyfishi i njerëzve në bord;
- Demonstrimi se si barkat e mbijetesës lëshohen nga: vinxhat - rënie e lirë;
- Tregimi i masave që duhet të merren për të garantuar sigurinë personale gjatë lëshimit të barkave të mbijetesës;
- Demonstrimi i imbarkimit nga anija në barkën e mbijetesës.
- **Trapet e mbijetesës**
 - Evidentimi i dy tipeve të trapeve të mbijetesës: statik dhe me vetëfryrje.
- **Barka e shpëtimit**
 - Konstatimi i minimumit të barkave të shpëtimit për: anijet pasagjere - anijet e ngarkesës;
 - Përshkrimi i kërkesave të cilat lejojnë një barkë mbijetesë të jetë dhe barkë shpëtimi.
- **Rrathët e shpëtimit**
 - Përshkrimi se si rrathët e shpëtimit janë të shpërndarë nëpër anije;
 - Përshkrimi mbi paisjet shtesë që mund të lidhen tek rrathët e shpëtimit.
- **Xhaketat e shpëtimit**
 - Konstatimi i numrit të xhaketave të shpëtimit për: anijet pasagjere - anijet e ngarkesës;
 - Konstatimi që lundrueshmëria sigurohet nga: material i lundrueshëm - fryrja;
 - Konstatimi i paisjeve të tjera të xhaketes së shpëtimit si: drita fikse apo vezulluese - bilbili i siguruar me litar.
- **Kostumet e zhytjes/veshjet anti ekspozim**
 - Përshkrimi i kostumit të zhytjes;
 - Konstatimi që personat në barkën e shpëtimit duhet të veshin kostum zhytje/veshje anti-ekspozim
 - Konstatimi që në anijet e ngarkesës çdo anëtar i ekipazhit duhet të ketë kostum zhytje/veshjet anti ekspozim.
- **Rrathët e shpëtimit**
 - Marrja e një rrethi shpëtimi, hedhja e tij në ujë dhe vëzhgimi i: pluskimit, dritave vetë ndezëse, sinjalet tymuse vetëndezëse, cimat pluskuuese.
- **Xhaketat e shpëtimit**
 - Veshja e një xhakete shpëtimi pa fryrje në mënyrë korrekte brenda 1 minute pa asistencë;
 - Hedhja në ujë nga lartësia me xhakete shpëtimi të veshur;
 - Notimi në një distancë të shkurtër me xhakete shpëtimi të veshur;
 - Testimi i bilbilit të xhaketes së shpëtimit;
 - Vënia në punë e dritës së xhaketes.
- **Xhaketat e shpëtimit me fryrje**
 - Veshja e një xhakete shpëtimi me fryrje në mënyrë korrekte brenda 1 minute pa asistencë;
 - Hedhja në ujë nga lartësia me xhakete shpëtimi të veshur;
 - Notimi në një distancë të shkurtër me xhakete shpëtimi të veshur;
 - Testimi i bilbilit të xhaketes së shpëtimit;
 - Testimi i metodave jo automatike të fryrjes.
- **Kostumet e zhytjes**
 - Shpaketimi dhe veshja e kostumit të zhytjes brenda 2 minutave pa asistencë;
 - Hipja dhe zbritja në shkallë vertikale deri në 5 m me kostum dhe xhakete shpëtimi veshur, hedhja në ujë nga lartësi jo më pak se 4.5 m, notimi në një distancë të

shkurtër, përmushja e detyrave të vëna gjatë braktisjes, testimi i bilibilit, vënia në punë e dritës.

- **Mbijetesat personale pa xhakete shpëtimi**
 - Demonstrimi se si mund të pluskohet në ujë pa xhakete shpëtimi, kostum zhytje apo kostum anti ekspozimi.
- **Hipja në mjetin e mbijetesës**
 - Hipja në mjetin e mbijetesës nga anija apo nga uji me xhaketa shpëtimi veshur;
 - Ndihma ndaj të tjerëve;
 - Demonstrimi i përdorimit të paisjeve përfshirë këtu dhe spirancën lundruese;
 - Drejtimi dhe kthimi i trapit të mbijetesës;
 - Demonstrimi i braktisjes së trapit të mbijetesës.

Mbijetesat në det

- **Rreziqet për të mbijetuarit**
 - Përshkrimi i rreziqeve si: goditjet e nxehtësisë- goditjet e diellit- ekspozimi ndaj të ftohtit dhe hipotermia- efektet nga zënia e detit- mungesa e lëngjeve të trupit- pirja e ujit të detit- zjarri apo vaji në ujë- peshkaqenët.
- **Përdorimi më i mirë i paisjeve të mbijetesës**
 - Përshkrimi mbi largimin nga anija;
 - Shpjegimi mbi masat mbrojtëse kundër goditjes së nxehtësisë- goditjes së diellit- ekspozimin ndaj hipotermisë;
 - Konstatimi i efektit të zënies së detit;
 - Shpjegimi mbi përdorimin e kujdesshëm të ujit të pijshëm dhe ushqimit për të evituar dehidratimin;
 - Shpjegimi i marrjes së masave në rastet e zjarrit apo vajit në det;
 - Shpjegimi i mënyrave të mbijetesës në ujrat me peshkaqenë;
 - Shpjegimi i përdorimit të spirancës lundruese;
 - Evidentimi i detyrave të vrojtimit;
 - Përshkrimi i mënyrave të zbulimit nga të tjerët;
 - Evidentimi i mënyrave për të mbajtur lart moralin;
 - Shpjegimi mbi mënyrat e largimit të peshkaqenëve;
 - Shpjegimi i mënyrave të mbijetesës në ujë.
- **Radiot portabël për barkat e mbijetesës**
 - Demonstrimi se si funksionojnë për transmetimin e sinjaleve të alarmit dhe fatkeqsive.
- **EPIRB-i (Emergency Position Indicating Radio Beacon)**
 - Konstatimi mbi mënyrën e përdorimit;
 - Sasia në bord dhe vendodhja e tyre;
 - Demonstrimi se si aktivizohet;
 - Përshkrimi i rrezikut për përdorimin aksidental;
 - Ndryshimi midis EPIRB-it dhe SART-it.
- **SART-i (Save and Rescue Transponder)**
 - Konstatimi mbi përdorimin;
 - Sasia në bord dhe vendodhja e tyre;
 - Demonstrimi se si aktivizohet;
 - Përshkrimi i rrezikut për përdorimin aksidental.

Asistenca e helikopterit

- **Komunikimi me helikopterin**
 - Demonstrimi i sinjaleve të dorës dhe të krahut;

- Shpjegimi si komunikohet me helikopterin me anë të stacionit tokësor kur janë pajisjet e duhura.
- **Braktisja nga anija apo barka e mbijetesës**
 - Shpjegimi që në anije duhet të ketë një zonë marrjeje, e lirë nga direkët, kavot etj;
 - Përshkrimi mbi metodat e braktisjes së barkës apo trapit pneumatik të mbijetesës.
- **Marrja me helikopter**
 - Përshkrimi i metodave të marrjes: me pajime, barrelë, rrjetë shpëtimi, kosh etj.
 - Shpjegimi i sinjaleve të dorës dhe të krahut për ngritje pa dëmtime;
 - Përshkrimi se si një anëtar i ekuipazhit të helikopterit mund të asistojë në ngritje;
 - Shpjegimi i rëndësisë së bindjes të urdhërave të dhëna nga piloti apo ndihmësi i tij.
- **Përdorimi korrekt i pajimeve të helikopterit**
 - Përshkrimi i pajimeve/rripit.
 - Demonstrimi për një vendosje korrekte dhe lidhja/sigurimi i tij.

Materialet Mësimore:

- Klasë ose mjedis anije ku mund të instalohet projektori.
- Tavolinë për demonstrim me përmasa 3 m me 1 m.
- Materiale audio-vizive apo me slaidera.

Mësimet praktike kërkojnë akses në një pishinë, liqen apo det. Për këtë kërkohen pajimet e mëposhtme:

- 36 xhaketa shpëtimi
- 5 xhaketa shpëtimi me fryrje
- 1 lifeboys
- 1 trap i ngurtë
- 2 trape me fryrje për 20 persona për praktikimin në ujë
- 1 SART (Transponder për kërkim Shpëtimin) që punon me frekuencë 9 GHz
- Kostume mbijetese (zhytje)
- Kompleti i pajimeve të trapit pneumatik
- Kompleti i pajimeve të barkës së mbijetesës
- 1 EPIRB Sinjalizues Radiofonik që Tregon Vend-ndodhjen e Avarisë që punon me frekuencë 460 MHz
- Solucion kundra peshkaqenëve
- Pajimet e Sigurisë/ndihmës së parë

2. Moduli: “Parandalimi dhe lufta kundër zjarrit”

Profili mësimor: Shërbime detare në kuvertë

Niveli: V i KSHK

Kodi: M-30-1036-14

Qëllimi i modulit: Një modul teorik e praktik që i pajis nxënësit/detarët me njohuri, aftësi dhe besim për t’iu përgjigjur siç duhet emergjencave të zjarrit, si dhe për përdorimin korrekt të pajisjeve dhe kryerjes së procedurave të emergjencës për të garantuar mbijetesën e tyre në një emergjencë zjarri

Metoda e trajnimit: Fillimisht do të zhvillohen leksione teorike për të trajtuar llojet e zjarrit dhe të paisjeve emergjente. Do të behet praktikë e përdorimit të fiksave portabël të zjarrit si dhe do të njihen me procedurat emergjente të evakuimit.

Kërkesa të veçanta: Pjesëmarrësit duhet të jenë të aftë nga ana shëndetsore para ndjekjes së kursit, sipas kërkesave të Rregullit 1/9 të STCW95

Kohëzgjatja e modulit: Moduli parashikohet të zgjasë 18 orë.

Provimi: Pjesëmarrësit duhet të kalojnë në provim për dijet teorike dhe aftësitë praktike të kërkesave të modulit.

Tema/Veprimtaria që do të zhvillohet

Hyrja, siguria dhe parimet

Të përgjithshme

- **Të dijë si të veprojë në rastet kur:**
 - Zbulohet tym apo zjarr ose bie alarmi i zjarrit;
 - Dhënien e alarmit dhe njohuri bazë mbi përdorimin e fiksave portativë;
 - Mbylljen dhe hapjen e dyerve: zjarrduruese, të kuvertës, dhe atyre hermetike në anije;
 - Zvogëlimin e rrezikut të zjarrit dhe mbajtjen e gjendjes së gatishmërisë për t’iu përgjigjur situatave emergjente në lidhje me zjarrin.
 - Lufta kundra zjarrit dhe fikja e tij.
- **Të njohë rregullat e sigurisë kundra zjarrit që trajtohen gjatë teorisë si dhe nga mësimet praktike.**
- **Parimet e mbijetesës në lidhje me zjarrin:**
 - Rregullsia e kryerjes së trajnimeve dhe alarmeve;
 - Prgatitja ndaj çdo lloj emergjence zjarri;
 - Njohuri për veprimet që duhet të kryhen pas grumbullimit tek stacioni i thirrjes;
 - Njohuri mbi rrugëkalimet e largimit;
 - Njohuri mbi rreziqet e tymit dhe avujve toksikë.

Kushtet e zjarrit:

- **Kushtet e nevojshme për shkaktimin e zjarrit:**
 - Elementët e zjarrit dhe ndezja (trekëndeshi i zjarrit).
 - Tipet, llojet e ndezjes dhe përhapja e zjarrit.
 - Rastet kur futet edhe elementi i katërt (reaksioni zinxhir) që të çon në konceptin e piramidës së zjarrit që përfaqson një zjarr me djegje të vazhdueshme.
- **Materialet e ndezshëm, rreziqet e zjarrit.**
 - Veçoritë e materialeve të ndezshëm që përcaktohen nga;
 - Ndezshmëria, pika e ndezjes, temperatura e djegjes, shpejtësia e djegjes, vlerat termike, kufiri i poshtëm i ndezjes (LFL), kufiri i sipërm i ndezjes (UFL), rrezja ndezshmërisë, pika e flakërimit dhe vetëndezja;
 - Shembuj si ndodh ndezja si rrjedhojë e elektricitetit;
 - Shpjegimi i reaksionit;
 - Shpjegimi i burimeve të ndezjes.

Tipet dhe burimet e ndezjes

- **Parimet e parandalimit të zjarrit.**
 - Si mund të parandalohet përhapja e zjarrit duke e reduktuar ose e bllokuar;
 - Ftohja e materialit që digjet;
 - Ndërprerja e oksigjenit;
 - Ndalimi i shkëndijave ndezëse;
 - Heqja njërit nga elementët e trekëndëshit mund të parandalojë ose fikë zjarrin.

Materialet e ndezshme që ndodhen më zakonshëm në anije

- **Përhapja e zjarrit:**
 - Ftohja e materialit që digjet, Ndërprerja e oksigjenit dhe Ndalimi i shkëndijave;
 - Shembuj mbi përhapjen e zjarrit si rezultat i barazimit të temperaturës së zjarrit dhe mjedisit përreth me anë të materialeve që digjen, oksigjenit dhe shkëndijës;
 - Shembuj mbi mënyrat e përhapjes;
 - Temperatura në një zjarr normal dhe në metalet që digjen;
 - Listimi i katër fazave të zhvillimit të zjarrit si:
Shkëndija ndezëse – zhvillimi - zjarri absolut-djegja totale.
- **Praktika e sigurtë:**
 - Proçedurat e praktikës së sigurtë në përgjithësi, përfshirë, të mos pirjes së duhanit në vendet e rrezikshme, pastërtia, higjena, aftësia për të njohur rreziqet e zjarrit dhe në marrjen e masave për parandalimin e zjarrit;
 - Në lokalin e makinerisë, masat për minimizimin e rreziqeve, që përfshijnë: mirëmbajtjen e izolacioneve elektrike dhe termoizolimit, eliminimin e rrjedhjeve vajore dhe parandalimin e akumulimit të karburanteve, marja e masave kundër zjarrit gjatë proçedurave të saldimit ose prerjeve me oksigjen, kontrolli për mbylljen e kapakëve të sondave dhe furnizimit të karburanteve, mbajtja e lokalit pastër dhe heqja e leckave të pastrimit mbas përdorimit;
 - Në guzhinë, masat për minimizimin e rreziqeve të zjarrit që përfshijnë: pastrimin e mbajtjen hapur të aspiratorit të nxjerjes së gazrave nga guzhina, të siguruarit që vajrat e gatimit nuk derdhen mbi sobë apo nuk tejnëhen mbi plitkat elektrike të gatimit, dhe mirëmbajtjen e instalimeve elektrike;
 - Në hoteleri, masat për minimizimin e rreziqeve të zjarrit që përfshijnë: të mos pirjes duhan në shtrat, mos përdorimin e pajisjeve të pa-autorizuara elektrike, mos zbrazjen e tavllave të duhanit tek koshat e plehrave pa u bindur që nuk ka mbetur cigare e ndezur;
 - Në lokalet e ngarkesës, masat për minimizimin e zjarrit që përfshijnë: pastrimin me

korrektësi të grykave të lokaleve të ngarkesës, stivimin dhe ventilimin e ngarkesës në përputhje me rregullat, ndalimin e pirjes së duhanit gjatë përpunimit të ngarkesës, sigurimit të ngarkesës, bllokimin e ajrosjeve në lokalet e ngarkesës kur kërkohet;

- Të siguruarit që ndriçimi fiks në lokalin e ngarkesës të jenë të fikura dhe ai i lëvizshëm të shkëputet nga linja dhe largohet pas përdorimit dhe para mbylljes së kapakëve.

Nevoja për vigjilencë të vazhdueshme

- Parandalimi i zjarrit është mënyra më e mirë për t'a luftuar dhe kjo mbërrihet nëpërmjet:
 - Vigjilencës së vazhdueshme;
 - Prgatitjes;
 - Kontrolleve;
 - Mbajtjen nën mbikqyrje si duhet;
 - Mirëmbajtjen e pajisjeve.
- **Sistemet e kontrollimit (patrullimi)**
 - Është e nevojshme që në anijet ku ka më shumë se 36 vetë duhet të mbahet një sistem patrullimi;
 - Detyrat e patrullës;
 - Sistemi i patrullimit ndaj zjarrit mund të jetë i këshillueshëm edhe në anije të tjera.

Rreziqet e Zjarrit

- Rreziqet e zjarrit në lokalin e makinerisë, përfshirë: lëngjet e djegshme – nafta e vajrat lubrifikues, rrjedhjet e karburanteve, izolacionet e lagura me naftë, sipërfaqet e nxehta, p.sh. tubot e shkarikos, - pjesët e motorrit që nxehen, difektet në termoizolime, saldimet, p.sh. saldimi – prerja me oksigjen-llambë acitileni, vetëndezja, p.sh. pikat e karburanteve që bien mbi sipërfaqe të nxehta;
- Rreziqet në guzhinë, përfshirë: lëngjet e djegshëm, p.sh. vaji gatimit, - yndyrnat e nxehura, sipërfaqet e nxehta, p.sh. furrat, fteret, aspiratorët, lidhjet e elektrike difektoze;
- Rreziqet në hoteleri, përfshirë: materialet e djegshme, p.sh. parapetet dhe mobilimi, - sendet personale, shkrepset dhe cigaret e ndezura, lidhjet elektrike difektoze;
- Rreziqet në lokalet e ngarkesës, përfshirë: ngarkesat me vetëngrohje që japin zjarre spontane, oksidimi i ngarkesës dhe peroksidet organike, gazrat e djegshëm nën presion, ngarkesat e rrezikshme, eksplozivët;
- Rreziqet nga duhanpirësit dhe cigaret përfshirë: temperaturën e djegjes së cigares e cila është rreth 500°C, pakujdesia me cigaret dhe shkrepset mund t'i vejë zjarrin shtratit – koshave të plehrave dhe hotelerisë.

Organizimi i luftës kundër zjarrit në anije

- **Alarmi emergjencës përgjithshme**
 - Përbëhet nga shtatë ose më shumë fishkëllima dhe të ndjekura nga një e gjatë të sirenës së anijes dhe zile apo çanga apo tinguj të njëjtë kudo në anije;
 - Qëllimi i alarmeve të veçanta të operueshme nga ura komandës, për të mbledhur ekuipazhin tek stacionet zjarrfikëse;
 - Alarme të tjerë të mundshëm si CO₂, salla e pompave, operimi me dorë, Sistemi i zbulimit të zjarrit në anijet me UMS (Unattended Machinery Space).
- **Planet e kontrollit të zjarrit dhe Listat e apelit**
 - Trajtimin e planeve të kontrollit të zjarrit dhe vend-ndodhjen e tyre;
 - Trajtimin e listës së apelit;
 - Shembuj detyrash individuale për secilin anëtar të ekuipazhit.

- **Komunikimet**
 - Trajtimin e mënyrave të komunikimit që përdoren gjatë një emergjence si: korierët, telefonat, radiot e dorës, Radiot VHF, P.A.-të (Public Address)
- **Procedurat e sigurisë së personelit**
 - Trajtimin e përbërjes së skuadrës zjarrfikëse dhe personi përgjegjës;
 - Trajtimin e faktit që në zonën e zjarrit nuk mund të futet njeri pa urdhër nga personi përgjegjës;
 - Trajtimin e rëndësisë së njohjes së zonës së zjarrit dhe rrugëve të largimit;
 - Trajtimin e rëndësisë të qenurit i pajisur si duhet për t'u futur në zonën e zjarrit, veçanarisht kur nuk ka ndriçim dhe hapësira është plot me tym.
 - Veshja kundra zjarrit
 - Pajisjet e duhura, përfshirë aparatën e frymëmarrjes, ndriçuesin e dorës, sopatën, levën, litarin e amjantit dhe pajimet e tjera;
 - Mënyra e përdorimit të litarit të amjantit për komunikime me sinjalizime;
 - Nevoja e të qenurit fleksibël në plotësimin e vendeve bosh me personel kyç në zonat e zjarrit.
- **Alarmet periodike në anije**
 - Qëllimi i alarmeve në anije;
 - Ushtrimet tipike që përdoren gjatë alarmeve të zjarrit: fikja në një zonë me vajra, hyrja në zona të mbyllura ku ka rënë zjarr, fikja e zjarrit në kuvertë, shpëtimi i personit pa ndjenja në hapësirat e mbushura me tym.

Vend-ndodhja e pajisjeve zjarrfikëse e rrugëkalimet e largimit të emergjencës

- **Linjat e konstruksionit të anijes**
 - Parimet bazë;
 - Vend-ndodhja rrugëkalimeve të emergjencës dhe si mbrohen këto rrugëkalime;
 - Shembuj mbi parapetet ndarëse të klasës A, B dhe C/F;
 - Shembuj mbi mënyrat e pastrimit të tankeve nga gazrat;
 - Shembuj mbi qëllimin dhe mënyrat e mbylljes së hapësirave të ngarkesës;
 - Masat parandaluese të kërkuara ndaj zjarreve në hapësirat e ngarkesës;
 - Pompa zjarrfikëse e emergjencës (në anijet e ngarkesës);
 - Kërkesat e numrit të saraçineskave të ujit, që pompa zjarrfikëse e emergjencës duhet të furnizojë;
 - Kërkesat për pozicionin e kësaj pompe;
 - Trajtimin e rrethanave kur duhet të përdoret pompa zjarrfikëse e emergjencës;
 - Përdorimin e kimikateve me pudër;
 - Aparati me pudër stacionar tipik me kontenitor që mban 250 Kg pudër;
 - Mënyrat e përdorimit për të marrë rezultatet më të mira;
 - Rrugëkalimet e largimit në rast emergjence;
 - Përshkrimin e rrugëkalimeve të emergjencës nga lokali mashinës për në hotel, kuvertën kryesore dhe më pas për tek sanajtë e mbijetesës;
 - Rrugëkalimet e emergjencës nga hoteli për tek sanajtë e mbijetesës;
 - Përshkrimin e rrugëkalimeve të emergjencës nga salla e pompave për tek kuverta kryesore dhe më pas për tek sanajtë e mbijetesës;
 - Përshkrimin e rrugëkalimeve të emergjencës nga hapësirat e ngarkesës për në kuvertën kryesore dhe më pas për tek sanajtë e mbijetesës;
 - Përshkrimin e markimeve dhe simboleve të rrugëkalimeve të emergjencës;
 - Përshkrimin e sistemit të ndriçimit të rrugëkalimeve të emergjencës;
 - Përshkrimin e mënyrave të përdorimit të rrugëkalimeve të emergjencës edhe në

sensin e kundërt
me qëllim për të mbërritur në vendin ku ka rënë zjarr.

Skudra e fikjes së zjarrit në disa pozicione në anije

• Skudra e fikjes së zjarrit në anije

- Konstatimi se zjarri që bie në lokalin e mashinës duhet të mbahet po aty për t'u përpjekur që të mos kaloj në hotel pasi ky i fundit është ndarë nga lokali mashinës me parapete me mbrojtje termike;
- Trajtimin e çështjes se zjarri që bie në lokalin e pompave të ngarkesës duhet të mbahet po aty për t'u përpjekur që të mos kaloj në hotel pasi ky i fundit është ndarë nga lokalet për-rreth me parapete me mbrojtje termike;
- Faktin që të gjithë dyert e tipit A-60 që ndajnë lokalin e mashinës nga lokali pompave të ngarkesës duhet të mbyllën në rast zjarri në hapësirat respektive;
- Faktin që të gjithë farfallat e shijunëve të ventilimit, duhet të mbyllën në rast të rënies së zjarrit në lokalin e mashinës dhe të ngarkesës;
- Trajtimin e çështjes se zjarri që bie në hotel duhet të mbahet po aty duke u përpjekur që të mos kaloj në lokalin e mashinës dhe në lokalin e pompave të ngarkesës pasi këto të fundit janë të ndarë nga njëri tjetri me parapete me mbrojtje termike;
- Trajtimin e çështjes se zjarri që bie në guzhinë, lavanteri, depon e leckave për pastrim, hapësirat publike dhe kabina duhet të mbahet po aty në vendin ku bie zjarr duke u përpjekur që të mos kaloj në pjesë të tjera të hotelit duke përdorur parapete me mbrojtje termike, farfallat e shijunëve të ventilimit/ndalimet e emergjencës;
- Trajtimin e çështjes se zjarri që bie në hapësirat e ngarkesës, duhet të mbahet po aty duke u përpjekur që të mbyllën kapakët e Mc.Gregorëve, farfallat e shijunëve të ventilimit dhe duke ftohur parapetet rrethues;
- Trajtimin e çështjes se zjarri që bie në hapësira të izoluara si timoneri, dhoma e radios, dhoma e hartave, zona e forpikut, d.m.th. lokali i bojrave etj. dhe salla e timonit të emergjencës duhet të mbahet po aty në vendin e origjinës duke u përpjekur që të mos e kaloj lokalin duke mbyllur farfallat e shijunëve të ajrosjes, dhe duke përdorur sistemet stacionare të fikjes së zjarrit si dhe pajisje të tjera në dispozicion për fikjen e zjarrit;

Masat e zbulimit të tymit dhe zjarrit si dhe sistemet e alarmit automatik në anije

• Sistemet e zbulimit të tymit dhe zjarrit në anije

- Trajton ndërtimin e sistemit automatik të zbulimit të zjarrit;
- Trajton llojet kryesore të sistemeve automatike të zbulimit të zjarrit;
- Trajton alarmet ose veprimet që mund të aktivizohen nga detektori;
- Trajton anët pozitive të sistemit automatik me sprinkler (sprucim) në lidhje me zbulimin e zjarrit në kabinat e pasagjerëve dhe të ekuipazhit.

• Alarmi automatik i zjarrit në anije

- Operimi i alarmit automatik të zjarrit;
- Sistemi me zona të mundshme zjarri dhe ku mund të instalohet ky sistem në anije.

Klasifikimi i zjarreve dhe agjentët fikës të aplikueshëm

• Klasifikimi i zjarreve

- Zjarri i klasës A: përfshin materiale inerte të karbonizueshme me natyrë organike, p.sh. lënda drusore, rrobat, letra, dërrasa etj;
- Zjarri i klasës B: përfshin lëngjet e ndezshme apo inerte të lëngëzueshme, p.sh. vajrat, graso, rrëshirë, bojra etj;
- Zjarri i klasës C: përfshin gazrat, p.sh. gazin e gatimit apo të saldimit;
- Zjarri i klasës D: përfshin metalet, p.sh. magnezium, sodium dhe potasium.

- **Agjentët e fikës të klasave të ndryshme të zjarrit**
 - Klasa A: Me ujë me sprucim, me presion, përmbajtje, CO₂;
 - Klasa B: Me shkumë, CO₂, pluhur i thatë;
 - Klasa C: Pluhur i thatë, CO₂;
 - Klasa D: Pluhur i thatë i veçantë;
 - Trajtimin e zjarrit elektrik që futet në një nga këto klasa d.m.th. A, B, C ose D, me shkëputjen e elektricitetit rekomandohen fikësat me kimikate të thatë ose CO₂.

Përzgjedhja e mjeteve dhe pajisjeve për fikjen e zjarrit

- **Shllangat dhe pipthat për fikjen e zjarrit.**
 - Rregullat që kanë të bëjnë me shllangat dhe pipthat e fikjes së zjarrit;
 - Mënyrat e bashkimit të shllangave dhe lidhja e tyre me saraçinskat;
 - Mënyra e përdorimit të pipthit, duke nxjerrë ujë me presion, spruco apo të përzier, dhe për ç'qëllim përdoret secili nga to;
 - Mënyra e mirëmbajtjes dhe e ruajtjes së shllangave dhe pipthave.
- **Aparati i lëvizshëm.**
 - Llojet e aparateve të lëvizshëm që njihen, përfshirë bombolat me dioksid karboni, kontenitorët me gaz pluhur, pajisjen e prodhimit të shkumës;
 - Zonat se ku ato shkarkohen më zakonisht.
- **Fikset e zjarrit portabël**
 - Llojet e fikseve portabël të zjarrit si: ujë, shkumë, pluhur, CO₂, AFFF;
 - Parimet e përdorimit të secilit nga këto fikse zjarri portabël;
 - Detaje të klasave të zjarrit dhe cila nga llojet e fikseve është më i përshtatshëm;
 - Kapacitetet normale të secilit nga fikset portabël të zjarrit;
 - Trajtimin e procedurave për mbushjen e fikseve të zbrazura;
 - Aplikatori portabël i shkumës, mënyra lidhjes me linjën e sistemit zjarrfikës.
- **Kostumi i zjarrfikësit.**
 - Përbërësit e kostumit zjarrfikës ndahen në tre grupe: pajimet personale, aparati frymëmarrjes, cima zjarrduruese e shpëtimit me levën dhe brezi sigurimit;
 - Dy llojet e aparateve frymëmarrëse që përdoren;
 - Avantazhet dhe dizavantazhet e tyre;
 - Kërkesat për cimën zjarrduruese të shpëtimit;
 - Përbërësit e pajimeve personale si: kostumi, dorezat dhe çizmet, helmata, elektriku i dorës dhe sopata zjarrfikëse. Të gjitha këto të tipit zjarrdurues;
- **Batania zjarrduruese.**
 - Përshkrimi i batanijes zjarrduruese;
 - Përdorimi i batanijes zjarrduruese;
 - Vend-ndodhja e batanijes zjarrduruese.
- **Njohuri mbi masat e ruajtjes nga zjarri.**
 - Vendodhja dhe përdorimi e alarmeve të zjarrit, vendodhja dhe përdorimi kontrollit të emergjencës;
 - Trajtimin e rëndësisë së njohjes së funksionimit të pajisjeve zjarrfikëse;
 - Rëndësia e të qenurit i vetëdijshëm për rreziqet potenciale që paraqet zjarri.
- **Alarmi zjarrit dhe veprimet paraprake.**
 - Përshkrimin e veprimeve me zbulimin e zjarrit, aktivizimin e alarmit, njoftimi stacionit të kontrollit, kufizimi, përpjekjet për fikjen e zjarrit.
- **Lufta kundër zjarrit.**

- Mbikqyrja e burimeve të mundshme të zjarrit;
- Faktorët që duhen marrë parasysh në vendim-marrjen se me ç' lloj mënyre duhet luftuar zjarri: mundësinë e hyrjes në vend-zjarr, personeli prezent në vendin e zjarrit, reaksionet me materiale të ndezshme/ngarkesa, pajisjet dhe agjentët zjarrfikës të përshtatshëm.
- **Mënyrat e fikjes së zjarrit në anije.**
 - Trajton llojet e agjentëve apo mënyrave të fikjes së zjarrit si: ujë me presion, me sprucim, “tymosje” apo përmbytje, shkumë, CO₂, avull, pluhura të thatë kimikate.
- **Proçedurat e fikjes së zjarrit në anije.**
 - Trajton momentin e dhënies së alarmit të zjarrit, proçedurat e fikjes dhe proçedurat e emergjencës që zbatohen në vend: mbledhja e ekuipazhit në vend grumbullimet e përcaktuara në listën e apelit, grupet e fikjes së zjarrit dhe dhënia e porosive në sallën e komandës për detyrën që duhet të kryejnë në vendin ku ka rënë zjarr për fikjen e tij, ndezja e pompave dhe furnizimi i linjave me ujë në zonën e zjarrit, dhe vendimi i kapitenit për mënyrën më të përshtatshme për fikje;
 - Autoriteti i kapitenit në komandimin e operacioneve për fikjen e zjarrit nga ura e komandës;
 - Trajton proçedura pas fikjes së zjarrit si p.sh. në lënien e rojes në atë zonë;
 - Trajton veprimet hetuese që ndërmer kapiteni për të evituar përsëritjen e ngjarjes;
 - Trajton rastin e rënies së zjarrit në anije kur kjo e fundit ndodhet në port, dhe njoftimi i menjëhershëm që i bëhet autoriteteve portuale.
- **Zjarret e vegjël në anije.**
 - Veprimet me shllangën zjarrfikëse me ujë me presion dhe sprucim me anën e pipthit dhe me aplikatorin e shkumës.
 - Veprimet për përdorim korrekt të fiksave të zjarrit portabël të përshtatshëm, respektivisht, për llojet vijuese të zjarrit: materialet p.sh. dru, karburant, yndyrna, plastike, gaz propan, elektrike.
- **Zjarret e mëdha në anije.**
 - Veprimet për fikjen e zjarreve të mëdha të llojeve të ndryshme, përfshirë zjarrin në karburante, duke përdorur sipas rastit: ujë (me presion, sprucim dhe “tymosje”), shkumën përfshirë AFFF (me bazë ujore), pluhur i thatë apo i njomë, CO₂.
 - Përdorimin e cimës së shpëtimit por pa aparat frymëmarrës dhe veprimet për të hyrë dhe kaluar në një lokal ku është lëshuar shkumë me shumicë.

Masat mbrojtëse për përdorimin e instalimeve stacionare për fikjen e zjarrit.

- **Të përgjithshme.**
 - Kërkesat e përgjithshme të një sistemi stacionar zjarrfikës përfshirë: materialet që përdoren për të mos prodhuar gazra toksikë, sasia e substancave duhet të jetë e mjaftueshme për hapësirat që mbulon, sistemi tubacioneve duhet të ketë valvola kontrolluese, lëshimi i substancave të gazta nuk duhet të jetë automatike, urdhëri për lëshimin e substancave duhet të jepet nga Kapiteni ose nga oficer më i ulët në gradë;
 - Sistemet stacionare si: CO₂, sprinkler (sprucues i lagësht ose i thatë), shkumë (me presion të ulët), shkumë (me presion të lartë), linja e tubacioneve kryesore me ujë të sistemit zjarrfikës, gjeneratorët e emergjencës, pompat zjarrfikëse dhe të sentinave, uji me presion në hapësirat e kategorisë së veçantë, pluhur kimik.
- **Sistemet me efekte mbytëse: CO₂ dhe shkuma.**
 - Efektet izoluese fikëse të zjarrit nga CO₂;
 - Avantazhet dhe rreziqet e CO₂;
 - Veprimet që kryhen kur jepet alarmi i CO₂;
 - Hapësirat ku përdoret zakonisht CO₂;

- Efektet e shkumës në një rast zjarri;
- Veprimet para se të lëshohet CO₂ ose shkuma në një lokal ku ka rënë zjarr;
- Llojet e ndryshme të shkumërave.
- **Sistemet me efekte kufizuese.**
 - Llojet e pluhurave që përdoren për fikjen e zjarrit.
- **Sistemet me efekt ftohës: sprinkleri, presion uji.**
 - Sprinkleri, si funksionon një sistem me sprinkler;
 - Hapësirat ku përdoret sistemi sprinkler;
 - Përcaktimin e kategorive të veçanta të hapësirave ku përdoret normalisht sistemi me presion me ujë i aktivizuar mekanikisht;
 - Arsyet pse në çdo kuti shllange, duhet të ketë një saraçineskë.
 - Arsyet e pajisjes me saraçineska dhe valvola mbyllëse të sistemit.
 - Flanxha ndërkombëtare e lidhjes me bregun, qëllimi, përmasat;
 - Mënyra e lidhjes nga bregu me flanxhën ndërkombëtare në anije.

Përdorimi i aparatit frymëmarrës për fikjen e zjarrit.

- **Aparati frymëmarrës.**
 - Përshkrimi i aparatit të frymëmarrjes për fikjen e zjarrit;
 - Veshja dhe verifikimi i veshjes korrekt i hermeticitetit të maskës;
 - Kontrollat verifikuese që bëhen pas veshjes në trup;
 - Teknikat korrekte të frymëmarrjes me presion të ulët ndërkohë që bën sforcime të mëdha;
 - Largimi nga hapësirat me ajër të intoksikuar pas mbarimit të ajrit në bombolat e aparatit;
 - Kontrollat e herë pas herëshme të manometrit të ajrit tek bombolat, gjatë përdorimit të aparatit frymëmarrës dhe veprimet pas sinjalit që tregon se ajri në bombola është në përfundim;
 - Pjesët përbërëse të aparatit të frymëmarrjes, përfshirë helmetën zjarrduruese, pompën, tubot e ajrit dhe pajimet shoqëruese.
- **Alarmet në hapësira të mbushura me tym.**
 - Mënyrat e kontrollit dhe përdorimit të aparatit frymëmarrës si vijon: helmetën të tipit zjarrdurues, pompën dhe tubot e ajrit, aparatit frymëmarrës me ajër të komprimuar;
 - Hyrja duke përdorur aparatit frymëmarrës në një lokal të mbushur me tym artificial jo toksik;
 - Përdorimin e cimës së shpëtimit si komunikim me sinjale në një lokal të mbushur me tym ku kemi hyrë me aparat frymëmarrje të veshur;
 - Pjesëmarrja në grup duke ushtruar komunikime me pjesën tjetër të grupit, ndërkohë që ke veshur aparatit frymëmarrës;
 - Përdorimi i fikseve të llojeve të ndryshme në një lokal me zjarr dhe i mbushur me tym ndërkohë që ke veshur aparatit frymëmarrës;
 - Fikja e zjarrit masiv me aparat frymëmarrës veshur, në lokale të mbyllura të mbushur me tym, përfshirë hoteleri apo stimulin të lokalit të makinerisë, dhe duke përdorur sipas rastit: (ujë me presion, sprucim apo “tymosje”), shkumë, pluhur.

Përdorimi i aparatit frymëmarrës për qëllime shpëtimi jete.


- **Aparati frymëmarrës.**
 - Kërkimi i personave në një hapësirë të mbushur me tym (duke mbajtur edhe barrelë) ndërkohë që është veshur aparatit frymëmarrës;
 - Përdorimi i aparatit frymëmarrës për shpëtimin e njerëzve të dëmtuar: demonstrimi praktik i veshjes së aparatit frymëmarrës, në grup prej dy personash, që hyjnë në një

lokal prove, duke kërkuar për të asfiksuar dhe transporti i barrelës mbajtëse, dhe më pas nxjerrjes së të dëmtuarit në një vend të sigurtë në kuvertën e hapur për dhënien e ndihmës së parë;

- Kryerja e ushtrimit të njejtë në lokal të errësuar;
- Kryerja e ushtrimit të njejtë në lokal të mbushur me tym;
- Kryerja e ushtrimit të njejtë në lokal të errësuar, të mbushur me tym dhe me temperaturë të lartë;
- Kryerja e ushtrimit të njejtë duke mbajtur aparat frymëmarrje rezervë për t'u përdorur gjatë operacioneve të shpëtimit.

Materialet mësimore:

- Klasë për pjesën teorike me projektor ku mund të shihen materialet audio vizive apo me slaidera.
- Një tavolinë me përmasa 3m me 1m.
- Ambjente për praktikën siç mund të jenë dy konteinerë sipër njëri tjetrit (shiko figurën më poshtë) apo në repart PMNZH.



- mundësi rimbushje të bombolave zjarrfikëse portabël;
- dhomë për inspektimin dhe mirëmbajtjen e apartit të frymëmarrjes
- 2 tabaka metalike (afërsisht 1 m x 1 m x 0.3 m)
- 2 tubo zjarrfikëse me dy dalje dhe një pompë zjarrfikëse
- material lënde djegëse (dru, naftë dhe vajra, etj.) për tabakat e hekurit
- 6 manikinë për procedurat e kërkim shpëtimit
- 6 shllanga zjarrfikëse (65 mm diameter)
- 3 shllanga zjarrfikëse (38 mm diameter)
- 2 piptha (hedhësa) zjarrfikësa (1 standard, 1 hedhës të pulverizuar)
- mbajtës mekanik të shpërndarjes së shkumës
- 1 prodhues me shtrirje të lartë dhe depozitë shhkumë
- 2 fikës zjarri me ujë (9 litra)
- 6 fikse zjarri me shkumë (9 litra)
- 6 fikëse zjarri me dioksid karboni (5 kilogram)
- 10 fikëse zjarri me pluhur (10 kilogram)
- rimbushje për fikset e zjarrit
- 30 komplete veshjesh mbrotëse, kominoshe, doreza, çizme zjarrdruuese, helmeta dhe mushama
- 25 komplete aparate frymëmarrje, me komplete bombolash rezervë dhe vegla mirëmbajtje

- 2 litarë zjarrdurues sigurie me nyjet (36 m të gjatë)
- prodhues tymi
- helmata për tym me pompë ajri
- një dush në vendin e praktikës
- 1 barrelë
- 1 komplet të ndihmës së parë
- 1 komplet rigjallërimi me njësinë e thithjes së oksigjenit
- 2 veshje zjarr-mbrojtëse
- 2 helmata me mbrojtje të fytyrës dhe qafës
- 2 sopata të luftës kundra zjarrit
- lloje të ndryshme detektorësh që përdoren në anije
- tregues për rrugëkalimet e largimit në ambjentin e praktiki

3. Moduli: “Ndhurma e parë elementare”

Profili mësimor: Shërbime detare në kuvertë

Niveli: V i KSHK IV

Kodi: M-30-1037-14

Qëllimi i modulit Një modul teorik e praktik që i pajis nxënësit/detarët me njohuri e aftësi për të ndërmarrë veprime të menjëhershme me t’u paraqitur një aksident apo emergjencë tjetër mjekësore në bordin anijes.

Metoda e trajnimit: Leksione teorike dhe praktikë në klasë duke demonstruar me paisjet përkatëse të duhura për zhvillimin e kursit.

Kërkesa të veçanta: Nuk ka ndonjë kërkesë të veçantë për ndjekjen e këtij kursi.

Kohëzgjatja e modulit: Moduli parashikohet të zgjasë 18 orë paralelisht teori dhe praktikë.

Provimi: Pjesëmarrësit duhet të kalojnë në provim për dijet teorike dhe aftësitë praktike të kërkesave të modulit.

Tema /Veprimtaria që do të zhvillohet

Parime të Përgjithshme

- **Demonstrimi mbi mënyrën e dhënies së alarmit.**
- **Përcaktimi se në emergjenca, parësore është siguria vetjake.**
- **Përshkrimi i rasteve të masave të menjëhershme që duhet të merren në rastet e emergjencave.**
- **Përcaktimi i përmbajtjes në Listëkontrollin e emergjencave si**
 - Vlerësimi i situatës së aksidentit;
 - Vlerësimi i rreziqeve për veten;
 - Pa vetëdija;
 - Ndalimi i frymëmarrjes;
 - Gjakosje e rëndë;
 - Shpëtimi i rastësishëm dhe raportimi i emergjencës;

Struktura e trupit dhe funksionet e tij

- **Përshkrimi i strukturës së trupit duke u fokusuar tek:**
 - Skeleti;
 - Nyjet, Muskujt dhe tendinat;
Organet madhore (truri, zemra, mushkëritë, etj);
 - Sitemet e Qarkullimit;
- **Përshkrimi me fjalë të thjeshta të funksioneve të pjesëve të trupit që formojnë strukturën e tij.**

Pozicionimi i Viktimës

- **Përshkrimi i procedurave të përshtatshme për pozicionimin e viktimës në rastet e emergjencës, në veçanti:**
 - Pozicionin e gjetjes;
 - Pozicionin e ringjalljes;

- **Demostrimin e procedurave të duhura për pozicionimin e viktimave..**

Viktima e Pavetëdijshme

- **Njohja e shenjave dhe rreziku i pavetëdijs.**
- **Aplikimi i masave të duhura duke përfshirë:**
 - Mbajtjen të lirë të rrugëve të ajrimit;
 - Pozicionimin e viktimës së pavetëdijshme;
 - Veprimi në rastet e ndalimit të frymëmarrjes apo rrahjeve të zemrës;
JO ushqimeve, lëngjeve apo substancave të tjera nga goja.

Ringjallja

- **Njohja e domosdoshmërisë për një ringjallje imediate në raste të ndryshme të emergjencës.**
- **Aplikimi i procedurave të ringjalljes vetëm, ose me ndihmën e një njeriu tjetër për një kohë minimale prej dhjetë minutash duke përfshirë:**
 - Kontrollin e frymëmarrjes;
 - Funkcionin e shtrirjes prapa të kokës;
 - Frymëmarrja gojë me gojë;
 - Frymëmarrja gojë me hundë;
 - Ndalimi i zemrës.
- **Në rastet e ndalimit të zemrës, tregohen metodat dhe faktorët kufizues të:**
 - Masazhit kardiak;
 - Ringjalljes kardiopulmonare (CPR).

Gjakosja

- **Njohja e rreziqeve të gjakosjes.**
- **Aplikimi i masave të duhura fillestare për të minimizuar gjakosjen në mënyrë të veçantë në rastet e:**
 - Gjakosjes së brendshme / jashtme;
 - Gjëndjes së shokut;
 - Aplikimit të shtypjes së jashtme dhe presionit;
 - Pozicionimi i Pacientit.

Menaxhimi i gjëndjes së shokut

- **Konstatimi i faktorëve kryesorë që shkaktojnë gjëndjen e shokut.**
- **Njohja e shenjave të shokut si:**
 - Ngjyra e fytyrës;
 - Ritmi dhe karakteri i pulsit.
- **Aplikimi i metodave të duhura për menaxhimin e gjëndjes së shokut.**
- **Njohja e metodave thelbësore për menaxhimin e gjëndjes së shokut si:**
 - Ndalimi i gjakosjes, mbrojtja nga të ftohtit;
 - Konsumimi menjëhere dhe i bollshëm i lëngjeve n.q.s. pacienti është i vetëdijshtëm;
 - Pozicionimi i Pacientit;
 - Jo cigares, Jo alkolit, Jo lëvizjes.

Djegjet, Përvëlimet dhe aksidentet e shkaktuara nga elektriciteti

- **Njohja e shenjave të djegjes dhe përvëlimeve dhe aksidentet e shkaktuara nga korenti elektrik.**
- **Aplikimi i masave të duhura për djegjet dhe përvëlimet:**
 - Ftohja e zonës së djegur sa më shpejt që të jetë e mundur.
- **Aplikimi i masave të duhura për djegjet me kimikate:**
 - Heqjen e rrobave dhe shpëlarja me ujë të bollshëm.
- **Aplikimi i masave të duhura për djegjet me kimikate të syve:**

- Shpëlarja e syve me ujë të bollshëm.
- **Aplikimi i masave të duhura në aksidentet e shkaktuara nga korenti elektrik:**
 - Të eliminohen rreziqet për shpëtuesit, izolimi i viktimës;
 - Mbrojtja nga kolapsi, kontrolli i funksioneve jetësore.

Shpëtimi dhe transportimi i viktimës

- **Aplikimi i transportit të duhur vetëm, ose me ndihmën e një personi tjetër, duke marrë parasysh zonat e mbyllura dhe lartësitë e ndryshme në bordin e anijes.**
- **Identifikimi dhe përdorimi:**
 - Transporti me mjete rrethanore;
 - Transporti me barrelë;
 - Transporti me karrige;
 - Transporti me copë trekëndeshe;
 - Transporti i ilustruar në IMGS.
- **Njohja e rreziqeve të transportimit të pacientit me dëmtime të pelvisit dhe /ose shtyllës kurrizore dhe demonstrimin korrekt të procedurave të transportimit të këtyre viktimave.**

Tema të tjera

- **Fashimi**
 - Improvizimi i fashimit me mjete rrethanore;
 - Përdorimi i materialeve fashuese në pajimet e emergjencës;
 - Demonstrimi i përdorimit korrekt i fashave.
- **Zonat e mbyllura**
 - Njohja e rreziqeve gjatë hyrjes në këto zona;
 - Konstatimi se hapësirat e mbyllura mund të përmbajnë gazra të rrezikshëm ose mungesë O₂.
 - Marrjen e masave të duhura paraprake para hyrjes në këto zona.
- **Sëmundjet infektive**
 - Njohja e rreziqeve nga gjaku apo sekrecionet nga persona që vuajnë nga sëmundjet infektive, në mënyrë të veçantë hepatitet dhe të sëmurët me virusin HIV;
 - Marrjen e masave mbrojtëse vetjake kur ke të bësh me këta persona;
 - Përshkrimi i hollësishëm i procedurave të duhura për sistemin e gjakut dhe sekrecioneve në raste të tilla.
- **Shëndeti dhe higjiena Personale**
 - Aplikimi i rregullave të thjeshta për mirëmbajtjen e shëndetit dhe pastërtisë vetjake.

Materialet Mësimore

- Klasë për pjesën teorike me projektor ku mund të shihen materialet audio vizive apo me slaidera. N
- Jë tavolinë me përmasa 3 m me 1 m.
- Dhoma më për instrimin praktik, demonstrimin dhe aplikacionet.
- Pajimet e mëposhtme duhet të jenë të disponueshme:
- Kutia e ndihmës mjekësore të anijes me përmbajtjen
- Fasha për krahun, duart, këmbët e dëmtuara, etj.
- Veshje, fasha
- Një manikim me përmasa njeriu për trajnimin e frymëdhënies praktike
- Barrelë

4. Moduli: “Siguria personale dhe përgjegjësia shoqërore”

Profili mësimor: Shërbime detare në kuvertë

Niveli: V i KSHK

Kodi: M-30-1038-14

Qëllimi i modulit: Një modul teorik e praktik që i pajis nxënësit/detarët me njohuri e aftësi për mbajtjen e një mjedisi të sigurtë pune ndërkohë që bashkëpunohet dhe ndihmohen të tjerët në anije në një mënyrë shoqërore reagimi.

Metoda e trajnimit: Trajnim teorik e praktik së bashku me paisjet shoqërore.

Kërkesa të veçanta: Nuk ka kërkesa të veçanta për ndjekjen e këtij moduli.

Kohëzgjatja e modulit: Moduli parashikohet të zgjasë 18 orë.

Provimi: Pjesëmarrësit duhet të kalojnë në provim për dijet teorike dhe aftësitë praktike të kërkesave të modulit.

Tema/Veprimtaria që do të zhvillohet

Vëzhgim mbi praktikat e sigurta në punë
--

- **Hyrje:**
 - Njohje mbi qëllimet dhe objektivat e kursit
- **Rëndësia e modulit:**
 - Konstatime që puna në anije është profesion i rrezikshëm ku ç’dokush është i ekspozuar që në momentin që personat venë këmbën në bord.
 - Shpjegimi i domosdoshmërisë së kuptimit të rreziqeve në bord si dhe pajimet e duhura për t’i parandaluar rreziqet.
- **Familiariazimi me anijen:**
 - Identifikimi i rreziqeve në lidhje me: shkallët e hypjes, tambureta e bashit dhe kuverta e qiçit, arganot, spirancat dhe vinxhat, bigat dhe vinxhat, rubinetat dhe sistemet e tubacioneve (tek anijet çisternë), hoteleria, ura e komandimit dhe lokali i mashinës.
- **Natyra e rreziqeve në bordin e anijes:**
 - Radhitja e rreziqeve të ndryshme në bordin e anijes si: rrëshqitje, pengesat dhe rëniet nga sipërfaqet e rreshqitshme (vaj, graso, plehra, ujë, akull, etj.) ose pengesat (tubacionet, kabllot e saldimit, cimat, kavot, etj) dëmtimet e kokës gjatë hyrjeve në dyer të ulta, paisje apo materiale që bien etj, rëniet nëpër bukaporta, koridoret e pa rrethuar, mungesat e zgarave etj, ngecja e veshjeve apo gishtave tek pjesët e lëvizshme, djegjet nga tubat e avullit, sipërfaqeve të nxehta, pikave të saldimit etj, dëmtimet e syve gjatë kepjes, saldimit, punimet me kimikate etj, dëmtimet dhe rreshkitjet e materialeve të pasiguruara gjatë lëvizjeve të anijes në mot të keq, rreziqet e motit ekstrem, mungesa e oksigjenit në hapësira të mbyllura, prezenca e dioksidit të karbonit dhe gazrave toksike, rreziqet e kimikateve të përdorura në bord, zjarri, përplasja/rënia në cekinë /përmbytja e lokaleve/mbytyjen, piratët dhe klandestinët.

- **Pajimet që gjenden në bord për njehsimin e këtyre rreziqeve dhe radhitja e artikujve sipas grupeve:**
 - Paisjet personale mbrojtëse - helmeta/doreza/kepucët e sigurisë/maskat/maskat dhe aparatet e frymëmarrjes, veshjet mbrojtëse, aparaturat vetëmbajtëse.
 - Paisjet e shpëtimit të jetës – xhaketat/rrathët/sanallet/trapet/pushka e pandulit /EPIRB/SART/Veshjet termike/kostumet e zhytjes.
 - Paisjet zjarrfikëse – shllangat/pipthat/hidranti/fikësat e dorës/sopata/sistemi i sinjalizimit të zjarrit /sistemet stacionare të fikjes.
 - Paisjet mjeksore – ringjalles/barrela/medikamentet/paisjet mjeksore.
- **Demonstrimi i përdorimit të PPM (Pajisjeve Personale Mbrojtëse)**
 - Mbrojtja e kokës – rëndësia e helmetes dhe funksionet në çdo pjesë, kur vishet helmeta, mirëmbajtja e helmetës.
 - Dorezat – nevoja e dorezave, tipet e dorezave dhe përshtatshmëria e çdo tipi me llojin e punës.
 - Mbrojtja e syve – rëndësia e mbrojtjes së syve, shkaqet e dëmtimit të syve, tipet e mbrojtësave të syve dhe diferenca midis tyre;
 - Mbrojtja e veshëve – rreziku i zhurmave të tepërta, tipet e mbrojtësve të veshëve;
 - Mbrojtja e frymëmarrjes – nevoja për mbrojtjen e frymëmarrjes, tipet e mbrojtësve dhe përdorimi i duhur, përkrahimi dhe kontrollat përpara përdorimit;
 - Veshjet e sigurisë për këmbët – nevoja për këpucët e sigurisë, veçoritë e këpucëve të sigurta dhe ndryshimet me këpucët normale;
 - Kompletet e sigurisë.
- **Detajimi i operacioneve që zhvillohen në bord të cilat mund të jenë të rrezikshme për ekuipazhin apo anijen:**
 - Ngarkim/shkarkimi i mallrave;
 - Akostim/ç'akostimi;
 - Punimet në lartësi;
 - Përdorimi i kimikateve;
 - Shërbimi dhe mirëmbajtja në sallën e mashinës;
 - Ngritja e peshave (manuale apo mekanike);
 - Hyrja në vende të mbyllura;
 - Punët në nxehtësi;
 - Operacionet anti-piraterisë dhe anti-klanësive.
- **Ngarkimi/Shkarkimi i mallrave**
 - Radhitja e llojeve të ndryshme të anijeve – mallrave të përgjithshme/mallrave rinfuzo /konteinereve /ro-ro dhe makina/ kimikiere/ gaziere/ pasagjere;
 - Konstatimi që në përgjithësi në anijet e mallrave të përgjithshme, mallrave rinfuzo dhe konteinere malli ngarkohet dhe shkarkohet me anë të vinxhave ose bigave. Ngarkesat rinfuzo ngarkohen në anije dhe me anë të transportierëve;
 - Konstatime për rreziqet në këto anije, në hambar dhe bankinë nga peshat e ngritura në ajër nga vinxhat apo kamionët, pirunët etj.;
 - Konstatimi që asnjë person i paautorizuar nuk lejohet të punojë në zonë;
 - Konstatimi që ekuipazhi i anijes duhet të përdorë krahun e detit për të kaluar në kuvertë;
 - Konstatimi që anijet ro-ro dhe makina mbajtëse kanë kuverta të ndryshme të lidhura me rampa dhe ngarkesa udhëton nëpërmjet këtyre rampave nëpër kuverta;
 - Konstatimi që ngarkesa lëviz me shpejtësi, prandaj ndalohet qëndrimi në ato vende;
 - Konstatimi që në çisterna, kimikiere apo gaziere, ngarkesa është e lëngshme dhe ngarkohet /shkarkohet me anë të pompave dhe tubacioneve;
 - Konstatimi që rreziku më i madh është nga gasi, që mund të jetë i ndezshëm, toksik

apo të ketë mungesë oksigjeni. Personat që punojnë në këto lloje anijesh, duhet të kenë njohuri të veçanta për rreziqet dhe procedurat e punës, që mbulohet nga kursi i familjarizimit në anije çisternë;

- Konstatimi që dhe anijet pasagjere mund të mbajnë makina, ngarkesë tjetër apo trena;
- Konstatimi që përveç stafit të kuvertës apo mashinës mund të ketë edhe staf shtesë si kuzhinierë, kamarierë, pastrues, shitës, argëtues, mjekë apo shërbyes fetar etj. dhe ky personel që punon në anije duhet të ketë njohuri mbi menaxhimin e turmave, veçanërisht në rastet e emergjencave.
- **Akostimi – ç’akostimi**
 - Përshkrimi i akostimit si lidhje e anijes në kalatë;
 - Konstatimi që litarët që përdoren për të lidhur anijen quhen cima apo kavo ormegjimi;
 - Duke përdorur diagrama, tregohen cimat e bashit dhe ato të kiçit, springu, cingu etj.;
 - Konstatimi që cimat e ormegjimit, janë cima sintetike dhe të rënda, me diameter rreth 100 mm e më shumë dhe kavot janë shumë të rënda, me diameter rreth 50 mm, përmasat varen nga madhësia e anijes;
 - Konstatimi që paisjet e ormegjimit – cima, kavo, pandula, stopues, gadinat, vinxhat etj duhet të kontrollohen që të jenë në gjendje të mirë pune para përdorimit;
 - Konstatimi që anija mund të afrohet në bankinë duke vendosur në tokë një apo më shumë cima dhe duke i tërhequr ato me anë të vinxhave të anijes;
 - Konstatimi që këto cima apo kavo janë të rrezikshme gjatë manovrimit dhe është e rrezikshme të qëndrosh afër tyre, veçanërisht kur ato janë të tendosura;
 - Konstatimi që kur cimat apo kavot janë të tendosura, ato mund të fshikullojnë njeriun deri në dëmtim apo vdekje;
 - Personat që merren me operacionin e akostim-ç’akostimit duhet të jenë të kujdesshëm dhe të vetëdijshëm për rreziqet dhe duhet të qëndrojnë larg cimave /kavove të tendosura;
 - Konstatimi që operimi bëhet më i vështirë dhe i rrezikshëm gjatë erërave të forta, detit të rëndë apo dallgëzimit, shiut apo nevojës për shpejtësi në operim;
 - Konstatimi se personat që punojnë cimat/kavot, asnjëherë nuk duhet të qëndrojnë në drejtimin e tërheqjes;
 - Konstatimi që personat që operojnë me cimat tek tamburo, duhet t’u mbajë lirshëm atë dhe gjithmonë të jetë gati t’i japë boshen, ose duhet të rrëshqasi nën tension (“frymëdhënie e cimës”);
 - Konstatimi që cimat/kavot e ormegjimit duhet të kontrollohen në mënyrë konstante dhe gjithmonë të mirëmbahen;
 - Konstatimi që kujdes i veçantë duhet të tregohet kur: ngarkohet-shkarkohet me ritëm të lartë, ka lëvizje të mëdha baticë-zbaticë, rrymë të fortë, erë të fortë në kalatat e ekspozuara nga deti.
- **Hapësirat e mbyllura:**
 - Përcaktimi i hapësirave të mbyllura si hapësira ku mungon ventilimi dhe qarkullimi i ajrit;
 - Evidentimi i hapësirave të mbyllura në anije si forpiku, depot, koferdamet, tanket e ngarkësës, ballastet, afterpiku, tanket e naftës etj.
 - Evidentimi i rasteve të aksidenteve të ndodhur, në disa raste fatale si rrjedhim i neglizhencës gjatë hyrjeve nëpër tanke, kur personi bie në kontakt me atmosferë që dëmton frymëmarrjen ose është dëmtuar dhe nuk shpëtohet në kohë;
 - Ndarja e rreziqeve në : a)-rreziqe të atmosferës dhe b)-rreziqe fizike;

- Konstatimi që rreziku i atmosferës mund të rezultojë nga:-prezenca e hidrokarbureve; prezenca e gazrave ose mungesa e oksigjenit;
 - Konstatimi që nga prezenca e gazit të hidrokarbureve, rritet rreziku i intoksikimit apo i zjarrit;
 - Konstatimi që avujt e hidrokarbureve janë prezente kur ka: rrjedhje të karburantit; mbetjet në hapësirat e tankut; mbetjet nëpër tubacionet etj.;
 - Konstatimi që gaze të tjera si NO, NO₂, SO₂, CO, benzeni, H₂S etj mund të jenë rreziqe toksike;
 - Konstatimi që këto gazra mund të çlirohen në anije nga-ngarkesa, rezervat apo operimi;
 - Shpjegimi që rreziku toksik është i dëmshëm ose helmues për trupin; Shpjegimi i vlerës së kufirit të lejuar dhe konstatimi se vlera e tij nëpër lokale nuk duhet t'a kalojë këtë normë;
 - Konstatimi që atmosfera mund të ketë mungesë oksigjeni në rastet e mëposhtme – futja e gazeve të plogët, ndryshku, tharje e bojës, hidrogjeni, lëngjet larëse për pajisjet elektrike, solventët, ftohja, djegja, mbytja me CO₂ për të shuar zjarre, saldimi dhe prerja e metaleve pa ventilimin përkates, puna e një motori në ambiente të mbyllura, kalbja e lëndëve organike;
 - Konstatimi që mungesa e oksigjenit mund të çojë në asfiksi;
 - Shpjegimi që rreziku fizik mund t'a bëjë personin të dëmtohet fizikisht deri në dëmtim fatal;
 - Konstatimi që simptomat fillojnë me marramëndje, marrje fryme, pavetëdije dhe plogështi dhe vazhdon deri në dëmtime të trurit duke shkaktuar humbje të kujtesës, paqëndrueshmëri mendore, paraliza, gjendje kome, vdekje;
 - Konstatimi që rreziqet fizike përfshijnë: errësirën, shkallë të pasiguruara, sipërfaqet e rrëshkitshme, pengesat, gropa të hapura dhe të paruajtura, objektet e pa siguruara etj;
 - Konstatimi i marrjes së masave paraprake që duhet të ndiqen para hyrjes në hapësira të mbyllura:
 - a) Ndjekja e përpiktë e aplikimit të lejes së punës;
 - b) Ventilimi i plotë i lokalit deri në limitet e pranuar të atmosferës;
 - c) Duhet të ketë oksigjen të mjaftueshëm për të mbijetuar;
 - d) Gaz të ndezshëm i pamjaftueshëm;
 - e) Gazi toksik duhet të jetë më pak se kufiri i vlerës së lejuar (TVL).
 - Konstatimi që duhet të përdoren paisjet e duhura të mbrojtjes si - rroba pune, helmeta, këpucë të sigurta, drita dore të aprovuara, vegla jo shkëndijëdhënëse etj.;
 - Konstatimi se duhet të ushtrohet vigjilencë dhe gadishmëri, atmosfera duhet të monitorohet vazhdimisht. Të gjitha masat e marra duhet të jenë në mbikqyrje gjatë kryerjes së punës;
 - Konstatimi që personeli duhet të jetë i kujdesshem kundrejt vetëbesimit dhe neglizhencës;
 - Konstatimi që pas përdorimit veshjet mbrojtëse dhe vendi i punës duhet të pastrohen dhe të mbahen pastër dhe me rregull;
 - Diskutim i shkurtër mbi pikat e lejes së punës në hapësirat e mbyllura.
- **Puna në nxehtësi**
 - Përkufizimi që puna në nxehtësi si të gjitha punët që çlirojnë nxehtësi apo shkëndija me temperaturë të mjaftueshme apo intensitet të ndezë gaz të ndezshëm;
 - Evidentimi i punëve në nxehtësi si: saldimi, prerja me O₂ ose gaz, djegjes, kepja apo përdorimi i mjeteve që gjenerojnë nxehtësi, zjarret e pambrojtur, harqet elektrike ose shkëndijat;

- Evidentimi rreziqeve të punëve në nxehtësi si zjarri, shpërthimi, dëmtime nga nxehtësia, dëmtime nga drita e fortë (rrezet ultraviolet tek sytë), dhe dëmtimi nga shokimi për personelin;
- Diskutim i shkurtër mbi pikat e lejes së punës në nxehtësi;
- Grupimi i zonave në anije ku kryhet puna në nxehtësi sipas shkallës së rritjes së rrezikut si: reparti i mekanikëve, salla e mashinës, depo e bashit, lokali timonit dhe hoteleria, zona e ngarkesës dhe depo të tjera.
- **Puna në lartësi:**
 - Përshkrimi i punës në lartësi si punë që kryhet në një lartësi të konsiderueshme nga kuverta ku rreziku kryesor është rënia dhe dëmtimi;
 - Kostatimi që puna jashtë bordit konsiderohet si punë në lartësi;
 - Dhënia e shembujve të punëve të ndryshme që kryhen në anije, ku puna në lartësi është e nevojshme si p.sh. lyerja e urës së komandimit- dyrekët- salla e mashinës-kuverta-pastrimi dhe lyerja e fumajolit, grasatimi, mirëmbajtja dhe riparimi i radarit- kavot dhe agregatet e vinxhave apo bigave, kepja- lyerja- pastrimi dhe inspektimi i tankeve apo hambarëve, lyerja e veshjes së anijes- poshtë apo anash allabandës etj.
 - Evidentimi i disa rreziqeve gjatë punës në lartësi si: rënia nga lartësia për humbje të ekuilibrit, këputje e litarëve etj- dëmtime nga rënia e materialeve apo paisjeve, djegja për shkak të kontaktit me sipërfaqe të nxehta si fumajoli, emetimi gazrave toksikë apo dioksidit të karbonit nga fumajoli për shkak të djegjes apo shkumbimit, nxjerrjes së blozës etj, ekspozimi ndaj erës apo të ftohtit- rreziqet elektrike apo radiative;
 - Konstatimi se lajmërimi në fillim duhet t'i bëhet personit përgjegjës që ka lidhje me fillimin e punës p.sh. mekanikun e shërbimit kur punohet në afërsi të fumajolit për t'u mbrojtur nga bloza apo gazrat gjatë djegjes ndalimi i avullit tek sirena, lajmërimi i oficerit të shërbimit kur punohet afër radarit apo oficerin e radios kur punohet afër antenave të radios apo satelitit;
 - Konstatimi që përdorimi i aparaturave të cilat mund të bëhen rrezik gjatë punës duhet të kyçen apo kontrollohen nga oficeri përgjegjës;
 - Konstatimi që të gjitha këto kontrole apo procedura mund të mbulohen me një listë kontrolli apo leje pune;
 - Evidentimi i materialeve që përdoren gjatë punëve në lartësi si: litarët e sigurisë, karrigia e bocmanit, sofrat e drurit, rrjetat mbrojtëse, rrethi i shpëtimit, etj.;
 - Konstatimi që këto mjete, duhet të ruhen në vend të veçantë, larg nga bojrat apo kimikatet dhe nuk duhet të përdoren për qëllime të tjera;
 - Konstatimi që këto mjete, duhet të kontrollohen çdo herë, para përdorimit nga personi kompetent, për difekte të mundshme në dru dhe cima;
 - Kostatimi se nyjet, lidhjet dhe kthimet duhet të bëhen në mënyrë korrekte dhe të kujdesshme për të parandaluar rrëshqitjen në mënyrë të veçantë kur përdoren cima sintetike;
 - Konstatimi se shkallët apo karrigia e bocmanit nuk duhen të ulen/ngrihen me vinxh;
 - Konstatimi se pikat e lidhjes për cimat e sigurisë, duhet të jenë të forta dhe jo të lëvizshme;
 - Konstatimi se cimat nuk duhet të kalojnë nëpër sipërfaqe të nxehta apo të mprehta;
 - Konstatimi se rrjeta e sigurisë, duhet të vendoset sa herë që të jetë e mundur e sidomos poshtë skelave të varura;
 - Konstatimi se skelat duhet të jenë të siguruara kundrejt lëvizjes së anijes sidomos kur ato janë të varura;

- Konstatimi se puna në lartësi, nuk duhet të kryhet kur anija lundron me det të trazuar;
- Konstatimi se veglat dhe materialet, duket të kalohen me anë të kovave apo cimave dhe asnjëherë të hidhen;
- Konstatimi se ngjitja e zbritja e personelit duhet të bëhet me anë të shkallëve e jo me litar;
- Konstatimi se shkallët fikse, duhet të vendosen në një bazament të sigurtë;
- Konstatimi se veglat dhe materialet, duhet të sigurohen dhe jo të vendosen nëpër cepa, ku ato mund të bien;
- Konstatimi se njerezit pa eksperience dhe ata nën 18 vjeç, nuk duhet të punojnë në punët në lartësi apo jashtë bordit;
- Konstatimi që puna jashtë bordit, nuk duhet të kryhet kur anija është në lëvizje;
- Konstatimi se, si shtesë e mjeteve mbrojtëse normale, duhet të vishet dhe xhaketa e shpëtimit apo veshje pluskuese;
- Konstatimi se duhet të mbahet në gadishmëri dhe një rreth shpëtimi me cimë dhe dritë.

- **Shërbimi në mashinë dhe mirëmbajtja:**

- Tregimi i planeve të përgjithshme të një lokali mashine me ndihmën e videove, fotografive apo vizatimeve.
- Evidentimi i makinerive të vendosura në mashinë –motorin kryesor, motorat ndihmues, bolierat, kompresorët, pompat, motorrat, paisjet elektrike, etj.
- Konstatimi se në lokalin e mashinës, mund të jenë dhe paisje të tjera si: timoni, bateritë, frigoriferat, paisjet hidraulike apo pneumatike, radiot marrëse-dhënëse të dorës, etj.;
- Konstatimi që dëmtimet e mundshëm në mashinë janë: djegja gjatë kontaktit me tubat e avullit, sipërfaqet e nxehta, pikat e saldimit, etj– dëmtimet e kokës gjatë përplasjes me objekte apo objekte që bien- rrëshkitjet, pengimet dhe rëniet nëpër shkallë, nga hapja e mbulesave të dyshemesë- dëmtimi i dëgjimit si rezultat i nivelit të lartë të zhurmave në mashinë – kontakti me pjesët e lëvizshme të makinerive, si volantë, rripa apo akse etj.;
- Konstatimi që përdorimi i veshjeve mbrojtëse të duhura është absolutisht i nevojshëm;
- Konstatimi se aksidentet mund të mënjanoen vetëm kur ka administrim të mirë të vendit të punës dhe praktika të sigurta pune;
- Dhënia e shembujve si :
 - 1) Trajtimin e menjëhershëm të rrjedhjeve vajore apo ujore;
 - 2) Rrjedhjet e vajit të pastrohen menjëherë dhe materiali izolues të ndërrohet menjëherë;
 - 3) Leckat e vajit apo mbetjet e leckave duhet të mbahen në kuti të mbyllura dhe jo të lihen gjithkund duke rrezikuar vetëndezjen;
 - 4) Përkujdesi për veglat e punës që ato mos të bien apo humbin nën mbulesat e dyshemesë dhe duhet të mblidhen dhe sistemohen direkt pas punës;
 - 5) Mbulesat e pjesëve të lëvizshme duhet të jenë gjithmonë në pozicione dhe në gjendje të mirë;
 - 6) Paisjet, materialet në depo dhe pjesët e makinerive të hapura duhet të bragohen dhe sigurohen kundër lëvizjes;

- 7) Të gjitha vendet e mashinës duhet të jenë të ndriçuara mirë;
 - 8) Sentinat duhet të mbahen të pastra dhe të thata;
 - 9) Mbulesat e dyshemesë nuk duhet të lihen hapur n.q.s. zona nuk është e mbrojtur nga rrethim apo të jenë vendosur tabela paralajmërimi;
 - 10) Hyrja për tek paisjet zjarrfikëse, rrugët e largimit dhe daljet e emergjencës nuk duhet të zihen nga rezervat apo paisjet.
- Konstatimi se praktikat e sigurta të punës duhet të përmbajnë:- bllokimin e makinerive nën riparim për të parandaluar ndezjen e pa lajmëruar – kontrollet paraprake për paisjet e ngritjes para përdorimit – kalibrimi i saktë dhe testimi i paisjeve – kontrollet paraprake për hyrjen në hapësirat e mbyllura-përdorimi i veglave të duhura për punën dhe mënyra e duhur e përdorimit.
- **Mardhëniet ndërpersonale (Inter Personal Relations - IPR)**
 - Konstatimi se mardhëniet e mira e bëjnë jetën e detarëve më të rehatshme, të shëndetshme dhe më të sigurtë nga pikpamja e aksidenteve;
 - Përshkrimi i elementëve që ndihmojnë në mardhënie më të mira si: - politikat e kompanisë – funksionimi i menaxhimit të anijes – qartësia e përgjegjesive duke i'u referuar funksioneve në anije - struktura dhe shpërndarja e autoritetit – rëndësia e kuptimit të nevojave etj.;
 - Konstatimi se çdokush duhet të respektojë individualitetin e tjetrit, vlerat, kulturën dhe llojin e punës;
 - Konstatimi që komunikimi i hapur do të nxisë përmirësimin e mardhënieve ndërpersonale;
 - Kostatimi se në ambientet e anijes kërkohet IPR më e mirë gjatë shërbimit dhe pushimit;
 - Përshkrimi i metodave të përmirësimit të IPR në bord nga: prezantimi dhe mirëkuptimi me njëri-tjetrin, angazhimi i oficerave të rinj – vlerësimi i diferencave individuale - drejtësi në mardhëniet me personelin–vlerësimin e vërtetë gjatë raportimit– disiplina.
 - **Ndërtimi i Skuadrës**
 - Konstatimi se operimet në bord janë punë skuadre dhe efektiviteti varet në angazhimin e çdonjërit nga antarët e skuadrës;
 - Konstatimi se skuadra ndihmon në vendimarrje të drejta;
 - Përshkrimi: skuadra/ objektivat – roli individual i antarëve,- nevoja për bashkim;
 - Evidentimi i dëmtimeve të operimit në skuadër;
 - Diskutime mbi pasojat si: shtrembërimi i objektivave - sjellje e patolerushme të antarëve – grupeve – problemeve të egos – probleme të komunikimit – problemeve fizike – trajtimi i fyerjeve;
 - Përshkrimi i çdo pike në referencë me ambientin e bordit të anijes.
 - **Puna e Skuadrës**
 - Shpjegimi se puna në skuadër është thelbësore në anije për disa arsye si:
 - a) Kompanitë detare, trajtojnë një numër anijesh të cilat në momente të ndryshme çohen në distanca të mëdha anembanë globit;
 - b) kur bëhet një udhëtim i gjatë, anija mund të takojë ndryshime klimaterike të konsiderueshme të cilat ndikojnë tek psikologjia dhe shëndeti i ekuipazhit;
 - c) anijet operohen 24 orë në 24 dhe për këtë ekipazhi duhet të organizojë shërbimet në mënyrë që njerëzit në bord të jenë të shlodhur dhe gati për punë;
 - d) ekuipazhi në anije duhet të organizohet që të operojë anijen në mënyrë të sigurtë dhe efektive me të gjitha funksionet si:
 - shërbimi në det dhe port (kuvertë & mashinë);

- përpunimi i ngarkesës;
 - mirëmbajtja e veshjes së jashtme, makinerive dhe aparaturave;
 - listë-kontrollet e sigurisë, ushtrimet dhe veprimet e emergjencës, përfshirë mbrojtjen e mjedisit;
 - riparim/dokimi;
 - rezervat, ushqimi, administrimi;
 - komunikimi anije-breg-anije;
 - ekuipazhi duhet të jetë në gjëndje të operojë me një nivel të lartë përgjegjësie dhe fleksibiliteti .
- **Themelet e komunikimit**
 - Konstatimi që komunikimi i mirë është elementi esencial i sigurisë dhe parandalimit të ndotjes së mjedisit detar nga ndotjet e anijeve;
 - Konstatimi që bashkëpunimi midis njerëzve arrihet nga komunikimi efektiv;
 - Konstatimi që komunikimi efektiv është elementi bazë për mbijetesën njerëzore;
 - Konstatimi që gjuha është një mjet për të transmetuar idetë, pikpamjet, instruksionet etj.
 - **Metodat e komunikimit**
 - Evidentimi i elementëve bazë të komunikimit si :dërguesi, marrësi, llojet dhe mënyrat e transmetimit, barrierat e komunikimit, reagimi;
 - Konstatimi se reagimi është esencial në komunikimin në anije;
 - Evidentimi i metodave të komunikimit;
 - Klasifikimi i tyre sipas listës së mëposhtme: - verbale p.sh. leximi, bisedimi, shkrimi dhe çdo komunikim duke përdorur fjalët,- jo verbale p.sh gjuha e trupit, tingujt, gjestet,- ironia p.sh. shenja, figura, diagrama, piktura dhe fotografi.
 - Konstatimi se të treja metodat duhet të përdoren në mënyrë efikase për një kuptueshmeri sa më të mirë;
 - Konstatimi se komunikimi verbal përfshin të gjitha komunikimet që përmbajnë fjalë, përfshirë leximin, shkrimin dhe bisedimin;
 - Konstatimi se gjuha e trupit dhe simbolet janë mënyra më të fuqishme se mënyrat verbale.
 - **Barrierat në komunikim**
 - Konstatimi se gjithmonë ka barriera në çdo hap të procesit të komunikimit;
 - Evidentimi i barrierave si:-shkalla e konceptit të dhënësit- mënyra e transmetimit- lloji i transmetimit - kapaciteti i marrësit - shkalla e konceptimit të marrësit - shkalla e reagimit –marrja e reagimit nga transmetuesi;
 - Demonstrimi i barrierave të mësipërme.
 - **Zotësia për transmetimin efektiv**
 - Konstatimi që komunikimi efektiv qëndron në fillim me dërguesin;
 - Konstatimi që dërguesi duhet të shpjegojë qëllimin e komunikimit;
 - Rëndësia e kohës, vendit, dhe personit të adresuar në kontekstin e nisjes së komunikimit;
 - Konstatimi i rëndësisë së gjuhës dhe fjalorit, p.sh. përdorimi i fjalorit detar anglisht;
 - Konstatimi se kuptimi i barrierave në komunikim ndihmon në një transmetim me të mirë;
 - Konstatimi që dërguesi duhet të jetë i aftë të flasë, shkruajë, skicojë në mendje. Efektive dhe të përdorë mjetet e sinjalizimit;
 - Përshkrimi që efektiviteti i transmetimit mund të verifikohet me reagimin e marrësit;
 - Përshkrimi që përgjegjësia qëndron tek dërguesi.
 - **Zotësia efektive e të kuptuarit**

- Konstatimi se të kuptuarit është përgjegjësi e marrësit;
- Shpjegimi i ndryshimit midis të kuptuarit kundrejt dëgjimit;
- Demonstrimi mbi ndryshimin midis të kuptuarit dhe dëgjimit;
- Konstatimi se kuptimi i barrierave të të kuptuarit përmirëson kapacitetin e të kuptuarit;
- Konstatimi se ka barriera të brëndshme dhe të jashtme të kuptimit dhe vlerësimi i efektit të barrierave për çka u tha më lart;
- Njerëzit janë në gjëndje të flasin rreth 150 fjalë në min. e të dëgjojnë rreth 1000 fjalë në min.;
- Konstatimi që ato plogështohen në 850 fjalë për minutë, si rezultat i shpërqëndrimit;
- Konstatimi se gjatë kësaj kohe të plogështisë folësi duhet t'a përdorë për gjuhën e trupit dhe sinjale të tjera;
- **Efektet dhe rezultatet e komunikimit të gabuar**
 - Konstatimi që komunikimi i gabuar mund të dëmtojë sigurinë e jetës, pronës dhe ambjentit;
 - Konstatimi që komunikimi i gabuar shkakton probleme njerëzore dhe të mardhënieve në bord;
 - Konstatimi që komunikimi i papërshtatshëm shkakton stres, humbje kohe, humbje të energjie dhe uljen e efiçencës në anije;
 - Demonstrimi i shkaqeve/efekteve me anë të ushtrimit.
- **Përmbledhje mbi komunikimin**
 - Konstatimi që komunikimi efektiv krijon një atmosferë që përçon punë të sigurtë, harmoni dhe mardhënie sociale të mira midis ekuipazhit;
 - Konstatimi se zakonet, vlerat e sjelljet mund të ndryshojnë nga komunikimi efektiv dhe njohja e bazave të mardhënieve ndërpersonale, aftësitë e të mësuarit dhe të qenurit në skuadër.
- **Shpjegimi i termit “EMERGJENCë”**
 - Theksimi se emergjenca është situatë ku rreziku është i afërt si: humbja e jetës, dëmtimi, humbja apo dëmtimi i pronës, apo dëmtimi i mjedisit;
 - Theksimi i nevojës për veprim të menjëhershëm në raste emergjece;
 - Evidentimi i emergjencave të ndryshme që mund të ndodhin në anije si: zjarr, përplasje, njeriu në det, futje e ujit, ndotje vaji, etj.;
 - Përshkrimi i planeve në bord të anijes si reagim ndaj emergjencave të përmendura më sipër;
 - Konstatimi i sistemeve të alarmeve që ndodhen në bord dhe vendodhjen e tyre: alarmi i përgjithëm i anijes, alarmi i zjarrit, sirena etj.;
 - Konstatimi i sinjaleve të emergjencës dhe kuptimin e tyre.
- **Ushtrimet dhe alarmet**
 - Përshkrimi i strukturës së përgjithshme të listës së apelit: detyrat specifike për ekuipazhin, ndarja e ekipazhit në skuadra, stacionet e grumbullimit etj.;
 - Konstatimi i veprimeve që duhet të kryhen në rastet e dëgjimit të alarmeve të emergjencës dhe n.q.s. zbulohet emergjencë reale si: veshja e vetvetes në mënyrën e duhur - vajtja në stacionin e grumbullimit - gjetja e llojit të emergjencës - veprimi i menjëhershëm sipas detyrave të listës së apelit.
- **Vlera dhe nevoja e ushtrimeve dhe trainimeve**
 - Konstatimi i tre aspekteve të nevojës për ushtrime dhe trainim si p.sh: nevojat e detyrueshme apo administrative - nevojat e operimit - gjëndja mendore.
- **Komunikimi i brëndshëm**

- Shpjegimi i komunikimeve të brendshme që janë në përdorim në anije në mënyrë të veçantë në situatat emergjente si psh: telefoni, telefon emergjence, qendër zëri, VHF, radio marrëse - dhënëse, alarmet e emergjencës etj.;
- Evidentimi i vendodhjes së tyre;
- Përshkrimi i rrugëve të shpëtimit të emergjencës në bord;
- Shpjegimi i nevojës së njohjes së numrit dhe vendodhjes të këtyre rrugëve.
- Organizimi në anije për marrjen e masave ndaj ndotjeve;
- Bashkëpunimi midis anijes dhe tokës për problemet e ndotjeve;
- Shpjegimi i detyrimit për të raportuar aksidentet e ndotjes;
- Shpjegimi se kur raportohen incidentet e ndotjes;
- Shpjegimi se kujt duhet t'i raportohen incidentet e ndotjes;
- Shpjegimi i strukturës së skuadrës së reagimit ndaj ndotjeve vajore dhe detyrat e vendosura për oficerat dhe ekuipazhin;
- Shpjegimi i masave të kontrollit të ndotjet vajore;
- Reagim i personelit të anijes për ndotjet vajore gjatë rasteve të ndryshme;
- Shpjegimi i rëndësisë të ushtrimeve për menaxhimin e ndotjeve të mjedisit detar;
- **Ndotja nga ujrat e zeza të anijes**
 - Përkufizimi i ujrave të zeza;
 - Rregullat trajtimit të ujrave të zeza dhe përjashtimet në vartësi të distancës nga bregu.
 - Detajet e trajtimit të ujrave të zeza në anije si: copëtimi, dizinfektimi, detaje të tankeve të mbledhjes si dhe të linjave depozituese dhe shkarkuese;
- **Ndotja nga mbetjet e ngurta**
 - Përkufizimi i mbetjeve të ngurta dhe derdhja e tyre jashtë zonave speciale /zonave të ndaluara;
- **Kontrolli i shkarkimeve të mbetjeve vajore nga salla e mashinës dhe tanket e ruajtjes**
 - Detaje të paisjeve të seperimit të karburanteve, kërkesat e përmbushjes sipas konventës së MARPOL (Marine Pollution);
- **Përmbajtja e regjistrit të trajtimit të hidrokarbureve**
 - Konstatimi i qëllimit të regjistrit dhe evidentimi i shënimeve që bëhen në ditar;
- **Kontrolli i shkarkimit të hidrokarbureve dhe zonat speciale**
 - Detaje të zonave speciale dhe në respekt me rregullin IX të MARPOL 73/78;
 - Kërkesat për mënyrat e parandalimit të ndotjeve hidrokarbure nga anijet që operojnë në zonat speciale.
- **Njohja me përmbajtjen e Shtojcës VI të MARPOL**
 - Konstatimi që Shtojca VI vendos limitet e emetimit të oksidit të squfurit dhe oksidit të nitrogjenit nga anijet.
- **Përcaktimi i termit ndotje**
 - Shpjegimi i ndotjes shkaktuar nga aktivitetet njerëzore dhe natyra;
 - Evidentimi i burimeve kryesore të ndotjes detare;
 - Konstatimi i ndotësve që hidhen në det nga anijet gjatë operimit apo në mënyra aksidentale;
 - Shpjegimi i shkaqeve të ndotjeve të ambjentit detar nga anijet si rezultat i: – përplasjet apo nxecjet në tokë - operacionet e çlirimit - hedhjet e pakontrolluara të plehrave dhe ujrave të zeza, larjet e tankeve, hedhjet e pakontrolluara të kimikateve, cekimi i ballasteve, etj.;
- **Efektet e ndotjes nga operimi dhe aksidentet në ambjentin detar**
 - Konstatimi i impaktit që i shkakton ndotja florës dhe faunës detare dhe zinxhiri i

- ushqimit;
- Shpjegimi i rreziqeve të shkaktuara nga mbetjet kimikate, plehrat, ujrat e zeza;
- Shpjegimi i rreziqeve për njerëzit, kafshët, dhe mirëqenia jetësore nga ndotja e ambientit detar.
- **Masat ndërkombëtare për parandalimin e ndotjeve, mënjanimin e tyre dhe magazinimin e ndotësve**
 - Përshkrim i shkurtër i përmbajtjes së MARPOL73/78;
 - Përshkrimi i ndarjes së ballasteve;
 - Pëshkrimi i kontruksionit të skafit të dyfishtë;
 - Përshkrimi i shërbimeve portuale për mbetjet e ndryshme (vajore, të ngurta etj);
 - Shpjegimi i trajtimit të ujrave të zeza dhe plani i menaxhimit të plehrave/librin e regjistrimit.
 - Përmbajtja dhe qëllimi i planit të emergjencave nga ndotjet vajore (Ship Oil Pollution Emergency Plan - SOPEP);
 - Trajtimi i plehrave në anije;
 - Mbështetja e politikës së sigurisë dhe mbrojtjes së ambjentit, ndihma ndaj detarëve në rastet e fatkeqësive, operacionet e kërkim shpëtimit dhe operacionet e parandalimeve të ndotjeve.
- **Kushtet e punësimit etj**
 - Përshkrimi i kushteve të punësimit si:kontrata e punës, të drejtat, kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare.
- **Droga dhe Alkooli**
 - Konstatimi që ka rregulla ndërkombëtare dhe kombëtare kundër përdorimit, mbajtjes dhe shpërndarjes së drogës apo alkoolit;
 - Konstatimi që ndëshkimi për këtë lloj veprimtarie mund të jetë shumë, shumë i rreptë;
 - Përshkrimi i disa rasteve të raportuara në kohë;
 - Përshkrimi i rreziqeve të përdorimit të drogës dhe alkoolit - si droga dhe alkooli dëmtojnë trupin e njeriut, me efektet e tyre dëmtuese dhe disa keq konceptime të përdorimit të alkoolit për t'u nxehur në kushte klimaterike të ftohta - rreziqet që janë me involvimin në trafikun/ kontrabandën e drogës - politika e kompanisë mbi drogën dhe alkoolin -narkotikët dhe gjurmimi i kontrabandës;
 - Përshkrimi mbi metodat e strukturave portuale, strukturave të flamurit dhe strukturave të tjera për zbulimin e konsumimit të drogës/alkoolit.
- **Shëndeti dhe higjena në bord**
 - Konstatimi se është një përgjegjësi normale për të gjithë në bord për t'u kujdesur për higjenën dhe nxitjen e një shëndeti të mirë;
 - Konstatimi se pastërtia dhe mirëmbajtja është themelore për një shëndet të mirë;
 - Konstatimi se personeli i anijes duhet të jetë i motivuar;
 - Konstatimi se ka një ndërlidhje të qartë midis nevojave njerëzore dhe motivimit të personelit;
 - Konstatimet që përcjellja e autoritetit janë një armë e fortë për motivimet e njerëzve.
- **Përmbledhje**
 - Përmbledhja e këtij moduli duke nënvizuar rëndësinë e IPR;
 - Konsatimi se përcjellja e autoritetit, besimi, dhe mardhëniet e mira janë motivuese;
 - Konstatimi që abuzimi me drogën dhe alkoolin mund të jetë i kushtueshem dhe mund të çojë në ndjekjen penale të anijes/personit dhe mund të rezultojë në zbarkimin deri në humbjen e karrieres nga detari.

- **Të drejtat dhe detyrat e ekuipazhit**

- Konstatimi që çdo anëtar i ekuipazhit ka përgjegjësi sociale kundrejt anijes së tij, vetvetes, kolegëve të tij, kompanisë dhe mjedisit;
- Përshkrimi i të drejtave si: të drejtën e mendimit, të drejtën e shprehjes së mendimit, të drejtën e qartësimit të komunikimeve për të koordinuar marrëdhëniet njerzore;
- Përshkrimi i detyrave të tij kundrejt punëdhënësit;
- Konstatimi që detaria është një entitet komercial dhe përfitimi financiar është pjesë e operimit;
- Konstatimi që i punësuari duhet t'i kryejë detyrat e tij në mënyrë të sinqertë dhe me të gjitha mundësitë e tij;
- Konstatimi që ai duhet të jetë përgjegjës kundrejt tre elementeve: -operimit detar, kompanisë, qeverisë dhe individuale;
- Konstatimi që në punë ka dinjitet;
- Konstatimi që ka përgjegjësi kundrejt:- bindjes-respektit-disiplinës dhe pajtimi me politikat e kompanisë ashtu siç deklarohet tek manualët e operimit, ndaj kërkesave dhe rregullave që qeverisin administratat detare të shteteve dhe kërkesat e detyrueshme legjislative;

Materialet Mësimore:

- Klasë për pjesën teorike me projektor ku mund të shihen materialet audio vizive apo me slaidera.
- Një tavolinë me përmasa 3m me 1m.

5. Moduli: “Trajnim për detarët me detyra të veçanta sigurie”

Profili mësimor: Shërbime detare në kuvertë

Niveli: V i KSHK

Kodi: M-30-1039-14

Qëllimi i modulit: Modul teorik dhe praktik që pajis nxënësit/detarët me njohuri dhe aftësi të nevojshme për tu imbarkuar në mjete lundrimi, për të ruajtur kushtet e caktuara në Planin e Sigurisë së Anijes, dalluar rreziqet dhe kërcënimet e sigurisë, ndërmarrë inspektime të rregullta sigurie dhe përdorin si duhet pajisjet dhe sistemet e sigurisë. Ky modul është në zbatim të kërkesave të Konventës për Standartet e Trajnimit, Çertifikimit dhe Atestimit për Detarët Seksioni A-VI paragrafi 4, Kodin përkatës të Konventës paragrafet 6-8.

Metoda e trajnimit: Fillimisht do të zhvillohen leksione teorike që do të zbatohen edhe në praktikë. Pjesa praktike do të zhvillohet në port dhe anije

Kërkesa të veçanta: Pjesëmarrësit duhet të jenë të aftë nga ana shëndetsore para ndjekjes së kursit, sipas kërkesave të Rregullit 1/9 të STCW95.

Kohezgjatja e modulit: Moduli parashikohet të zgjasë 18 orë.

Provimi: Pjesëmarrësit duhet të kalojnë në provim për dijet teorike dhe aftësitë praktike të kërkesave të modulit.

Tema/veprimtaria që do të zhvillohet

1. Hyrje

1.1. Këndvështrimi mbi modulën

1 përshkrim i temave dhe theksit të modulit

1.2. Kompetencat që do të arrihen

.1 përshkrim i kompetencave që do të arrihen në përfundim të modulit

1.3. Kërcënimet aktuale për sigurinë dhe mënyrat

1 përmbledhje e kërcënimeve për industrinë e transportit detar, siç janë:

- pirateria dhe sulmet e armatosura
- terrorizmi
- kontrabanda
- kalime të paligjshme të refugjatëve
- vjedhje mallrash
- dëme anësore

1.4. Operacionet e anijes dhe portet dhe kushtet

1.5 . Karakteristikat e natyrës intermodale të transportit dhe ndërfaqet midis mjeteve lundruese dhe mënyrave të tjera

2. Politika e Sigurisë Detare

2.1. Njohja me konventat ndërkombëtare përkatëse, kodet, dhe rekomandimet

1 përpyekjet e mëparshme të IMO-s për sigurinë detare siç janë:

- MSC/Circ.443;
- Akti SUA (Kufizimi i Veprimeve të Paligjshme), etj.

- .2 Reagimi i shpejtë të IMO-s në përmirësim të sigurisë detare pas 9/11
- 3 Ndryshimet në kapitullin XI të SOLAS-it dhe përmbajtja e Kodit ISPS
- 2.2. Familjarizimi me legjislacionin vendas dhe rregulloret përkatëse**
 - .1 Ligji Nr. 168/2013, datë 31.10.2013 “Për sigurinë në Anije dhe në Porte” si dhe legjislacionin tjetër përkatës në Republikën e Shqipërisë.
- 2.3. Përkufizime**
 - .1 përkufizime të:
 - Planit të Sigurisë së Anijes
 - Oficerit të Sigurisë së Kompanisë
 - Oficerit të Sigurisë së Anijes
 - Terminalit Portual
 - Ndërfaqjes Anije-Terminal portual
 - Ndërfaqjes Anije-Port
 - Vepritarisë nga Anija në anije
 - Oficerit të Sigurisë së Terminalit Portual
 - Autoritetit Shtetëror të Sigurisë Portuale
 - Subjektit të Njohur të Sigurimit
 - Deklaratës së Sigurisë
 - Incidentit të Sigurisë
 - Nivelit të Sigurisë
 - Të tre niveleve të sigurisë
- 2.4. Trajtimi i informacionit dhe komunikimeve me ndjeshmëri që ka lidhje me sigurinë**
 - 1 Përcaktim i informacionit me ndjeshmëri që ka lidhje me sigurinë dhe rëndësia e ruajtjes së tij si konfidencial

3. Përgjegjësitë e Sigurisë

- 3.1. Shtetet Kontraktuese**
 - 1 Përgjegjësitë e shteteve kontraktuese në lidhje me Kapitullin XI-2 të SOLAS-it dhe Kodin ISPS
- 3.2. Subjektet e Njohura të Sigurisë**
 - 1 Roli i Subjekteve të Njohura të Sigurisë
- 3.3. Kompania**
 - 1 Përgjegjësitë e kompanisë lidhur me:
 - garantimin që Kapiteni të ketë në anije dokumentacionin lidhur me ekuipazhimin e anijes dhe të punësimit të saj
 - garantimin që Plan i Sigurisë së Anijes përmban një deklaratë të qartë ku theksohet autoriteti i kapitenit
 - caktimin e një Oficeri të sigurisë së Kompanisë dhe një Oficeri Sigurie të Anijes dhe garantimin që atyre u jepet mbështetja e nevojshme për të plotësuar detyrat dhe përgjegjësitë
- 3.4. Anija**
 - 1 Përmbushja nga anija i kërkesave të Planit të Sigurisë së Anijes sipas nivelit të sigurisë të vendosur
- 3.5. Terminali Portual**
 - 1 Terminalët do të përmbushin kërkesat përkatëse të legjislacionit detar vendas, të Kapitullit XI-2 të SOLAS ‘74 i ndryshuar dhe të Kodit ISPS
 - .2 Terminali portual do të veprojë në përputhje me nivelin e sigurisë së vendosur nga Administrata Detare
- 3.6. Oficeri i Sigurisë së Anijes**
 - 1 Kompania do të caktojë një Oficer Sigurie Anije për çdo anije

- 2 Detyrat dhe përgjegjësitë e oficerit të Sugrisë së Anijes
- 3.7. Oficeri i Sigurisë së Kompanisë**
 - 1 Caktimi nga kompania i një Oficeri sigurie të Kompanisë
 - 2 Oficeri i caktuar i Sigurisë së Kompanisë mund të jetë për një ose më shumë anije me kusht që të identifikohet qartë se për cilat anije ai është përgjegjës
 - 3 Kompania mund të caktojë disa Oficerë sigurie Kompanie me kusht që të identifikohen qartë se cili është përgjegjës për çdo anije
 - 4 Detyrat dhe përgjegjësitë e Oficerit të Sigurisë së Kompanisë
- 3.8. Oficeri i Sigurisë së Terminalit Portual**
 - 1 oficeri i Sigurisë së Terminalit do të caktohet për çdo terminal
 - 2 një person mund të caktohet për një ose më shumë terminale
 - 3 detyrat dhe përgjegjësitë e Oficerit të Sigurisë së terminalit Portual
- 3.9. Personeli i Anijes me detyra të veçanta sigurie**
 - 1 Anëtarët e ekuipazhit përveç OSA mund t'u caktohen detyra sigurie në mbështetje të Planit të Sigurisë së Anijes
- 3.10. Personeli i Terminalit Portual me detyra të veçanta sigurie**
 - 1 Personeli i terminalit përveç OSTP mund t'i caktohen detyra sigurie në mbështetje të Planit të Sigurisë së Terminalit Portual
- 3.11. Personeli tjetër**
 - 1 Personeli tjetër i anijes dhe i terminalit portual mund të ketë një rol në përmirësim të sigurisë detare
 - 2 Personel tjetër përveç nga anija apo terminali portual mund të ketë një rol në përmirësim të sigurisë detare

4. Vlerësimi i Sigurisë së Anijes

- 4.1. Instrumentat e vlerësimit**
 - 1 Përdorimi i listë-kontrolleve për kryerjen e vlerësimit të sigurisë
- 4.2. Survejimi i sigurisë në vend**
 - 1 Përgatitjet e duhura paraprake për një survejm në vend
 - 2 Proçedurat, masat dhe operacionet që duhen vlerësuar në një survejm në vend
 - 3 Aspektet e sigurisë në vizatimet e anijes
 - 4 Ndarja e survejimit në seksionet e mëposhtme:
 - Siguria Fizike
 - Siguria Strukturore
 - Sistemet e Mbrojtjes së Personelit
 - Politikat Proçeduraliale
 - Sistemet e Radios dhe Telekomunikacionit
 - Zona të tjera
 - 5 Rëndësia dhe elementët e sigurisë fizike në mjetet e lundrimit
 - 6 Rëndësia integritetit strukturor për anijet dhe struktura të tjera
 - 7 Përbërësit dhe operacionet e sistemeve për të mbrojtur personelin e anijes
 - 8 Roli i proçedurave korrekte në parandalimin dhe zbutjen e incidenteve të sigurisë
 - 9 Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe sistemeve të komunikimit në operacionet e anijes për të ruajtur sigurinë
 - 10 Identifikimi i zonave që, nëse dëmtohen apo përdoren për mbikqyrje të palejuar, mund të paraqesin rrezik ndaj njerëzve, pronës, apo operacioneve në anije apo në terminalin portual
 - 11 identifikimi i pikave të prekshme në zonat e përmendura më lart dhe përgatitja për kundërmasa për t'iu përgjigjur atyre

5. Pajisjet e Sigurisë

5.1. Sistemet dhe pajisjet e sigurisë

- 1 Familjarizimi me lloje të ndryshme të pajisjeve dhe sistemeve të sigurisë që mund të përdoren në anije dhe terminale portuale

5.2. Kufizimet operacionale të pajisjeve dhe sistemeve të sigurisë

- 1 Kufizimet e disa zërave të pajisjeve dhe sistemeve të sigurisë

5.3. Testimi, kalibrimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe sistemeve të sigurisë

- 1 Kërkesat për testimin, kalibrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve të sigurisë

6. Identifikimi, Njohja dhe reagimi ndaj kërcënimeve të sigurisë

6.1. Njohja dhe zbulimi i armëve, lëndëve të rrezikshme dhe pajisjeve

- 1 Pamjet e llojeve të ndryshme të armëve, lëndëve të rrezikshme dhe pajisjeve dhe dëmet që atom und të shkaktojnë

6.2. Metodatat e kërkimit fizik dhe të inspektimeve pa shkaktuar bezdi

- 1 Kryerja e kërkimeve fizike dhe inspektimeve pa shkaktuar bezdi.

6.3. Kryerja dhe bashkërendimi i kërkimeve

- 1 Rëndësia e planifikimit të një kërkimi dhe praktikimi me anë të alarmit.
- 2 Planifikimi i një kërkimi duke përdorur një sistem të kontrollit të kartave
- 3 Pajisjet për grupin e kërkimit për kryerjen e një kërkimi
- 4 Proçedurat që duhen ndjekur për një kërkim efikas
- 5 Vendet e ndryshme ku mund të fshihen sende në anije

6.4. Njohja me bazë jo-diskriminuese, të personave që paraqesin rreziqe potenciale për sigurinë

- 1 Karakteristikat e përgjithshme dhe mënyrat e sjelljeve që mund të kërcënojnë sigurinë
- 2 Rëndësia e vëzhgimit për të dalluar këto persona

6.5. Teknikat e përdorura për të shmangur masat e sigurisë

- 1 Teknikat që mund të përdoren për të shmangur masat e sigurisë

6.6. Menaxhimi i turmave dhe teknikat e kontrollit

- 1 Psikologjia bazë e turmave në një situatë krize
- 2 Rëndësia e një komunikimi të qartë me ekuipazhin dhe pasagjerët në një emergjencë

7. Veprimet e Sigurisë së Anijes

7.1. Veprimet e kërkuara për nivele të ndryshme sigurie

- 1 Tre nivelet e sigurisë dhe veprimet që kërkohen për çdo nivel sigurie.

7.2. Ruajtja e sigurisë në ndërfaqjen anije/terminal portual

- 1 Kërkesat e raportimit për anijet përpara hyrjes në një port

7.3. Familjarizimi me Deklaratën e Sigurisë

- 1 Përshkrim të deklaratës së Sigurisë dhe kujt i adresohet ajo.

7.4. Kryerja e proçedurave të sigurisë

- 1 Kërkesat për Oficerin e Sigurisë së Anijes për kryerjen e inspektimeve të rregullta të sigurisë
- 2 Masat dhe proçedurat e sigurisë që kërkohen në të tre nivelet e sigurisë për të:
 - siguruar performancën e të gjitha detyrave të sigurisë në anije
 - kontrollin e aksesit në anije
 - kontrollin e imbakimit të personave dhe sendeve të tyre
 - monitorimin e zonave të kufizuara për t'u siguruar që kanë akses vetëm personat e autorizuar
 - monitorimin e zonave në kuvertë dhe zonave përreth anijes

- koordinimin e aspekteve të sigurisë në përpunimin e mallrave dhe furnizimeve të anijes; dhe
- siguruar që komunikimi për sigurinë të jetë gjithnjë i disponueshëm

8. Përgatitja për emergjenca, Alarmet dhe Ushtrimet

8.1. Kryerja e planeve të kontigjencës

- 1 Veprimet që duhen marrë në rast të cenimit të sigurisë
- 2 Planet e kontigjencës për:
 - pengmarjen
 - kërcënimin për bombë
 - sende të panjohura / shpërthyes në anije
 - dëme ndaj / shkatërrime të terminalit portual
 - pirateria dhe grabitje të tjera
 - klandestinët

8.2. Alarmet dhe Ushtrimet e Sigurisë

- 1 Kërkesat për kryerjen e alarmeve dhe ushtrimeve

9. Administrimi i Sigurisë

9.1. Dokumentacioni dhe regjistrimet

- 1 Dokumentacioni që duhet të jetë i disponueshëm në anije në çdo kohë
- 2 Veprimtaritë për të cilat duhen mbajtur regjistrime në anije dhe kohëzgjatja e ruajtjes së tyre.

Materialet Mësimore:

- Klasë për pjesën teorike me projektor ku mund të shihen materialet audio vizive apo me slaidera.
- Pjesa praktike realizohet në ambjentet e një anije dhe porti.

IX. Përshkruesit e moduleve profesionale të praktikës së shpërndarë.

1. Moduli: “Notimi dhe vozitja”

Profili mësimor: Shërbime detare në kuvertë

Niveli: V i KSHK

Titulli dhe kodi	<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i> NOTIMI DHE VOZITJA	(M-30-1040-14)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për realizuar not të paktën në dy stile të ndryshme dhe për një largësi deri në 50 m si dhe të vozisë me mjete të lehta lundrimi të tilla siç është varka (sandalli).	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar me sukses modulet bazë të sigurisë	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zhytet dhe noton me stile të ndryshme deri në 50m. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Përzgjedhja e vendit dhe stinës për notim.- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhet notimi.- Përgatitja fizike trupore.- Futja graduale në ujë.- Përdorimi i mjeteve pluskuese ndihmëse.- Lëvizja e gjymtyrëve në ujë.- Pluskimi i trupit.- Teknika e frymëmarrjes.- Qëndrimi në pozicione të ndryshme pluskimi.- Zhytja në ujë në kohëzgjatje dhe zhvendosje të ndryshme.- Notimi deri në 50m largësi me disa stile. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përzgjedhë vendin dhe stinën e përshtatshme për notim- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhet notimi;- të realizojë përgatitjen fizike trupore në tokë;- të futet gradualisht në ujë për të përshtatur temperaturën e trupit me atë të ujit;- të përdorë si duhet mjetet pluskuese ndihmëse në ujë;- të lëvizë gjymtyrët në ujë për të realizuar pluskimin;- të realizojë pluskimin;	

- të realizojë teknikën e frymëmarrjes, pa provokuar pirjen e ujit;
- të qëndrojë në pozicione të ndryshme pluskimi sipas udhëzimeve;
- të notojë, duke përshkuar distanca të ndryshme;
- të zhytet në ujë në kohëzgjatje dhe zhvendosje të ndryshme;

RM 2 Nxënësi kryen vozitje individuale të mjetit lundrues.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e mjeteve dhe pajimeve për vozitje.
- Teknika e futjes së varkës në ujë.
- Vendosja e skalmave.
- Vendoja e rremave.
- Teknika e mbajtjes së rremave.
- Pozicionimi i vozitësit ulur.
- Teknika e lëvizjes së rremave për ecjen para.
- Teknika e lëvizjes së rremave për ecjen prapa.
- Teknika e lëvizjes së rremave për kthim.
- Teknika e lëvizjes së rremave për ndalim.
- Mirëmbajtja e mjeteve të punës.
- Pastrimi i mjetit lundrues.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet e duhura për realizimin e vozitjes;
- të zbatojë teknikat e futjes së mjetit lundrues në ujë, pa e dëmtuar atë;
- të vendosë skalmat në vendet e duhura;
- të vendosë rremat në vendin e duhur;
- të zbatojë teknikën e mbajtjes së rremave në ujë;
- të pozicionojë trupin ulur, për vozitje;
- të lëvizë rremat sipas teknikës së duhur, për zhvendosjen para, prapa, kthim dhe ndalim të mjetit lundrues;
- të mirëmbajë mjetet e punës;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së vozitjeve individuale të mjetit lundrues;

RM 3 Nxënësi realizon mënyra të ndryshme vozitjeje të mjetit lundrues

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e vendit dhe mjeteve të punës për vozitje.
- Përgatitja e mjeteve dhe pajimeve të punës.
- Teknika e vozitjes në këmbë.

- Teknika e vozitjes në çift.
- Teknika e vozitjes në grup.
- Teknika e vozitjes e feneristit
- Teknika e vozitjes me një rremë (morrazë).
- Teknika e vozitjes me palluqe.
- Mirëmbajtja e mjeteve të punës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të për zgjedhë vendin dhe mjetet e punës për vozitje;
- të përgatisë mjetet dhe pajimet e punës për vozitje;
- të vozisë në këmbë, duke ruajtur ekuilibrin e trupit në mjetin lundruar;
- të zbatojë teknikën e vozitjes në këmbë;
- të zbatojë teknikën e vozitjes në çift;
- të zbatojë teknikën e vozitjes në grup;
- të zbatojë teknikën e vozitjes së feneristit;
- të zbatojë teknikën e vozitjes me një rremë (morrazë);
- të zbatojë teknikën e vozitjes me palluqe;
- të mirëmbajë mjetet e punës;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë realizimit të vozitjes së mjetit lundruar me mënyra të ndryshme;

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në det, bregdet, rezervuarë e pishina.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të procedurave të zhytjes, notimit dhe vozitjes.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për notim, zhytje, si dhe për përdorimin e mjeteve të punës për vozitje e pajimeve ndihmëse.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajimeve gjatë realizimit të zhytjeve, notimit dhe vozitjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e notimit, zhytjes dhe vozitjes.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Ambiente për notim.
- Mjete pluskuese.
- Varkë me mjetet dhe pajimet e nevojshme për vozitje.

2. Moduli: “Interpretimi i instrumentave kryesorë hidrometeorologjikë dhe radionavigacional”

Profili mësimor: Shërbime detare në kuvertë

Niveli: V i KSHK

PERSHKRUESI I MODULIT
Titulli dhe kod **INTERPRETIMI I INSTRUMENTAVE** (M-30-1041-14)
KRYESORË HIDRO-METEOROLOGJIKË DHE
RADIONAVIGACIONAL

Qëllimi i modulit Një modul që aftëson nxënësit për të interpretuar instrumentet kryesorë hidro-meteorologjikë si: barometri, flugeri dhe termometri, dhe ato radionavigacionale të tillë si: busulla magnetike/xhiroskopike & përsëritësat, krenëmatësin, instrumentat tregues të sistemit të lëvizjes dhe të drejtimit, pelengatori, thellësimatësi, llampën ALDIS.

Kohëzgjatja e modulit 30 orë mësimore

Niveli i parapëlqyer për pranim Nxënësit duhet të kenë përfunduar me sukses modulet bazë të sigurisë.

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit **RM 1 Nxënësi interpreton të dhënat nga matja me fluger.**

Përmbajtja:

- Marrja e kutisë së flugerit nga vendi i ruajtjes.
- Hapja e kutisë dhe nxjerrja e flugerit nga kutia.
- Kontrolli pamor për gjendjen teknike të flugerit.
- Zgjedhja e vendit ku do të kryejë matjen.
- Mbajtja e flugerit në pozicion matjeje.
- Interpretimi i të dhënave në ekranin e flugerit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë kutinë e flugerit pa e dëmtuar atë;
- të hapë në mënyrë korrekte kutinë e flugerit;
- të verifikojë gjendjen teknike të flugerit;
- të përzgjedhë një vend të hapur dhe pa pengesa për kryerjen e matjes;
- të mbajë si duhet flugerin në pozicion matjeje;
- të interpretojë saktë të dhënat e flugerit: shpejtësinë dhe drejtimin e erës;
- të zbatojë me korrektësi rregullat e sigurimit teknik gjatë interpretimit të të dhënave nga matja me fluge.

RM 2 Nxënësi interpreton të dhënat e temperaturës, lagështisë dhe shtypjes atmosferike.

Përmbajtja:

Për temperaturën dhe lagështinë:

- Marrja e kutisë së termometrave psihrometrikë nga vendi i ruajtjes.
- Hapja e kutisë dhe nxerrja e termometrave nga kutia.
- Kontrolli pamor për gjendjen teknike të termometrave.
- Dallimi i termometrit të thatë nga ai i lagët.
- Lagia me ujë e pambukut të termometrit të lagështisë.
- Zgjedhja e vendit ku do të kryhen matjet.
- Mbatja e termometrave në pozicion matjeje.
- Leximi i temperaturës e matur nga të dy termometrat.
- Përcaktimi i lagështirës relative dhe absolute të ajrit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik.

Për shtypjen atmosferike:

- Mbatja hapur e dritareve të ambientit ku ndodhet barometri.
- Godetja e lehtë me gisht në xhamin e aparatit të barometrit.
- Interpretimi i të dhënave të shigjetës treguese të shtypjes.
- Vendosja e shigjetës së besimit tek shigjeta treguese e shtypjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Për temperaturën dhe lagështinë:

- të marrë kutinë e termometrave pa e dëmtuar atë;
- të hapë saktë kutinë e termometrave;
- të verifikojë gjendjen teknike të termometrave;
- të dallojë termometrin e thatë nga ai i lagët ;
- të përzgjedhë një vend ku ka hije dhe ku nuk ka ndonjë burim tjetër nxehtësie për kryerjen e matjes;
- të mbajë termometrat në pozicion matjeje.
- të lexojë saktë të dhënat e temperaturës në të dy termometrat: të thatë dhe të lagur;

Për shtypjen atmosferike:

- të mbaë hapur për 20 minuta, dritaret e ambientit ku ndodhet barometri për matjen e shtypjes atmosferike;
- të godasë lehtë me gisht në xhamin e aparatit të barometrit.
- Interpretimi i të dhënave të shigjetës treguese të shtypjes.
- Vendosja e shigjetës së besimit tek shigjeta treguese e shtypjes.
- të përcaktojë saktë lagështinë relative dhe absolute në anë të tabelës psihometrike;
- të kryejë si duhet procedurat për leximin e shtypjes
- kexon saktë të dhënat mbi shtypjen atmosferike
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë interpretimit të temperaturës, lagështirës dhe shtypjes atmosferike;

RM 3 Nxënësi interpreton leximin e busullës në anije.

Përmbajtja:

- Shikimi i gradëve që tregon vija e besimit e busullës.
- Korrigjimi i leximit të busullës.
- Raportimi i drejtimit të bashit.
- Vendosja e pelengatorit mbi busull.
- Marrja e drejtimit (pelengun) të objektit që i kërkohet nga eprori.
- Raportimi i pelengut.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shikojë vazhdimisht gradët që tregon vija e besimit e busullës;
- të bëjë korrigjimin e leximit të busullës sipas tabelës;
- të raportojë me interpretim te eprori për drejtimin e bashit;
- të vendosë siduhet pelengatorin mbi busull;
- të marrë drejtimin (pelengun) e objektit që i kërkohet nga eprori;
- të raportojë me interpretim, pelengun te eprori;
- të zbatojë me korrektësi rregullat e sigurimit teknik gjatë interpretimit të busullës;

RM 4 Nxënësi interpreton leximet e ndihmuesve lundrimorë.

Përmbajtja:

- Leximi i shigjetës së krenëmatësit.
- Raportimi i leximit të krenëmatësit.
- Leximi i treguesit të drejtimit.
- Raportimi i leximit të treguesit të drejtimit.
- Leximi i treguesit të lëvizjes.
- Raportimi i leximit të treguesit të lëvizjes.
- Leximi i shpejtësimatësit.
- Raportimi i leximit të shpejtësimatësit.
- Leximi i thellësimatësit.
- Raportimi i leximit të thellësimatësit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të lexojë saktë shigjetën e krenëmatësit;
- të raportojë me interpretim leximin e krenëmatësit eprorit;
- të lexojë saktë treguesit të drejtimit;
- të raportojë me interpretim leximin e treguesit të drejtimit eprorit;
- të lexojë saktë treguesit të lëvizjes;

- të raportoje me interpretim leximin e treguesit të lëvizjes eprorit;
- të lexojë saktë shpejtësimatësit.;
- të raportoje me interpretim leximin e shpejtësimatësiteprorit;
- të lexojë saktë thellësimatësit;
- të raportoje me interpretim leximin e thellësimatësit eprorit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë interpretimit të leximeve të ndihmuesve lundrimorë.

RM 5 Nxënësi përdor llampën e sinjalizimit ALDIS.

Përmbajtja:

- Marrja e kutisë së llampës ALDIS nga vendi i ruajtjes.
- Hapja e kutisë dhe nxjerrja e llampës ALDIS nga kutia.
- Vendosja e llampës ALDIS pranë vendit ku parashikohet të përdoret.
- Bërja neto e kabllit të ushqimit.
- Sigurimi për prizën 24Volt të llampës ALDIS.
- Futja e spinën së llampës tek priza përkatëse.
- Shtypja e dorëzës së sinjalizimit me dritë.
- Heqja nga priza e kabllit të llampës.
- Mbledhja e llampës me kabllin përkatës.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë përdorimit të llampës ALDIS.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë me kujdes kutinë e llampës ALDIS nga vendi i ruajtjes;
- të hapë kutinë dhe të nxjerrë llampën ALDIS nga kutia me kujdes;
- të vendos llampën pranë vendit ku parashikohet të përdoret;
- të bëjë neto kabllin e ushqimit;
- të sigurohet për prizën 24Volt të llampës ALDIS;
- të fusë spinën e llampës tek priza përkatëse;
- të shtypë dorëzën e sinjalizimit me dritë për tek objekti që urdhërohet nga eprori;
- të heqë nga priza kabllin e llampës pas përfundimit të punës;
- të mbledhë llampën me kabllin përkatës tek kutia pas përdorimit;
- të kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të llampës ALDIS;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të llampës ALDIS.;

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në anije dhe laborator.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të

punës me instrumentat hidro-metereologjikë dhe radionavigacionalë.

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për leximin dhe raportimin e treguesve të instrumentave meteorologjikë dhe radionavigacionalë në urën e komandës së një mjeti lundrimi, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për leximin dhe interpretimin e leximeve të instrumentave meteorologjikë dhe radionavigacionale.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e vozitjeve me mjete të ndryshme lundrimi.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise në urës së komandës së një anije.
- Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumentave metereologjikë dhe radio-navigacionalë të nevojshme dhe në gjendje pune për realizimin e leximit të treguesve të tyre nga nxënësit.
- Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul

3. Moduli: “Punime mirëmbajtje në kuvertë”

Profili mësimor: Shërbime detare në kuvertë

Niveli: V i KSHK

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi **PUNIME MIRËMBAJTJE NË KUVERTË** (M-30-1042-14)

Qëllimi i modulit Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të mirëmbajtjes në kuvertë si: realizimi i nyjeve detare I, II, III, përdorimi i mjeteve e punës për qepjen e cimave e kavove, realizimi i qepjeve të cimave e kovove, përgatitja e mjeteve për mbrojtjen e anijes nga ndryshku, pastrimi i sipërfaqeve metalike të anijes nga ndryshku, lyerja e sipërfaqeve metalike me bojë, si dhe asiston oficerin për matje e ujit në tanket përkatës.

Kohëzgjatja e modulit 96 orë mësimore

Niveli i parapëlqyer për pranim Nxënësit duhet të kenë përfunduar me sukses modulet bazë të sigurisë.

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit

RM 1 Nxënësi realizon nyje detare I.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e abicave, sfillacave dhe cimave për t’u lidhur
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet.
- Teknika e realizimit të nyjës së thjeshtë.
- Teknika e realizimit të nyjës së mbarë.
- Teknika e realizimit të nyjës së mbarë dopio.
- Teknika e realizimit të nyjës së akostimit njëshe
- Teknika e realizimit të nyjës së akostimit dyshe.
- Teknika e realizimit të nyjës së akostimit treshe.
- Teknika e realizimit të nyjës së tetës njëshe.
- Teknika e realizimit të nyjës së tetës dyshe.
- Teknika e realizimit të nyjës së spirancës.
- Teknika e realizimit të nyjës së sanallit.
- Teknika e realizimit të nyjës së kalunit tek.
- Teknika e realizimit të nyjës së kalunit çift.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë abicat, sfillacat dhe cimave për t’u lidhur;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen

- lidhjet;
- të realizojë saktë nyjen e thjeshtë sipas teknikës së duhur;
 - të realizojë saktë nyjen e mbarë sipas teknikës së duhur;
 - të realizojë saktë nyjen e mbarë dopio;
 - të realizojë saktë nyjen e akostimit njëshe;
 - të realizojë saktë nyjen e akostimit dyshe;
 - të realizojë saktë nyjen e akostimit treshe;
 - të realizojë saktë nyjen e tetës njëshe;
 - të realizojë saktë nyjen e tetës dyshe;
 - të realizojë saktë nyjen e spirancës;
 - të realizojë saktë nyjen e sanallit;
 - të realizojë saktë nyjen e kalunit tek;
 - të realizojë saktë nyjen e kanlunit çift;
 - të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë realizimit të nyjeve detare I.

RM 2 Nxënësi realizon nyje detare II.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e abicave, sfillacave dhe cimave për t'u lidhur.
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet.
- Teknika e realizimit të nyjës së kacaskotës.
- Teknika e realizimit të nyjës së flamurit njëshe.
- Teknika e realizimit të nyjës së flamurit dyshe.
- Teknika e realizimit të nyjës margarita I.
- Teknika e realizimit të nyjës margarita II.
- Teknika e realizimit të nyjës margarita III.
- Teknika e realizimit të nyjës gjysëm vollta.
- Teknika e realizimit të nyjës vollta.
- Teknika e realizimit të nyjës së stopimit.
- Teknika e realizimit të nyjës së ganxhit njëshe.
- Teknika e realizimit të nyjës së ganxhit dyshe.
- Teknika e realizimit të nyjës së ganxhit treshe.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë abicat, sfillacat dhe cimat për t'u lidhur;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet;
- të realizojë saktë nyjen e kacaskotës sipas teknikës së duhur;
- të realizojë saktë nyjen e flamurit njëshe sipas teknikës së duhur;
- të realizojë saktë nyjen e flamurit dyshe;

- të realizojë saktë nyjen margarita I;
- të realizojë saktë nyjen margarita II;
- të realizojë saktë nyjen margarita III;
- të realizojë saktë nyjen gjysëm volla;
- të realizojë saktë nyjen volla;
- të realizojë saktë nyjen e stopimit;
- të realizojë saktë nyjen e ganxhit njëshe;
- të realizojë saktë nyjen e ganxhit dyshe;
- të realizojë saktë nyjen e ganxhit treshe;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë realizimit të nyjeve detare II;

RM 3 Nxënësi realizon nyje detare III.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e abicave, sfillacave dhe cimave për t'u lidhur.
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet.
- Teknika e realizimit të nyjës së mbarë me fund.
- Teknika e realizimit të nyjës së grepit.
- Teknika e realizimit të nyjës së pandulit.
- Teknika e realizimit të nyjës së bocës.
- Teknika e realizimit të gacës fikse njëshe.
- Teknika e realizimit të gacës fikse dyshe.
- Teknika e realizimit të gacës së lëvizshme.
- Teknika e realizimit të nyjës këmbë pule.
- Teknika e realizimit të nyjës së diamondit.
- Teknika e realizimit të nyjës së peshkatarit.
- Teknika e realizimit të nyjës së rremit të sanallit.
- Teknika e realizimit të nyjës së shamadurit.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë abicat, sfillacat dhe cimave për t'u lidhur;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet;
- të realizojë saktë nyjen e mbarë me fund;
- të realizojë saktë nyjen e grepit;
- të realizojë saktë nyjen e pandulit;
- të realizojë saktë nyjen e bocës;
- të realizojë saktë gacën fikse njëshe;
- të realizojë saktë gacën fikse dyshe;
- të realizojë saktë gacën e lëvizshme;
- të realizojë saktë nyjen këmbë pule;
- të realizojë saktë nyjen e diamondit;

- të realizojë saktë nyjen e peshkatarit;
- të realizojë saktë nyjen e rremit të sanallit;
- të realizojë saktë nyjen e shamadurit;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë realizimit të nyjeve detare III.

RM 4 Nxënësi përdor mjetet e punës për qepjen e cimave.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e vendit të punës për qepjen e cimave.
- Përzgjedhë materialet dhe veglat për qepjen e cimave.
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen qepjet.
- Përdorimi i sfillacave.
- Përdorimi i çakmakut.
- Përdorimi i skoçit.
- Përdorimi i kaviles.
- Përdorimi i fugave.
- Përdorimi i çekiçit të drurit.
- Përdorimi i thikës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për qepje e cimave;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qepjen e cimave;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen qepjet;
- të përdorë sfillacat për kuanimin e fundeve të cimave për moshpërbërjen e rrumave të cimës;
- të përdorë çakmakun për djegjen e fundeve të cimave për moshpërbërjen e rrumave të cimës;
- të përdorë çakmakun për djegjen e fundeve të cimave për moshpërbërjen e rrumave të cimës;
- të përdorë kavilen për distancimin e rrumave të cimës;
- të përdorë çekiçin për goditjen e kaviles distancuese;
- të përdorë thikën për prerjen e sfillacës dhe cimave;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve të punës për qepjen e cimave.

RM 5 Nxënësi realizon qepjen e cimave.

- Përzgjedhja e cimave për t'u qepur.
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen

lidhjet.

- Teknika e qepjes së cimës shkurtas.
- Teknika e qepjes së cimës gjatas.
- Teknika e realizimit të gacës së cimës me ndërthurje.
- Teknika e realizimit të gacës së cimës me qepje dhe kuanim.
- Thurja e pandulit.
- Thurja e balunit.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë cimat e përshtatshme për qepje;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen qepjet;
- të realizojë saktë qepjen e cimës shkurtas;
- të realizojë saktë qepjen e cimës gjatas;
- të realizojë saktë gacën e cimës me ndërthurje;
- të realizojë saktë gacën e cimës me qepje dhe kuanim;
- të realizojë saktë thurjen e balunit;
- të realizojë saktë thurjen e pandulit;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë realizimit të qepjes së cimave;

RM 6 Nxënësi përdor mjetet e punës për qepjen e kavove.

Përmbajtja:

- Përzgjedhë vendin e punës për qepje.
- Përzgjedhë materialet dhe veglat për qepjen e kavos.
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen qepjet.
- Përdorimi i sfillacave.
- Përdorimi i kaviles.
- Përdorimi i morsetave.
- Përdorimi i çekiçit.
- Përdorimi i darëve.
- Përdorimi i bagotës.
- Përdorimi i daltës në kudhrën metalike.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për qepje;

- të përzgjedhë materialet dhe veglat për qepjen e kavos;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen qepjet;
- të përdorë sfillacat për kumanimin e fundeve të kavos;
- të përdorë kavilen për distancimin e rrumave të kavos;
- të përdorë morsetat për shtërngimin dhe fiksimin e kavove;
- të përdorë çekiçin për goditjen e kaviles distancuese;
- të përdorë çekiçin për goditjen e daltës për prerje rrumash të vendosur mbi kudhrën metalike;
- të përdorë darët për tërheqjen e rrumave në ndërthurje;
- të përdorë bagotën për gacat e vogla kaluese;
- të përdorë morsetat për bërjen e gacave;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve për qepjen e kavove.

RM 7 Nxënësi realizon qepjen e kavove.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e kavove për qepje.
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet.
- Teknika e realizimit të qepjes së kavos shkurtas.
- Teknika e realizimit të qepjes së kavos gjatas.
- Teknika e realizimit të gacave me qepje.
- Teknika e realizimit të gacave me morseta.
- Teknika e realizimit të gacave me bagota dhe morseta.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë kavot e përshtatshme për t'u qepur;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen lidhjet;
- të realizojë saktë qepjes së kavos shkurtas;
- të realizojë saktë qepjes së kavos gjatas;
- të realizojë saktë gacën me qepje;
- të realizojë saktë gacën me morseta;
- të realizojë saktë gacën me bagota dhe morseta;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë realizimit të qepjes së kavove.

RM 8 Nxënësi përgatit mjetet për mbrojtjen anijes nga ndryshku.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e vendit të punës për mirëmbajtje.
- Përgatitja e uniformës personale të mbrojtjes në punë.
- Përgatitja e mjeteve për largimin e ndryshkut nga sipërfaqja e metalit.
- Përgatitja e skelave për punime në lartësi dhe jashtë bordit.
- Përgatitja e mjeteve të punës për lyerje.
- Përgatitja e bojës kundra ndryshkut.
- Përgatitja e bojës kundra mikro-organizmave.
- Përgatitja e brezit të sigurimit për punime në lartësi dhe jashtë bordit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për mirëmbajtje nga ndryshku;
- të përgatisë uniformën personale të mbrojtjes në punë;
- të përgatisë mjetet për largimin e ndryshkut nga sipërfaqja e metalit;
- të përgatisë skelat për punime në lartësi dhe jashtë bordit;
- të përgatisë mjetet e punës për lyerje;
- të përgatisë bojën kundra ndryshkut;
- të përgatisë bojën kundra mikro-organizmave duke e përzierë me llojin dhe sasinë e tretësit të rekomanduar;
- të përgatisë brezin e sigurimit për punime në lartësi dhe jashtë bordit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së mjeteve për mbrojtjen e anijes nga ndryshku.

RM 9 Nxënësi pastron sipërfaqen e metalit (të anijes) nga ndryshku.

Përmbajtja

- Veshja e uniformës personale të mbrojtjes në punë.
- Kepja e ndryshkut me çekiç.
- Heqja e ndryshkut me rrashpë.
- Heqja e shtresave të mëdha të ndryshkut.
- Pastrimi i shtresave të imëta të ndryshkut.
- Pastrimi i pluhurave të ndryshkut të mbetur në sipërfaqen e metalit.
- Mbledhja e mbeturinave të ndryshkut.
- Largimi i mbeturinave të ndryshkut.
- Përdorimi i skelës për punime në lartësi dhe jashtë bordit.
- Përdorimi i brezit të sigurimit për punime në lartësi dhe jashtë bordit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën personale të mbrojtjes në punë;
- të keqë shtresën e ndryshkur në sipërfaqen e metalit me çekiç;
- të heqë shtresat e ndryshkut nga sipërfaqja e metalit me rrashpë;
- të përdorë çekiçin elektrik ose me ajër për heqjen e shtresave të mëdha të ndryshkut nga sipërfaqja e metalit;
- të pastrojë shtresat e imëta të ndryshkut të mbetur në sipërfaqen e metalit, duke përdorë si furçën e telit të dorës ashtu edhe furçën e telit elektrike.
- të pastrojë pluhurat e ndryshkut të mbetur në sipërfaqen e metalit me fshesën e dorës;
- të mbledhë me fshesë mbeturinat e ndryshkut pas pastrimit të sipërfaqes së metalit;
- të largojë mbeturinat e ndryshkut pas pastrimit të sipërfaqes së metalit;
- të përdorë skelën për punime në lartësi dhe jashtë bordit;
- të përdorë brezin e sigurimit për punime në lartësi dhe jashtë bordit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë pastrimit të sipërfaqes së metalit të anijes.

RM 10 Nxënësi lyen me bojë sipërfaqen e metalit të anijes me bojë.

Përmbajtja:

- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhet lyerja.
- Lyerja e njollave me bojë kundra ndryshkut.
- Lyerja e njollave me bojë kundra mikro-organizmave.
- Lyerja e krejt sipërfaqes së metalit me bojë kundra mikro-organizmave.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhet lyerja;
- të lyejë me furçë njollat me bojë kundra ndryshkut, si dorë e parë;
- të lyejë njollat me bojë kundra ndryshkut, si dorë e dytë;
- të lyejë njollat me bojë kundra mikro-organizmave;
- të lyejë krejt sipërfaqen e metalit me bojë kundra mikro-organizmave (dorë e dytë);
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat

higjiëno-sanitare;

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë lyerjes së sipërfaqeve të metalit të anijes.

RM 11 Nxënësi asiston oficerin për matjen e lengjeve në tanke.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e mjeteve për matjen e tankeve.
- Hapja e kapakut të matjes.
- Lyerja e sondës me pastën lagështi-treguese.
- Ulja e sondës në tubin e matjes.
- Ngritja e sondës.
- Kqyrja e shenjës së lagies së sondës nga uji i tankut.
- Raportimi i gjatësisë së lagur i sondës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhet matje;
- të hapë kapakun për matje sipas udhëzimit të oficerit;
- të lyejë sondën me pastën lagështi-treguese në zonën ku orienton oficeri;
- të ulë sondën në tubin e matjes me ngadalë deri sa të prekë fundin e tankut;
- të ngrejë sondën duke mbledhur neto fijen lidhëse;
- të kqyrë me kujdes shenjën e lagies së sondës nga uji i tankut në zonën e ngjyer me pastë;
- të raportojë gjatësinë e lagur të sondës eprorit;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë asistimit të oficerit për matjen e tankeve (depove) të ujit në anije.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet detyrimisht në anije.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të punës për realizimin e nyjeve detare I, II dhe III, përdorimin e mjeteve të punës për qepjen e cimave e kavove, realizimin e qepjeve të cimave dhe kavove, përgatitjen e mjeteve për mbrojtjen e anijes nga ndryshku, pastrimin e sipërfaqeve të metalit të anijes, lyerjes me bojë të sipërfaqes metalike të anijes, si dhe asistimit të oficerit për matjen e tankevetë ujit në anije.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e proceseve të punës për realizimin e nyjeve detare I, II dhe III, përdorimin e mjeteve të punës për qepjen e cimave e kavove, realizimin e qepjeve të cimave dhe kavove, përgatitjen e mjeteve për mbrojtjen e anijes nga ndryshku, pastrimin e

sipërfaqeve të metalit të anijes, lyerjes me bojë të sipërfaqes metalike të anijes, si dhe asistimit të oficerit për matjen e tankevetë ujit në anije.

- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajimeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për realizimin e nyjeve detare I, II dhe III, përdorimin e mjeteve të punës për qepjen e cimave e kavove, realizimin e qepjeve të cimave dhe kavove, përgatitjen e mjeteve për mbrojtjen e anijes nga ndryshku, pastrimin e sipërfaqeve të metalit të anijes, lyerjes me bojë të sipërfaqes metalike të anijes, si dhe asistimit të oficerit për matjen e tankevetë ujit në anije.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- uniformën personale të mbrojtjes në punë si: helmetën mbrojtëse, syze mbrojtëse, kominoshet e punës, dorezat e lëkurës, tapat e mbrojtjes së veshëve, këpucët e sigurta, kufiet e zhurmave, maskën mbrojtëse ndaj avujve të dëmshëm
- ambiente pune në klasë apo anije.
- mjete pune për realizimin e kepjes, pastrimit dhe lyerjes së një sipërfaqeje metali të ndryshkur në anije.
- tabelë udhëzuese të hapave të punës për realizimin e kepjes së një sipërfaqeje metali të ndryshkur në anije
- tabelë udhëzuese të hapave të punës për realizimin e pastrimit të një sipërfaqeje metali të kepur
- mjete pune për realizimin e qepjeve të cimave dhe kavove
- sfillaca, abica, cima dhe kavo të përshtatshme për lidhje dhe qepje.
- tabelë udhëzuese të hapave të punës për realizimin e nyjeve detare
- tabelë udhëzuese të hapave të punës për realizimin e qepjeve të cimave dhe kavove
- tabelë udhëzuese të hapave të punës për realizimin e lyerjes së një sipërfaqeje metali të pastruar

4. Moduli: “Operime të mjeteve, mekanizmave dhe agregateve në kuvertë”

Profili mësimor: Shërbime detare në kuvertë

Niveli: V i KSHK IV

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi **OPERIME TË MJETEVE, MEKANIZMAVE (M-30-1043-14)
DHE AGREGATEVE NË KUVERTË**

Qëllimi i modulit Një modul që aftëson nxënësit për të përdorur me bashkërendim disa nga operacionet më kryesore që kryhen nga sektori i kuvertës në një anije tradicionale të tilla si: përdorimi i mjeteve e i mekanizmave për kalim cimash dhe kavosh, përdorimi i mekanizmave për akotim/ç’akostim, përdorimi i mekanizmit për hedhje/marje të spirancës, përdorimi i mekanizmave për hapje/mbyllje të hapësirave të ngarkesës, përdorimi i mjeteve e i mekanizmave për uljen/ngritjen e shkallës së imbarkimit, asistenca për operatorin e mekanizmave të ngarkim/shkarkimit, përgaritja e mjeteve dhe pajisjeve për pritjen dhe përcjelljen e pilotit.

Kohëzgjatja e modulit 36 orë mësimore

Niveli i parapëlqyer për pranim Nxënësit duhet të kenë përfunduar me sukses modulet bazë të sigurisë.

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit

RM 1 Nxënësi përdor mjetet e mekanizmat për kalimin e cimave e kavove në anije.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.
- Përzgjedhja e mjeteve dhe mekanizmave të nevojshëm.
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen qepjet.
- Kalimi i cimës në makarâ.
- Kalimi i cimës në parango.
- Kalimi kavove në tajat metalike.
- Përdorimi i ganxhave për kalim cime dhe kavo.
- Përdorimi i pastekës për kalimin e cimës.
- Përdorimi i okjos për kalim cimash dhe kavosh.
- Përdorimi bocës për stopim cimash dhe kavosh .
- Përdorimi i gametës për kalim cimash dhe kavosh.
- Përdorimi i kalunëve për nxjerjen e cimës.
- Përdorimi i kacaskotave për nxjerjen e cimës.
- Përdorimi i tamburove të vinxhave të instaluar në anije për kalim cimash dhe kavosh.
- Përdorimi i rrulave për kalim cimash dhe kavosh.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së

mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për operim;
- të përzgjedhë mjetet dhe mekanizme për kalimin e cimave dhe kavove;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen operacionet e kalimit të cimave dhe kavove;
- të kalojë saktë cimën në makarà;
- të kalojë saktë cimën në parango;
- të kalojë saktë kavot në taja metalike;
- të përdorë saktë ganxhat për kalimin e cimave ose të kavove;
- të përdorë saktë pastekën për nxjerjen e cimës;
- të përdorë saktë okjon për kalimin e cimave ose të kavove;
- të përdorë saktë bocën për stopimin e cimave ose të kavove;
- të përdorë saktë gametën për kalimin e cimave ose të kavove;
- të përdorë saktë kalunët për nxjerjen e cimës;
- të përdorë saktë kacaskotat për nxjerjen e cimës;
- të përdorë saktë tamburot e vinxhave të instaluar në anije për kalimin e cimave dhe kavove;
- të përdorë saktë rrulat për kalimin e cimave dhe kavove;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve e mekanizmeve për kalimin e cimave e kavove në anije.

RM 2 Nxënësi përdor mekanizmin e spirancës për hedhje.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave e pajisjeve për hedhjen e spirancës.
- Heqja e bllokuesve të gadinës.
- Furnizimi me energji i mekanizmit të spirancës.
- Prova pa ingranim e mekanizmit të spirancës.
- Kontrolli i rrugës së spirancës për hedhje nga bashi.
- Lëshimi i spirancës sipas urdhërit.
- Raportimi për çdo copë që kalon nga mekanizmi.
- Raportimi përfundimtar për sasinë dhe drejtimin nga sheh gadina në ujë.
- Fiksimi i barabanit.
- Bllokimi i gadinës.
- Vendosja e sinjalistikës për ditëm/natën.
- Shkëputja e energjisë për mekanizmin e spirancës.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për hedhjen e spirancës;
- të heqë me kujdes bllokueset e gadinës;
- të takojë çelësin e furnizimit me energji të mekanizmit të spirancës;
- të provojë pa ingranim mekanizmin e spirancës;
- të kontrollojë rrugën e spirancës për hedhje nga bashi;
- të lëshojë spirancën sipas urdhërit;
- të raportojë për çdo copë që kalon nga mekanizmi;
- të bëjë raportimin përfundimtar për sasinë dhe drejtimin nga sheh gadina në ujë;
- të fiksojë barabanin;
- të realizojë bllokimin e gadinës;
- të vendosë sinjalistikën për ditëm/natën;
- të realizojë shkëputjen e energjisë për mekanizmin e spirancës;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mekanizmit të spirancës për hedhje.

RM 3 Nxënësi përdor mekanizmin e spirancës për marrje.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave e pajisjeve për marrjen e spirancës.
- Heqja e bllokuesve të gadinës.
- Furnizimi me energji i mekanizmit të spirancës.
- Prova pa ingranim e mekanizmit të spirancës.
- Takimi i sistemit të larjes së gadinës me ujë.
- Kontrolli dhe raportimi i drejtimit të gadinës nga bashi.
- Përdorimi i mekanizmit për marrje spirance sipas urdhërit.
- Raportimi për çdo copë që futet në mekanizëm.
- Ndjekja me kujdes e gadinës që futet për të shmangur përplasjen e spirancës me skafin e anijes.
- Raportimi përfundimtar për marrjen e spirancës.
- Fiksimi i barabani.
- Bllokimi i unazës së spirancës.
- Heqja e sinjalistikës për ditëm/natën.
- Shkëputja e energjisë për mekanizmin e spirancës.
- Stakimi i sistemit të larjes së gadinës me ujë.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit .

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për marrjen e spirancës;
- të heqë me kujdes bllokueset e gadinës;

- të takojë çelësin e furnizimit me energji të mekanizmit të spirancës;
- të provojë pa ingranim mekanizmin e spirancës;
- të takojë sistemin e larjes me ujë të gadinës;
- të kontrollojë e raportojë për drejtimin nga 'shesh' gadina e spirancës nga bashi;
- të takojë mekanizmin për marjen e spirancën sipas urdhërit;
- të raportojë për çdo copë që futet në mekanizëm;
- të ndjekë me kujdes ardhjen e gadinës për të shmangur incidentet në momentin e ardhjes së spirancës;
- të bëjë raportimin përfundimtar për marjen e spirancës;
- të fiksojë barabanin;
- të realizojë bllokimin e unazës së spirancës;
- të heqë sinjalistikën për ditën/natën;
- të realizojë shkëputjen e energjisë për mekanizmin e spirancës;
- të stakojë sistemin e larjes së gadinës me ujë;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat e pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mekanizmit të spirancës për marrje.

RM 4 Nxënësi përdor mjetet e mekanizmat për akostimin e anijes

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.
- Përzgjedhja e mjeteve e mekanizmave për akostimin e anijes.
- Takimi i çelësit të furnizimit me energji mekanizmit të akostimit.
- Përgatitja e pandulit për hedhje.
- Prova e funksionimit të mekanizmit të akostimit.
- Përgatitja e cimave që do të përdoren për akostim.
- Raportimi i gatishmërisë dhe distancës nga vendi i akostimit.
- Hedhja e pandulit drejt vendit ku do të akostohet anija.
- Sigurimi që panduli është kapur nga personat të tjerë nga krahu ku do të akostohet anija.
- Kalimi drejt i fijes së pandulit nëpër okio sipas rastit për t'a lidhur me cimën e akostimit.
- Lidhja e fijes së pandulit me cimën e akostimit.
- Lirimi i cimës së akostimit për t'a nxjerë jashtë bordit.
- Ndjekja e kapjes së cimës nga personat në vendin ku do akostohet anija.
- Raportimi për kapjen dhe sigurimin e cimës nga personat në vendin ku do akostohet anija.
- Përdorimi i pastekave për kalimin e cimave.
- Vendosja e krahut të cimës që ndodhet në bord në barabanin e mekanizmit të akostimit.

- Puna me mekanizmin e akostimit për marjen (virimin) dhe fiksimin e cimës.
- Përdorimi i bocës për mbajtjen e cimës para fiksimit në anije.
- Lidhja e cimave në kalunë.
- Vendosja e gomave përgjatë skafit në bordin e akostimit.
- Stakimi i çelësit të energjisë për mekanizmin e akostimit.
- Marrja e pandulave në bord.
- Vendosja e mjeteve në vendet e duhura.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e punës për operim sipas caktimit;
- të përzgjedhë mjetet e mekanizmat për akostimin e anijes;
- të takojë çelësin e furnizimit me energji mekanizmit të akostimit;
- të përgatisë pandulin për hedhje;
- të provojë funksionimin e mekanizmit të akostimit;
- të përgatisë cimën që do të përdoren për akostim sipas udhëzimit;
- të raportojë gatishmërinë dhe distancën nga vendi i akostimit eprorit;
- të hedhë pandulin drejt vendit ku do të akostohet anija;
- të sigurohet që panduli është kapur nga personat të tjerë nga krahu ku do të akostohet anija;
- të kalojë drejt fijen e pandulit nëpër okio sipas rastit për t'a lidhur me cimën e akostimit sipas udhëzimit;
- të lidhë fijen e pandulit me cimën e akostimit;
- të lirojë cimën e akostimit për t'a nxjerë jashtë bordit sipas udhëzimit;
- të ndjekë kapjen e cimës nga personat në vendin ku do akostohet anija;
- të raportojë për kapjen dhe sigurimin e cimës nga personat në vendin ku do akostohet anija;
- të përdorë si duhet pastekat për kalimin e cimave;
- të vendosë krahun e cimës që ndodhet në bord në barabanin e mekanizmit të akostimit me volla saktë;
- të punojë me mekanizmin e akostimit për marjen (virimin) dhe fiksimin e cimës sipas udhëzimit;
- të përdorë bocat për mbajtjen e cimës para fiksimit në anije;
- të lidhë drejt dhe në mënyrë të sigurtë cimën në kalunë;
- të vendosë gomat përgjatë skafit në bordin e akostimit sipas udhëzimit;
- të stakojë çelësin e energjisë për mekanizmin e akostimit;
- të marrë pandulat në bord;
- të vendosë mjetet dhe veglat në vendet e duhura;

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve e mekanizmave për akostimin e anijes.

RM 5 Nxënësi përdor mjetet dhe mekanizmat për ç'akostimin e anijes

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.
- Përzgjedhja e mjeteve e mekanizmave për ç'akostimin e anijes.
- Takimi i çelësit të furnizimit me energji mekanizmit të akostimit.
- Prova e funksionimit të mekanizmit të akostimit.
- Raportimi i gatishmërisë për ç'akostim.
- Lirimi i cimës.
- Sigurimi që cima është e lirë edhe nga vendi i ç'akostimit.
- Puna me mekanizmin e akostim/ç'akostimit për marjen e cimave në bord.
- Stivimi i cimës neto në vendin e caktuar.
- Raportimi për marjen e cimave në bord.
- Heqja e gomave përgjatë skafit në bordin e akostimit.
- Stakimi i çelësit të energjisë për mekanizmin e akostimit.
- Vendosja e mjeteve në vendet e duhura.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e punës për operim sipas caktimit;
- të përzgjedhë mjetet e mekanizmat për ç'akostimin e anijes;
- të takojë çelësin e furnizimit me energji mekanizmit të akostimit;
- të provojë funksionimin e mekanizmit të akostimit;
- të raportojë gatishmërinë për ç'akostim eprorit;
- të lirojë cimën sipas udhëzimit;
- të sigurohet që cima është e lirë edhe nga vendi i ç'akostimit;
- të punojë me mekanizmin e akostim/ç'akostimit për marjen e cimave në bord;
- të stivojë cimën neto në vendin e caktuar;
- të raportojë për marjen e cimave në bord;
- të heqë gomat përgjatë skafit në bordin e akostimit sipas udhëzimit;
- të stakojë çelësin e energjisë për mekanizmin e akostimit;
- të vendosë mjetet në vendet e duhura;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve e mekanizmave për ç'akostimin e anijes..

RM 6 Nxënësi përdor mjetet dhe mekanizmat për hapjen e hapësirave të ngarkesës.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.
- Përzgjedhja e mjeteve dhe mekanizmave për hapjen e hapësirave të ngarkesës.
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen punët.
- Përdorimi i veglave për lirim të krikove të kashtanjimit.
- Përdorimi i veglave për heqjen e pykave bllokuese.
- Vendosja e kavove në udhëzues, gameta dhe taja për hapjen e kapakëve të hambarit.
- Sigurimi që në rrugën e hapjes e stivimit të kapakëve të hambarëve nuk ka njerëz apo pengesa konstruktive.
- Sigurimi që në rrezen e punës së kavos apo mekanizmit për hapjen e kapakëve të hambarit nuk ka njerëz apo pengesa konstruktive.
- Përdorimi i shenjave ndërkombëtare të dorës për udhëzimin e përdoruesit të mekanizmit për hapjen e kapakëve të hambarëve.
- Përdorimi i mekanizmit të hapjes së kapakëve të hambarëve me sinjalizues.
- Hapja e tambuqeve të hyrjes për në hapësirat e ngarkesës.
- Takimi i çelësit të ndriçimit për rrugëkalimet për në hapësirat e ngarkesës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për operim;
- të përzgjedhë mjetet dhe mekanizmave për hapjen e hapësirave të ngarkesës;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen operacionet;
- të përdorë veglat për lirim të krikove të kashtanjimit;
- të përdorë veglat për heqjen e pykave bllokuese;
- të vendosë kavot në udhëzues, gameta dhe taja sipas rastit për hapjen e kapakëve të hambarit;
- të sigurohet që në rrugën e hapjes dhe stivimit të kapakëve të hambarëve nuk ka njerëz apo pengesa konstruktive;
- të sigurohet që në rrezen e punës së kavos apo mekanizmit për hapjen e kapakëve të hambarit nuk ka njerëz apo pengesa konstruktive;
- të përdorë shenjat ndërkombëtare të dorës për udhëzimin e përdoruesit të mekanizmit për hapjen e kapakëve të hambarëve;
- të përdorë mekanizmin e hapjes së kapakëve të hambarëve me sinjalizues sipas rastit;

- të hapë tambuqet e hyrjes për në hapësirat e ngarkesës;
- të takojë çelësin e ndriçimit për rrugëkalimet për në & hapësirat e ngarkesës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve e mekanizmave për hapjen e hapësirave të ngarkesës.

RM 7 Nxënësi përdor mjetet dhe mekanizmat për mbylljen e hapësirave të ngarkesës.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.
- Përzgjedhja e mjeteve e mekanizmave për mbylljen e hapësirave të ngarkesës.
- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhen punët.
- Përdorimi i veglave për sigurimin e krikove të kashtanjimit.
- Përdorimi i veglave për sigurimin e pykave bllokuese.
- Vendosja e kavove në udhëzues, gameta dhe taja për mbylljen e kapakëve të hambarit.
- Sigurimi që në rrugën e lëvizjes dhe vendosjes në vend të kapakëve të hambarëve dhe në hambar nuk ka njerëz apo pengesa konstruktive.
- Sigurimi që në rrezen e punës së kavos apo mekanizmit për mbylljen e kapakëve të hambarit nuk ka njerëz apo pengesa konstruktive.
- Përdorimi i shenjave ndërkombëtare të dorës për udhëzimin e përdoruesit të mekanizmit për mbylljen e kapakëve të hambarëve.
- Përdorimi i mekanizmit të mbylljen së kapakëve të hambarëve me sinjalizues.
- Mbyllja e tambuqeve të hyrjes për në hapësirat e ngarkesës.
- S'takimi i çelësit të ndriçimit për rrugëkalimet për në hapësirat e ngarkesës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për operim;
- të përzgjedhë mjetet e mekanizmave për mbylljen e hapësirave të ngarkesës;
- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhen operacionet;
- të përdorë veglat për sigurimin e krikove të kashtanjimit;
- të përdorë veglat për sigurimin e pykave bllokuese;
- të vendosë kavot në udhëzues, gameta dhe taja sipas rastit për mbylljen e kapakëve të hambarit;

- të sigurohet që në rrugën e lëvizjes dhe vendosjes në vend të kapakëve të hambarëve dhe në hambar nuk ka njerëz apo pengesa konstruktive;
- të sigurohet që në rrezen e punës së kavos apo mekanizmit për mbylljen e kapakëve të hambarit nuk ka njerëz apo pengesa konstruktive;
- të përdorë shenjat ndërkombëtare të dorës për udhëzimin e përdoruesit të mekanizmit për mbylljen e kapakëve të hambarëve;
- të përdorë mekanizmin e mbylljes së kapakëve të hambarëve me sinjalizues sipas rastit;
- të mbyllë hermetikisht tambuqet e hyrjes për në hapësirat e ngarkesës;
- të s'takojë çelësin e ndriçimit për rrugëkalimet për në & hapësirat e ngarkesës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve e mekanizmave për mbylljen e hapësirave të ngarkesës.

RM 8 Nxënësi përdor mjetet dhe mekanizmat për uljen e shkallës së imbarkimit.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.
- Përzgjedhja e mjeteve e mekanizmave për uljen e shkallës së imbarkimit.
- Lirimi i bllokuesit të shkallës së imbarkimit në bandë dhe pjesë të tjera të skafit të anijes.
- Shpalosja e bashkërenduar e shkallës nga pozicioni ngjitur me bandën në pozicionin horizontal.
- Vendosja e belastrave (parmakëve) portative në vendet e tyre përgjatë shkallës.
- Lidhja/fiksimi i belastrave njëra me tjetrën për secilin krah të shkallës.
- Vendosja e rrethës mbrojtëse përgjatë shkallës.
- Përdorimi me udhëzim i mekanizmit të uljes për uljen e shkallës së imbarkimit.
- Vendosja e rrethit të shpëtimit pranë çarkut të shkallës.
- Raportimi eprorit për gatishmërinë e shkallës së imbarkimit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për operim sipas caktimit;
- të përzgjedhë mjetet dhe mekanizmave për uljen e shkallës së imbarkimit;
- të lirojë bllokuesit e shkallës së imbarkimit në bandë dhe

- pjesë të tjera të skafit të anijes;
- të shpalosë me bashkërendim shkallën nga pozicioni ngjitur me bandën në pozicionin horizontal duke përdorur tajat me cima, apo mjete të tjera sipas specifikës së anijes;
- të vendosë belaustrat (parmakët) portative në vendet e tyre përgjatë shkallës;
- të lidhë/fiksojë belaustrat njëra me tjetrën për secilin krah të shkallës;
- të vendosë rrjetën mbrotëse përgjatë shkallës;
- të përdorë me udhëzim ekanizmin e uljes për uljen e shkallës së imbarkimit;
- të vendosë rrethin e shpëtimit pranë çarkut të shkallës;
- të raportojë eprorit për gatishmërinë e shkallës së imbarkimit
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve e mekanizmave për uljen e shkallës së imbarkimit.

RM 9 Nxënësi përdor mjetet dhe mekanizmat për ngritjen e shkallës së imbarkimit.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.
- Përzgjedhja e mjeteve e mekanizmave për ngritjen e shkallës së imbarkimit.
- Heqja e rrethit të shpëtimit pranë çarkut të shkallës.
- Përdorimi i mekanizmit për ngritjen e shkallës së imbarkimit.
- Heqja e rrjetës mbrotëse përgjatë shkallës.
- Heqja/zgjidhja e belaustrave njëra me tjetrën nga secili krah i shkallës.
- Heqja e belaustrave (parmakëve) portative nga vendet e tyre përgjatë shkallës.
- Palosja e bashkërenduar e shkallës nga pozicioni horizontal me bandën në pozicionin ngjitur
- Vendosja e bllokuese të shkallës së imbarkimit në bandë dhe pjesë të tjera të skafit të anijes.
- Raportimi për marjen në bord të shkallës së imbarkimit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e punës për operim sipas caktimit;
- të përzgjedhë mjetet dhe mekanizmat për ngritjen e shkallës së imbarkimit;
- të heqë rrethin e shpëtimit pranë çarkut të shkallës;
- të përdorë me udhëzim mekanizmin për ngritjen e shkallës së imbarkimit;
- të heqë rrjetën mbrotëse përgjatë shkallës;

- të heqë/zgjidhë belaustrat njëra nga tjetra nga secili krah i shkallës;
- të heqë belaustrat (parmakët) portative nga vendet e tyre përgjatë shkallës;
- të palosë me bashkërendim shkallën nga pozicioni horizontal me bandën në pozicionin ngjitur duke përdorur tajat me cima, apo mjete të tjera sipas specifikës së anijes;
- të vendosë bllokuet e shkallës së imbarkimit në bandë dhe pjesë të tjera të skafit të anijes;
- të raportojë eprorit për marjen në bord të shkallës së imbarkimit
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përdorimit të mjeteve e mekanizmave për ngritjen e shkallës së imbarkimit.

RM 10 Nxënësi vendos mjetet dhe veglat për pritjen e pilotit.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave e mjeteve të punës për pritjen e pilotit.
- Vendosja e shkallës së brendshme të bandës.
- Vendosja e shufrave mbajtëse.
- Kontrolli i shkallës së pilotit para lëshimit jashtë bordit.
- Lidhja paraprake e fundeve të shkallës tek kacaskotat e caktuara.
- Lëshimi jashtë bordit i shkallës.
- Rregullimi i lartësisë nga vija e ujit.
- Fiksimi përfundimtar i lidhjeve të shkallës.
- Vendosja e rrethit të shpëtimit pranë shufrave mbajtëse.
- Raportimi për gatishmërinë e pritjes.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat dhe mjetet e punës për pritjen e pilotit;
- të vendosë shkallën e brendshme të bandës në vendin dhe bordin e caktuar nga oficeri;
- të vendosë shufrat mbajtëse tek vendet e duhura në filin e bandës;
- të kontrollojë shkallën e pilotit para lëshimit jashtë bordit;
- të bëjë lidhje paraprake të fundeve të shkallës tek kacaskotat e caktuara;
- të lëshojë jashtë bordit shkallën;
- të rregullojë lartësinë nga vija e ujit sipas udhëzimit të oficerit;
- të realizojë fiksimin përfundimtar të lidhjeve të shkallës;
- të vendosë rrethin e shpëtimit pranë shufrave mbajtëse;
- të raportojë për gatishmërinë e pritjes së pilotit eprorit;

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vendosjes së mjeteve e veglave për pritjen e pilotit..

RM 11 Nxënësi largon mjetet dhe veglat pas përcjelljes së pilotit

Përmbajtja:

- Veshja e pajimeve të mbrojtjes vetjake në punë.
- Shkuarja në vendin ku janë vendosur veglat dhe mjetet për pritjen e pilotit.
- Transferimi i shkallës së brendshme të bandës në vendin e caktuar për të.
- Heqja e shufrave mbajtëse nga vendet në filin e bandës.
- Ngritja në bord e shkallës së pilotit.
- Zgjidhja e fundeve të shkallës nga kacaskotat/vendet ku janë lidhur.
- Mbledhja e shkallës në formën e rotativit.
- Heqja e rrethit të shpëtimit nga vendi.
- Vendosja e shkallës, veglave dhe mjeteve të tjera në vendet e caktuara.
- Raportimi për përfundimin e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë pajimet e mbrojtjes vetjake në punë;
- të shkojë në vendin ku janë vendosur veglat dhe mjetet për pritjen e pilotit;
- të transferojë shkallën e brendshme të bandës në vendin e caktuar për të;
- të heqë shufrat mbajtëse nga vendet në filin e bandës;
- të ngrëjë në bord shkallën e pilotit;
- të zgjidhë fundet e shkallës nga kacaskotat/vendet ku janë lidhur;
- të mbledhë shkallën në formën e rotativit;
- të heqë rrethin e shpëtimit nga vendi;
- të vendosë shkallën, veglat dhe mjetet e tjera në vendet e caktuara;
- të raportojë për përfundimin e punës oficerit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë largimit të mjeteve e veglave pas përcjelljes së pilotit.

RM 12 Nxënësi asiston gjatë punës së mekanizmave për ngarkim-shkarkimin e anijes.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e vendit të punës për operim.
- Përzgjedhja e mjeteve për asistencën që do t'i jepet mekanizmit të ngarkim – shkarkimit.

- Heqja/vendosja e ganxhës së mekanizmit të përpunimit nga/në vendet e caktuara.
- Përdorimi i shenjave ndërkombëtare të dorës për udhëzimin e veprimeve që do të kryhen nga operatori i mekanizmit të ngarkim shkarkimit të anijes.
- Veprime të tjera sipas specifikës që ka anija.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin e përshtatshëm për operim;
- të përzgjedhë mjetet për asistencën që do t'i jepet mekanizmit të ngarkim-shkarkimit;
- të heqë/vendosë ganxhën e mekanizmit të përpunimit nga / në vendet e caktuara;
- të përdorë shenjat ndërkombëtare të dorës për udhëzimin e veprimeve që do të kryhen nga operatori i mekanizmit të ngarkim shkarkimit të anijes;
- të kryejë veprime të tjera sipas specifikës që ka anija;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë asistimit në punën e mekanizmave për ngarkim-shkarkimin e anijes.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në anije dhe laborator.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të përdorimit të mjeteve e mekanizmave për kalimin e cimave e kavove, përdorimin e mekanizmit të spirancës për hedhje e marrje, akostimin e ç'akostimin, hapjen e mbylljen e hapësirave të ngarkesës, uljen e ngritjen e shkallës së imbarkimit, vendosjen dhe largimin e mjeteve e veglave për pritjen e përcelljen e pilotit, si dhe asistimin gjatë punës së mekanizmave për ngarkimin e shkarkimin e anijes.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përdorimin e mjeteve dhe mekanizmave për kalimin e cimave dhe kavove, përdorimin e mekanizmit të spirancës për hedhje e marrje në anije, akostimin e ç'akostimin, hapjen e mbylljen e hapësirave të ngarkesës, uljen e ngritjen e shkallës së imbarkimit, vendosjen dhe largimin e mjeteve e veglave për pritjen e përcelljen e pilotit, si dhe asistimin gjatë punës së mekanizmave për ngarkimin e shkarkimin e anijes, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për

çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise anije dhe laborator.
- Kompleti i veglave, pajisjeve dhe mekanizmave të nevojshme për punën në kuvertë.
- Mjete të ndryshme lundrimi.
- Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

5. Moduli: “Peshkimi me anije dhe me mjete të lehta lundruese”

Profili mësimor: Shërbime detare në kuvertë

Niveli: V i KSHK

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi **PESHKIMI ME ANIJE DHE ME MJETE TË (M-16-1044-14)
LEHTA LUNDRUESE**

Qëllimi i modulit Një modul që aftëson nxënësit për të realizuar me bashkërendim detyra në funksion të gjuetisë me: (i) trata fundore me anije ku përfshihen: përgatitjen e tratës, përgatitjen e timonëve të hapjes, përdorimin e mekanizmit të lëshimit të tratës në det, marrjen e tratës, marrjen e timonëve, pastrimin, seleksionimin, ambalazhimin dhe ruajtjen e produkteve nga gjuetia, etj., si dhe gjuetinë; (ii) mjete të lehta peshkimi në bregdet, ku përfshihen: gjuetia me parangalla dhe gjuetia me vegla peshkimi stacionare (ngjitëse dhe mbrezhda).

Kohëzgjatja e modulit 36 orë mësimore

Niveli i parapëlqyer për pranim Nxënësit duhet të kenë përfunduar me sukses modulet bazë të sigurisë.

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit **RM 1 Nxënësi përgatit veglën e gjuetisë së peshkut me trata fundore.**

Përmbajtja:

- Përgatitja e tratës për gjueti.
- Kontrolli i gjendjes së pluskuese
- Kontrolli i gjendjes së peshave.
- Kontrolli i gjendjes së pëlhurës.
- Pastrimi i pëlhurës nga objekte penguese të mbetura.
- Përgatitja e timonëve të veglës së peshkimit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të punojë në grup për përgatitjen e tratës për gjueti;
- të raportojë dëme apo ngatërime tek pluskueset;
- të raportojë dëme apo ngatërime tek peshat;
- të raportojë dëme apo ngatërime tek pëlhura;
- të pastrojë pëlhurën nga objekte penguese të mbetura;
- të punojë me koordinim për përgatitjen e timonëve të tratës për hedhje;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për përgatitjen e veglës së gjuetisë së peshkut me trata fundore.

RM 2 Nxënësi sistemon veglën pas gjuetisë së peshkut me trata fundore.

Përmbajtja:

- Sistemimi i tratës pas gjuetisë.
- Kontrolli i gjendjes së pluskuese.
- Kontrolli i gjendjes së peshave.
- Kontrolli i gjendjes së pëlhurës.
- Pastrimi i pëlhurës nga objekte penguese të mbetura.
- Marrja e timonëve të veglës së peshkimit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të punojë në grup për sistemimin e tratës pas gjuetisë;
- të raportojë dëme apo ngatërime tek pluskueset;
- të raportojë dëme apo ngatërime tek peshat;
- të raportojë dëme apo ngatërime tek pëluhra;
- të pastrojë pëlhurën nga objekte penguese të mbetura;
- të punojë me koordinim për marjen e timonëve të tratës në kuvertën e anijes;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës së sistemimit të veglës pas gjuetisë së peshkut me trata fundore.

RM 3 Nxënësi përzgjedh dhe sistemon paraprakisht peshkun e zënë në anije.

Përmbajtja:

- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të punohet.
- Zbrazja e thesit të tratës fundore nga peshku i zënë.
- Heqja e papastërtive që ndodhen në thes nga peshku.
- Larja e peshkut.
- Nxjerrja e ambalazhit nga vend ruajtja.
- Pastrimi dhe larja e ambalazhit.
- Përgatitja e ambalazhit për sistemimin e peshkut të zënë.
- Seleksionimi i peshkut.
- Vendosja e peshkut nëpër ambalazhe.
- Shpëlarja përfundimtare me ujë deti.
- Vendosja e arkave të mbushura në çelën frigoriferike.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mos ndotjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të punohet;
- të bëjë zbrazjen e thesit të tratës nga peshku i zënë mbi teneshirin e kiçit të anijes sipas udhëzimit;
- të bëjë ndarjen e papastërtive që ndodhen në thes (leshterikë, sallatë deti, guaska, etj.) nga peshku pa e dëmtuar atë;
- të lajë mirë peshkun me ujë deti me kova;
- të nxjerë pa dëmtuar ambalazhin nga vend ruajtja;
- të pastrojë dhe lajë ambalazhin sipas kushteve teknike;
- të bëjë gati për përdorim sipas llojeve, ambalazhin për sistemimin e peshkut të zënë;
- të bëjë përzgjedhjen e peshkut sipas llojeve dhe madhësisë;
- të sistemojë peshkun e përzgjedhur nëpër ambalazhe (arka) sipas peshës që mund të mbartë çdo arkë në përputhje me kushtet teknike;
- të bëjë shplarjen përfundimtare me ujë deti me kova;
- të vendosë sipas kushteve teknike arkat e mbushura në çelën frigoriferike;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mos ndotjes së mjedisit gjatë përzgjedhjes dhe sistemimit paraprak të peshkut të zënë në anije.

RM 4 Nxënësi hedh vargun me parangalla për peshkim.

Përmbajtja:

- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhet peshkimi.
- Përgatitja e sanallit për vozitje.
- Vendosja e arkës me parangalla.
- Vendosja e arkës së karremave.
- Vendosja e mjeteve të shpëtimit vetjake.
- Vendosja e peshave.
- Vendosja e pluskueset me shenjë ose dritë.
- Veshja e kostumit prej mushamaje.
- Veshja e xhaketës së shpëtimit.
- Vozitja e sanallit për në vendin e hedhjes së parangallave.
- Lidhja e peshave me fundin e vargut të parangallave.
- Hedhja e peshës në ujë.
- Vendosja e karremit për parangallin e radhës nga arka.
- Hedhja e parangallit e kuar me karrema njëri pas tjetrit.
- Lidhja e pluskuesen me shenjë ose dritë tek fundit tjetër i vargut të parangallave.
- Vozitja e sanallit ndërkohë që hidhen parangallat nga person tjetër.
- Vozitja për të shkuar në breg.
- Vendosja e mjeteve dhe pajimeve që ndodhen në sanall tek vend ruajtja.

- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mosndotjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhet peshkimi;
- të bëjë si duhet gati sanallin për vozitje;
- të vendosë arkën me parangalla në sanall në ndarjen përkatëse të kështjës;
- të vendosë arkën e karremave në sanall pranë arkës së parangallave;
- të vendosë mjetet përkatëse të shpëtimit vetjak;
- të vendosë në sanall peshat pranë arkës së parangallave;
- të vendosë në sanall pluskueset me shenjë ose dritë pranë arkës së parangallave;
- të veshë si duhet kostumin prej mushamaje;
- të veshë si duhet xhaketën e shpëtimit;
- të vozisë sanallin për në vendin e hedhjes së parangallave;
- të lidhë si duhet peshën me fundin e vargut të parangallave;
- të hedhë me kujdes peshën në ujë;
- të vendosë si duhet karremin për parangallin e radhës nga arka;
- të hedhë me kujdes parangallat e kuar me karrema njëri pas tjetrit ndërkohë që sanalli vozitet nga person tjetër;
- të lidhë si duhet pluskuesen me shenjë ose dritë tek fundit tjetër i vargut të parangallave;
- të vozisë ndërkohë që hidhen parangallat nga person tjetër;
- të vozisë mbarë për të shkuar në breg;
- të vendosë pa i dëmtuar mjetet dhe pajimet që ndodhen në sanall tek vend ruajtja;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mosndotjes së mjedisit gjatë hedhjes së vargut me parangalla për peshkim.

RM 5 Nxënësi mbledh vargun me parangalla.

Përmbajtja:

- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhet peshkimi.
- Përgatitja e sanallit për vozitje.
- Vendosja e arkës së parangallave në sanall;
- Vendosja e arkës për mbledhjen e peshkut.
- Vendosja e mjeteve të shpëtimit vetjake.
- Veshja e kostumin prej mushamaje.
- Veshja e xhaketën e shpëtimit.
- Vozitja e sanallin për në vendin ku janë hedhur parangallat.
- Kapja e pluskuesen me shenjë ose dritë.

- Vendorsja e pluskuesen në sanall dhe zgjidhja e saj.
- Marrja një e nga një e parangallave në sandall.
- Heqja e peshkut të rënë në seicilin parangall.
- Vendorsja e peshkut të zënë tek arka e mbledhjes së peshkut.
- Pastrimi i parangallit nga karremat e pakonsumuar.
- Vendorsja e parangallëve në arkë.
- Marrja e peshës së lidhur në fundin e vargut të parangallave.
- Vendorsja e peshës në sanall dhe zgjidhja e saj.
- Vozitja për në breg.
- Vendorsja e mjeteve dhe pajimeve që ndodhen në sanall tek vend ruajtja.
- Dërgimi i peshkut të zënë në ambjentin për seleksionim dhe përpunim.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik dhe të mosndotjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhet peshkimi;
- të bëjë si duhet gati sanallin për vozitje;
- të vendosë arkën e parangallave në sanall në ndarjen përkatëse të kështj;
- të vendosë mjetet përkatëse të shpëtimit vetjak;
- të veshë si duhet kostumin prej mushamaje;
- të veshë si duhet xhaketën e shpëtimit;
- të vozisë sanallin për në vendin ku janë hedhur parangallat;
- të kapë me kujdes pluskuesen me shenjë ose dritë;
- të vendosë pluskuesen në sanall dhe zgjidh atë;
- të marrë ngadalë parangallat një e nga një në sanall;
- të heqë me kujdes peshkun e rënë në seicilin parangall;
- të vendosë peshkun e zënë tek arka e mbledhjes së peshkut;
- të pastrojë mirë parangallin nga karremat e pakonsumuar;
- të vendosë parangallat sipas radhës në arkën e parangallave;
- të marrë me kujdes peshën e lidhur në fundin e vargut të parangallave;
- të vendosë peshën në vendin e duhur në sanall dhe e zgjidh atë;
- të vozisë mbarë për të shkuar në breg;
- të vendosë pa i dëmtuar mjetet dhe pajimet që ndodhen në sanall tek vend ruajtja;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mosndotjes së mjedisit gjatë mbledhjes së vargut me parangalla.

RM 6 Nxënësi peshkon me rrethim pasiv në bregdet.

Përmbajtja:

- Marrja e masave të sigurisë në mjedisin ku do të kryhet peshkimi.
- Përgatitja e sanallit për vozitje.
- Vendosja e mbrezhdës (ngjitësen) në sandall.
- Vendosja e mjeteve të shpëtimit vetjake.
- Vendosja e peshave;
- Vendosja e pluskueset me shenjë ose dritë.
- Veshja e kostumit prej mushamaje.
- Veshja e xhaketës së shpëtimit.
- Vozitja e sanallit për në vendin e hedhjes së veglës së peshkimit.
- Lidhja e peshës me fundin e veglës së peshkimit.
- Hedhja e peshës dhe e pluskueses së fundit në ujë;
- Hedhja e veglës së peshkimit në ujë ndërkohë që sanalli vozitet nga person tjetër.
- Lidhja e peshës dhe pluskuesen me shenjë ose dritë tek fundit tjetër i veglës së peshkimit.
- Vozitja e sandallit ndërkohë që hidhet vegla e peshkimit në ujë nga person tjetër.
- Vozitja për në skajin e parë ku u hodh vegla e peshkimit.
- Goditja me mjete të forta e filit të sanallit për krijuar zhurma.
- Marrja e pluskueses dhe peshës së hedhur në fillim.
- Marrja e veglës së peshkimit.
- Heqja e peshkut të rënë në veglën e peshkimit.
- Vendosja e peshkut të zënë në arka.
- Pastrimi i veglës së peshkimit.
- Stivimi i veglës së peshkimit.
- Marrja e pluskuesen dhe e peshës së hedhur në fund.
- Vozitja për në breg.
- Vendosja e mjeteve dhe pajimeve në vendruajtja.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mosndotjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë masat e sigurisë në mjedisin ku do të kryhet peshkimi;
- të bëjë si duhet gati sanallin për vozitje;
- të vendosë mbrezhdën (ngjitësen) në sanall larg pengesave në teneshirin e kicët;
- të vendosë mjetet e shpëtimit vetjake;
- të vendosë në sanall peshat;
- të vendosë si duhet në sanall pluskueset me shenjë ose dritë;
- të veshë si duhet kostumin prej mushamaje;

- të veshë si duhet xhaketën e shpëtimit;
- të vozisë pa zhurmë sanallin për në vendin e hedhjes së veglës së peshkimit;
- të lidhë si duhet peshën me fundin e veglës së peshkimit;
- të hedhë me kujdes peshën dhe pluskuesen e fundit në ujë;
- të hedhë pa ngatërruar veglën e peshkimit në ujë ndërkohë që sanalli vozitet nga person tjetër;
- të lidhë si duhet peshën dhe pluskuesen me shenjë ose dritë tek fundit tjetër i veglës së peshkimit;
- të vozisë si duhet ndërkohë që hidhet vegla e peshkimit në ujë nga person tjetër;
- të vozisë me zhurma për të shkuar në skajin e parë ku u hodh vegla e peshkimit;
- të godasë me mjete të forta filin e sanallit për krijuar zhurma;
- të marë me kujdes në sanall pluskuesen dhe peshën e hedhur në fillim;
- të marë mbarë pa ngatërruar në sanall veglën e peshkimit;
- të heqë peshkun e rënë në veglën e peshkimit;
- të vendosë peshkun e zënë tek arka e mbledhjes së peshkut;
- të pastrojë mirë veglën e peshkimit nga papastërtitë;
- të stivojë pa ngatërruar veglën e peshkimit në teneshirin e sanallit;
- të marë në sanall pluskuesen dhe peshën e hedhur në fund;
- të vozisë mbarë për të shkuar në breg;
- të vendosë pa i dëmtuar mjetet dhe pajimet që ndodhen në sanall tek vend ruajtja;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mosndotjes së mjedisit gjatë peshkimit me rrethim pasiv në bregdet.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në anije dhe në bregdet.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të proceseve përgatitore për peshkimin në anije dhe me mjete të lehta lundruese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e veglës dhe sistemimin e saj pas gjuetisë së peshkut me trata fundore, përzgjedhjen dhe sistemimin paraprak të peshkut të zënë në anije, hedhjen e mbledhjen e vargut me parangalla të peshkimit, si dhe të peshkimit me rrethim në bregdet, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin punës së bashkërenduar, dallimin dhe raportimin e menjerëshëm të problemeve të konstatuara dhe sistemimin e produkteve të zëna nga gjuetia.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për

çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Ambiente pune në anije gjuetie me trata fundore dhe bregdet.
- Mjete individuale sipas specifikës së proçesit.
- Tabelë udhëzuese të hapave të punës për sistemimin e peshkut të zënë në arka sipas llojit, madhësisë dhe kushteve teknike.
- Sanall peshkimi me pajimet përkatëse të gjuetisë në bregdet.
- Veshjet vetjake të mbijetesës si: Rreth shpëtimi, xhaketë shpëtimi dhe kostum mushamaje pune.
- Tabelë udhëzuese të hapave të punës për kryerjen e gjuetisë me varg parangallash në bregdet;
- Tabelë udhëzuese të hapave të punës për kryerjen e gjuetisë me rrethim pasiv me ngjitëse në bregdet;
- Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

6. Moduli: “Sigurimi i ngarkesave të stivuara”

Profili mësimor: Shërbime detare në kuvertë

Niveli: V i KSHK

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SIGURIMI I NGARKESAVE TË STIVUARA	(M-30-1045-14)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të siguruar ngarkesën e stivuar konteinere, depozitave të lëngjeve, ngarkesën me rotativë, ngarkesa të rënda, ngarkesën me shasi, ngarkesës infuzë, ngarkesave mbi kuvertë, si dhe të ngarkesave të rrezikshme.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar me sukses modulet bazë të sigurisë.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi siguron ngarkesat konteinere. <i>Përmbajtja:</i> <ul style="list-style-type: none">- Përzgjedhja e veglave e pajisjeve për sigurim stivimi.- Kontrolli i kryqeve dhe unazave për vendosjen e krikove siguruese të konteinerëve.- Vendosja e krikove të sigurimit të konteinerëve.- Shtërngimi dhe sigurimi i krikove të kapura në konteiner dhe kuvertë.- Kontrolli i ngarkesës me konteinerë me anë të patrullimeve.- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të stivimit të konteinerëve. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përzgjedhë veglat e pajisjet e duhura për sigurimin e stivimit të konteinerëve;- të kontrollojë gatishmërinë e kryqeve dhe unazave për vendosjen e krikove siguruese të konteinerëve;- të vendosë krikot siguruese tek konteinerët dhe kuvertë;- të shtërngojë dhe sigurojë krikot e kapura në konteiner dhe në kuvertë;- të kontrollojë ngarkesën me kontejnerë;- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të stivimit të konteinerëve.	

RM 2 Nxënësi siguron depozitat e lëngjeve.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave e pajisjeve për sigurimin e stivimit.
- Përgatitja e hapësirës së ngarkesës për stivim.
- Procedura e sigurimit të depozitave të lëngjeve në kohë të keqe.
- Vendosja e takove, pykave, slingave dhe materialeve të tjera braguese.
- Kontrolli i depozitave të lëngjeve.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të stivimit te depozitave te lëngjeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat e pajisjet e duhura për sigurimin e stivimit të depozitave të lëngjeve;
- të përgatitë hapësirat për sigurimin e stivimit të depozitave të lëngjeve;
- të sigurojë depozitat e lëngjeve me anën e veglave dhe materialeve shtesë në kohë të keqe;
- të vendosë takot, pykat, slingat dhe materiale të tjera braguese;
- të kontrollojë ngarkesën me depozita lëngjesh;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të stivimit te depozitave të lëngjeve;

RM 3 Nxënësi siguron ngarkesat me rotativë.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave e pajisjeve për sigurimin e stivimit.
- Përgatitja e hapësirës së ngarkesës për vendosjen e veglave e pajisjeve për sigurimin e stivimit.
- Procedura e sigurimit të ngarkesave rotative me anën e veglave shtesë siguroese kur koha është e keqe.
- Kontrolli i ngarkesave rotative.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të ngarkesave rotative.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat e pajisjet e duhura për stivimin e ngarkesave rotative;
- të përgatitë hapësirat e ngarkesës për vendosjen e veglave e paisjeve të sigurimit të stivimit;
- të sigurojë ngarkesat rotative me anën e veglave e materialeve shtesë në kohë të keqe;

- të kontrollojë ngarkesën rotative me anë të patrullimeve;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të stivimit te ngarkesave rotative.

RM 4 Nxënësi siguron ngarkesat e rënda..

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave e pajisjeve për stivimin e ngarkesave të rënda.
- Përgatitja e hapësirave të ngarkesës për vendosjen e paisjeve për sigurimin e stivimit.
- Marrjen e masave shtesë për sigurimin e stivimit të ngarkesave të rënda
- Procedura e sigurimit të ngarkesave të rënda me anën e veglave e materialeve shtesë.
- Kontrolli i ngarkesave të rënda
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të stivimit te ngarkesave të rënda.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat e pajisjet e duhura për sigurimin e stivimit të ngarkesave të rënda;
- të përgatitë hapësirat e ngarkesës për vendosjen e pajisjeve të sigurimit të stivimit;
- të marrë masat shtesë sipas udhëzimeve të oficerit për sigurimin e stivimit të ngarkesave të rënda;
- të sigurojë ngarkesat e rënda me anën e veglave dhe materialeve shtesë në kohë të keqe;
- të kontrollojë ngarkesën e rëndë me anë të patrullimit;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të stivimit të ngarkesave të rënda.

RM 5 Nxënësi siguron ngarkesën me shasi (automjete).

Përmbajtja:

- Lokalizimi i veglave e pajisjeve për sigurimin e stivimit.
- Udhëzimi i drejtuesit të automjetit mbi pozicionin e parkimin e automjetit.
- Kontrolli i ngarkesës së automjetit.
- Përgatitja e automjetit për vendosjen e paisjeve për sigurim stivimi.
- Procedura e sigurimit shtesë të automjeteve me anën e pajisjeve të sigurisë.
- Kontrolli i ngarkesës me automjete.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të stivimit të ngarkesave me shasi

(automjeteve).

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të lokalizojë veglat dhe pajisjet për stivimin e automjeteve;
- të udhëzojë drejtuesin e automjetit mbi pozicionin e parkimit;
- të kontrollojë ngarkesën e automjetit;
- të përgatisë automjetin për vendosjen e paisjeve për sigurimin e stivimit;
- të sigurojë automjetin sipas udhëzimeve të oficerit me anën e paisjeve të siguruse;
- të kontrollojë ngarkesën me automjete me anë të patrullimeve;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të stivimit të ngarkesave me shasi (automjeteve).

RM 6 Nxënësi siguron ngarkesën rinfuzë.

Përmbajtja:

- Përgatitja e hapësirave të ngarkesës për stivimin e ngarkesave rinfuzë.
- Monitorimi i stivimit mbi plan ngarkesën.
- Hermetizimi shtesë i hapësirave të ngarkesës.
- Seperimi i ngarkesave rinfuzë .
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë stivimit të ngarkesave rinfuzë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë hapësirat e ngarkesës për stivimin e ngarkesave rinfuzo;
- të monitorojë stivimin sipas udhëzimeve të oficerit mbi plan ngarkesën;
- të testojë hermetizimin e hapësirave të ngarkesës;
- të hermetizojë hapësirat e ngarkesës;
- të seperojë ngarkesat rinfuzë nëse nevojitet;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë stivimit të ngarkesave rinfuzë;

RM 7 Nxënësi siguron ngarkesat mbi kuvertë.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e veglave e paisjeve për sigurimin e stivimit.
- Përgatitja e hapësirave të kuvertës për stivimin dhe sigurimin e ngarkesës.

- Procedura e sigurimit të ngarkesave mbi kuvertë.
- Kontrolli i ngarkesës mbi kuvertë.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të stivimit të ngarkesave mbi kuvertë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat e pajisjet e duhura për sigurimin e stivimit të ngarkesave mbi kuvertë;
- të përgatitë ngarkesat dhe hapësirat e kuvertës për stivimin dhe sigurimin e ngarkesë;
- të sigurojë ngarkesën mbi kuvertë me anën e veglave dhe materialeve shtesë;
- të kontrollojë ngarkesën mbi kuvertë me anë të patrullimeve;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat e pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë realizimit të stivimit të ngarkesave mbi kuvertë.

RM 8 Nxënësi siguron ngarkesat e rrezikshme.

Përmbajtja:

- Interpretimi i etiketimit të ngarkesave të rrezikshme.
- Përgatitja e hapësirave të ngarkesës për sigurim stivimi.
- Masat dhe procedurat specifike për transportin dhe sigurimin e ngarkesave të rrezikshme.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë stivimit të ngarkesave të rrezikshme

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të interpretojë etiketimin e ngarkesave të rrezikshme;
- të përgatisë hapësirat e ngarkesës për sigurim stivimi;
- të sigurojë ngarkesat e rrezikshme sipas procedurave specifike;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë stivimit të ngarkesave të rrezikshme.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në bordin e anijes ose laborator.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave stivimit të ngarkesave të ndryshme në mjete të ndryshme lundrimi.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për

kryerjen e sigurimit dhe stivimit të ngarkesës në mjete të ndryshme lundrimi, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin sigurimit dhe stivimit të ngarkesës në mjete të ndryshme lundrimi.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise anije dhe laborator.
- Komplet i veglave dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e sigurimit dhe stivimit të ngarkesave.
- Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

XI. Praktika profesionale e grupuar në anije.

Praktika profesionale e grupuar në anije kryhet në kuadrin e detyrave që përmbushen në anije, sipas Librit të Regjistrimit të Trajnimit në Mjetin Lundrues. Kompetencat profesionale për të cilat nxënësit duhet të praktikohen në mjete lundrimi, pasqyrohen në Librin e Regjistrimit të Trajnimit në Bord të Mjetit Lundrues. Ky libër nuk është pjesë e dokumentit të këtij skeletkurrikuli, por i bashkëngjitet atij.